



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 45, Datë 18.03.2022

MBI

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË KODIN E RRJETIT TAP,
ME PROPOZIM TË SHOQËRISË TAP AG, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 97,
DATË 15.06.2020 TË BORDIT TË ERE-S**

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1, gërma "a"; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e gazit natyror" i ndryshuar; nenit 22 të vendimit nr. 97, datë 15.06.2020 të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), “Për miratimin e Kodit të Rrjetit TAP”; Direktivës 2009/73/EC së Parlamentit dhe Këshillit të Evropës, e 13 Korrikut 2009 “Në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/EC”; Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit të Evropës, 942/2019 e datës 5 Qershor 2019, “Për krijimin e një Agjencie të Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë”; Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit të Evropës 715/2009 e 13 korrikut 2009 e ndryshuar me Vendimin e Komisionit të 24 gusht 2012, Rregullores së Komisionit të BE 312/2014 e datës 26 Mars 2014; “Mbi kushtet për akses në rrjetet e transmetimit të gazit natyror” Rregullores së Komisionit të BE 2017/459 e datës 16 Mars 2014 “Për krijimin e një kodi të rrjetit për balancimin e gazit të rrjeteve të transmetimit; Vendimit të Komisionit Evropian të datës 16 Maj 2013, i cili përmban "Përjashtimin e tubacionit Tran Adriatik nga kërkesat për aksesin e palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (Opinionit Përfundimtar i Përbashkët), Nenit 4.7.1 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët; dispozitat e Rregullores 715/2009 dhe të Kodeve Europiane të rrjetit të cilat nuk janë në konflikt me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët; Letra dërguar nga TAP AG më datë 24 Dhjetor 2021; Letra dërguar nga TAP AG më datë 7 Mars 2022; si dhe nenit 113, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 18.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror me nr. 381 prot., datë 17.03.2022,

“Mbi kërkesën e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) AG për shqyrtimin e propozimeve për aprovimin e ndryshimeve në Kodit e Rrjetit TAP” miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 97, datë 15.06.2020”,

Konstatohet se:

- TAP AG, në datën 1 shtator 2011, dorëzoi pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) të Shqipërisë një “Kërkesë Përrjashtimi për Gazsjellësin Trans Adriatik”, në përputhje me nenin 22 të Direktivës së Gazit 2003/55/EC.
- TAP AG paraqiti një “Aplikim përjashtimi për Gazsjellësin Trans Adriatik”, pranë Ministrisë Italiane të Zhvillimit Ekonomik (ARERA), në datën 29 gusht 2011; pranë Autoritetit Rregullator për Energjinë të Greqisë (RAE) në datën 31 gusht 2011, ashtu siç parashikohet në nenin 36 të Direktivës së Gazit 2009/73/EC.
- Në muajin Qershor 2013 Ministria përgjegjëse e qeverisë Italiane, RAE dhe ERE morën vendimin e përjashtimit duke miratuar Opinionin Përfundimtar të Përbashkët një dokument që është shkruar në mënyrë të përbashkët nga ARERA, RAE dhe ERE dhe e ndryshuan për t’u pajtuar me Vendimin e Komisionit [C (2013)2949 përfundimtar] datë 16 Maj 2013 dhe morën parasysh Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 Maj 2013.
- Në dokumentin e përmendur më sipër, përjashtimi nga dispozitat e Neneve 9 (Veçimi), 32 (Aksesi i Palëve të Treta TPA) për Kapacitetin Fillestar prej 10 miliard metër kub / në vit, dhe Nenet 41.6, 41.8, 41.10 (Tarifat e Rregulluara) të Direktivës së Gazit i janë dhënë TAP AG për një periudhë prej 25 vjetësh duke filluar nga Data Komerciale e Funksionimit (Commercial Operation Date), sipas disa kushteve. Midis të tjerash, sipas Nenit 4.7.1 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG është e detyruar tu paraqesë për miratim Autoriteteve Kodin e Rrjetit të TAP jo më vonë se 12 muaj para Datës Komerciale të vendosjes në Funksion.
- Bazuar në nenit 4.7.1 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Kodi i Rrjetit duhet të pajtohet me të gjitha dispozitat e Rregullores 715/2009 dhe të Kodeve Evropianë të Rrjetit të cilat nuk janë në konflikt me kushtet e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët.
- Në vijim të detyrimeve të FJO-së, dhe pas konsultimit publik, Kodi i Rrjetit është miratuar nga Autoritetet në vitin 2020 (Arera Deliberation 218/2020/R/gas, Vendim ERE N. 97 datë 15.06.2020) RAE (Vendimi 1036/2020 - Fletorja e Qeverisë B. ' 2928/17.07.2020).

- Kodi i Rrjetit TAP zbatohet për të gjithë Transportuesit mbi baza jodiskriminuese, si për Transportuesit që mbajnë Kapacitetin Fillestar ashtu edhe për Transportuesit e mundshëm të ardhshëm të Kapacitetit Zgjerues.
- TAP AG filloi aktivitetin e tij në 15 Nëntor 2020 ndërsa volumet e para të gazit u transportuan në 31 Dhjetor 2020.
- Pas një përvoje operative vjetore dhe gjithashtu pas disa reagimeve nga forumi i palëve të interesuara të TAP-it, ky i fundit nisi një proces rishikimi të Kodit të rrjetit TNC-së sipas nenit 22.1 (f) të TNC-së për të përfshirë disa ndryshime që synojnë përmirësimin e proceseve të regjistrimit dhe menaxhimit të kredisë.
- TAP AG, me letrën e datës 29 Dhjetor 2021, pas konsultimit me përdoruesit, u paraqiti Autoriteteve një propozim për disa ndryshime në Kodin e Rrjetit të evidentuar në Aneksin A. Shtesat dhe ndryshimet kanë të bëjë me:
 - Shtesat funksionale për të bërë më efikase formalitetet e nevojshme për marrjen dhe ruajtjen e statusit të “përdoruesit të regjistruar”, të nevojshëm për të kërkuar shpërndarjen e kapacitetit të transportit;
 - Futja e dispozitave që synojnë forcimin dhe bërjen më efikase të masave mbrojtëse për të garantuar ekspozimin e TAP AG ndaj përdorueseve;
 - Futja e dispozitave që lejojnë menaxhimin e një shërbimi transporti në drejtim të vëllimeve të gazit të injektuar në rrjedhën e sipërme me përcaktimin e një pike të re virtuale hyrëse që përfshin pikat fizike të Komotinit dhe Nea Mesimvrisë.
- TAP AG, në letrën e datës 7 Mars 2022, dërgoi një përditësim të propozimit zyrtar me versionin përfundimtar të Kodit të Rrjetit TAP për miratim nga tre Autoritetet, bazuar në nenin 22 të “Kodit të Rrjetit TAP” të miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 97, datë 15.06.2020, ndërmjet datave 12 Tetor 2021 dhe 11 Nëntor 2021, TAP ndërmori një konsultim publik për rishikimin e propozimit për ndryshimin e Kodit të Rrjetit TAP.
- Ndryshimet në Kodin e Rrjetit të gazsjellësit TAP janë në përputhje me parimet e përfshira në legjislacionin përkatës Evropian dhe Opinionin e Përbashkët Përfundimtar;
- Ndryshimet në Kodin e Rrjetit të transmetimit të gazit natyror të gazsjellësit TAP janë të domosdoshme të miratohen, në bazë të arsyetimeve të përbashkëta me rregullatorët e tjerë të përfshirë në Greqi(RAE) dhe Itali(ARERA) dhe të renditura në Aneksin A të kësaj dispozite.

Për të gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë së bashku me Autoritetet Rregullatore të Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAE), ndryshimet në Kodin e Rrjetit TAP të raportuar në Aneksin B, mbi bazën e arsyeve të përbashkëta të përcaktuara në Aneksin A.
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftoje palët e interesit për vendim e bordit të ERE-s përfshirë shoqërinë TAP AG, Autoritetet Rregullatore të Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAE), Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (EnC), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe shoqërinë “Albgaz” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në gjykatën administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

Shtojca A1

Autorità di regolazione per Energia, Reti e Ambiente (ARERA, Itali)
Enti Rregullator i Energjise (ERE, Shqipëri)
Ρυθμιστική Αρχή Ενέργειας (RAE, Greqi)

Miratimi i “Kodit të Rrjetit të TAP”

Miratuar me vendimin e bordit te ERE nr. 97, date 15.06.2020

Duke patur parasysh që¹:

Në datën 29 Gusht 2011 TAP AG paraqiti tek Ministria Italiane e Zhvillimit Ekonomik dhe në datën 31 Gusht 2011 tek Autoriteti Rregullator për Energjinë në Greqi (RAE) “Aplikimin e Përrjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik”, si parashikohet tek Neni 36 i Direktivës së Gazit 2009/73/EC. Në datën 1 Shtator 2011 TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë (ERE) Shqipëri “Aplikimin e Përrjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik” sipas Nenit 22 të Direktivës së Gazit 2003/55/EC.

Në muajin Qershor 2013 Ministria Italiane, RAE dhe ERE morrën vendimin e përrjashtimit duke miratuar Opinionin Përrfundimtar të Përrbashkët (këtu dhe më poshtë “FJO”) një dokument që është shkruar në mënyrë të përrbashkët nga ARERA, RAE dhe ERE (këtu dhe më poshtë: “Autoritetet”) dhe e ndryshuan për tu pajtuar me Vendimin e Komisionit [C (2013)2949 përrfundimtar] datë 16 Maj 2013 dhe morrën parasysh Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 Maj 2013.

Tek dokumenti i përrmendur më sipër, përrjashtimi nga dispozitat e Neneve 9 (Veçimi), 32 (Aksesi i Palëve të Treta TPA) për Kapacitetin Fillestar prej 10 miliard metër kub / në vit, dhe Nenet 41.6, 41.8, 41.10 (Tarifat e Rregulluara) të Direktivës së Gazit i janë dhënë TAP AG për një periudhë prej 25 vjetësh duke filluar nga Data Komerciale e Funksionimit (Commercial Operation Date), sipas disa kushteve. Midis të tjerash, sipas Nenit 4.7.1 të Opinionit Përrfundimtar të Përrbashkët, TAP AG është e detyruar tu paraqesë për miratim Autoriteteve Kodin e Rrjetit të TAP jo më vonë se 12 muaj para Datës Komerciale të vendosjes në Funksion.

Sipas Nenit 4.7.1, Kodi i Rrjetit duhet të pajtohet me të gjitha dispozitat e Rregullores 715/2009 dhe të Kodeve Europiane të Rrjetit të cilat nuk janë në konflikt me kushtet e Opinionit Përrfundimtar të Përrbashkët.

Sipas Opinionit Përrfundimtar të Përrbashkët Kodi i Rrjetit i TAP (këtu dhe më poshtë) të paktën duhet të përrfshijë sa më poshtë:

- Proçedurat e detajuara për funksionimin normal përrfshirë nominimin e kapacitetit tek të gjitha pikat e hyrjes dhe të daljes së TAP për rrjedhën në drejtim dhe në drejtim të kundërt;
- Të gjitha proçedurat e nevojshme për tregëtimin sekondar, përrfshirë të ashtuquajturën “electronic-bulletin board pjesën online për pyetje dhe përrgjigje”, e cila do të jetë në dispozicion të të gjithë tregëtarëve/furnizuesve;
- Proçedurat e Menaxhimit të Kongjestionëve;
 - Proçedurat për publikimin e të dhënave që kanë lidhje me operimin dhe disponueshmërinë e kapacitetit për të gjithë përrdoruesit e gazsjellësit;
- Deklaratën nga TAP AG që gazi i sanksionuar nuk do të importohet ose transportohet nga asnjë pjesë e projektit TAP.

¹Këtu dhe më poshtë zbatohen përrkufizimet e Opinionit Përrfundimtar të Përrbashkët dhe të Rregullores së BE 2017/459.

Kodi i Rrjetit i TAP duhet të publikohet tek faqja e internetit e TAP AG.

Sipas detyrimeve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, në datën 7 Gusht 2018 TAP AG kanë filluar tek faqja e internetit konsultimet publike për Kodin e Rrjetit të TAP. Si rezultat TAP ka marrë komente nga nëntë ente (subjekte) përgjatë procesit të konsultimit. Këtu përfshihen gjashtë kompani aktive në treg, dy shoqata industrish si dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

TAP AG paraqiti në mënyrë zyrtare Kodin e Rrjetit tek Autoritetet për miratim në datën 21 Dhjetor 2018, së bashku me komentet e marra nga “Raporti i Konsultimit Publik”. Në vijim të konsultimeve të tjera me Autoritetet, TAP AG (këtu dhe më poshtë “Tregëtarët /Furnizuesit”) ndryshoi Kodin e Rrjetit të TAP dhe në datën 20 Dhjetor 2019, u paraqiti Autoriteteve për miratim draftin e ri.

Kodi i Rrjetit i TAP aplikohet për të gjithë Tregëtarët/Furnizuesit në mënyrë jo diskriminuese (Tregëtarët/Furnizuesit që kanë Kapacitetin Fillestar janë Tregëtarët/Furnizuesit e mundshëm të të ardhmes së Kapacitetit të Zgjerimit).

Duke patur parasysh se:

Kodi i propozuar i Rrjetit (Shtojca A2) është një dokument i cili përfshin sa më poshtë ²:

1. Parakushti për të patur akses tek gazsjellësi (që do të thotë të bëhesh një Tregëtar/Furnizues) është të bëhesh Palë e Regjistruar (Neni 3), që do të thotë të sigurosh një kopje të nënshkruar të formularit të regjistrimit që ka për qëllim të identifikojë:
 - a. identitetin e kompanisë;
 - b. identitetin e përfaqësuesve të saj ligjorë;
 - c. referencat e autorizuara për kontaktet dhe funksionimin e biznesit
 - d. referencat e autorizuara për kontaktet dhe funksionimin e biznesit; e. adresën e faturës;
 - f. deklaratën e pajtueshmërisë me kushtet përkatëse të liçensës;
 - g. informacionin për të lejuar që TAP të kryejë vlerësimin fillestar të kredisë dhe të caktojë një Limit Kredie;
 - h. deklaratën për të dhënë paralajmërimet në lidhje me Sanksionet; i. deklaratën se nuk ka pozicion dominues tek tregjet përkatëse
2. Pala e Regjistruar e cila ka blerë një ose më shumë Produkte të Kapacitetit (dhe si pasojë ka nënshkruar Marrëveshjen e Transportit të Gazit me TAP) bëhet Tregëtar/Furnizues. Pala e Regjistruar po ashtu mund të tregëtojë Produktet e Kapacitetit tek një Palë tjetër e Regjistruar dhe të ketë akses tek Platforma Elektronike e të Dhënave e TAP si dhe tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit.

² Dokumenti aktual përdor përkufizime të përfshira tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët (FJO) dhe tek Kodi i Rrjetit i TAP (TNC)

Limitet e kredisë

3. Transportuesi do të caktojë një Limit Kredie për Palën e Regjistruar nëse ajo ka një përqindje kredie ose ka prokuruar një Garanci të Vlerësimit të Subjektit (Rated Entity Guarantee) ose ka paguar të paktën Minimumin e Limitit të Kredisë tek një Llogari Kolaterale me para në dorë (Cash Collateral Account);
4. Limiti i Kredisë i një Pale të Regjistruar mund të rishikohet, për tu rritur ose për tu ulur në çdo kohë me kërkesë të Palës së Regjistruar ose mund të ri testohet nga Transportuesi;
5. Kodi përcakton kriterin (Neni 4.3 dhe më tej) për të llogaritur mbi baza ditore debitin e mbetur dhe sasinë maksimale të lejuar; Produktet e Kapacitetit
6. Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Pandërprerë ofrohet, nëse është në dispozicion në formën e produkteve vjetore, tremujore, mujore dhe ditore të kapacitetit; ai ofrohet në mënyrë të pavarur tek çdo Pikë Interkonjeksioni dhe si pasojë Palët e Regjistruara duhet të rezervojnë në mënyrë të pavarur Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë tek Pikat e kërkuara të Hyrjes dhe/ose Daljes;
7. Produktet e Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Pandërprerë në një Pikë të veçantë Interkonjeksioni mund të kufizohen nga disponueshmëria e përgjithshme e Fluksit të Perëndimit (Fizik) dhe rezervimi i produkteve të Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Pandërprerë tek Pikat e tjera të Interkonjeksionit përgjatë rrugës së Sistemit të Transportit të TAP. Si rezultat i këtyre kufizimeve, Produktet e Kapacitetit tek Pikat e Daljes duhet të “plotësojnë” të njëjtin Produkt Kapaciteti për Pikat e tjera të Daljes. Kufizimet e kapacitetit duhet të bien dakord me OST fqinje.
8. Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Pandërprerë, në rastin kur të dyja anët e Pikës së Interkonjeksionit (përveç pikës së Kipoi), ofrohet si Kapaciteti i Lidhur.
9. Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Ndërprerë ofrohet vetëm për ditën në avancë;
10. Kapaciteti Komercial në Drejtim të Kundër ofrohet në formën e produkteve vjetore, tremujore, mujore dhe ditore të kapacitetit; ai ofrohet si një kombinim i shumave të barabarta të Kapacitetit të Rezervuar tek një Pikë Hyrje dhe një Pikë Dalje. Kombinimet e lejuara për Pikat e Hyrjes dhe të Daljes përcaktohen në Tabelën B Shtojca 2. Çdo kombinim i referohet Rrugës Komerciale në Drejtim të Kundërt. Kapaciteti Komercial në Drejtim të Kundërt është një produkt i ndërprerë.
11. Rrjedha Fizike në Drejtim të Kundërt ofrohet për veprime emergjente vetëm dhe nëse nuk ofrohet si produkt komercial.

Rezervimet e kapacitetit

12. Përveç në lidhje me Mekanizmin Fillestar të Alokimit të Kapacitetit dhe Produkteve të Kapacitetit të cilat rezervohen sipas Testimit të Tregut, nëse një Palë e Regjistruar dëshiron të rezervojë Kapacitet të Rezervuar ajo duhet ta bëjë këtë përmes ankandeve të kryera përmes Platformës së Rezervimit të Kapacitetit dhe është përgjegjësia e saj për të pranuar dhe për të përmbushur kërkesat e aksesit të Platformës së Rezervimit të Kapacitetit.

13. Platforma që është përzgjedhur nga Transportuesi që do të përdoret tek çdo Pikë Interkonjeksioni ofrohet nga PRISMA Platforma Europiane e Kapacitetit GmbH.

14. “Kapacitetet konkurruese” njoftohen nga Transportuesi për Platformën e Rezervimit të Kapacitetit, e cila do të marrë parasysh këto kufizime si pjesë e ankandeve konkurruese për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë tek Pikat e Daljes. Kriteri për ankandet konkurruese është që ato duhet të zhvillohen nga Transportuesi, të miratohen nga Autoritetet Rregullatore dhe të publikohen tek faqja e internetit e Transportuesit.

15. Ankandet për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë dhe Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (përveç Kapacitetit Ditor) do të aplikohen sipas një algoritmi (ascending clock auction algorithm) e cila fillon me Çmimin Rezervë sipas procedurave dhe algoritmit të përcaktuar tek Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/459 (që do të thotë Mekanizmi i Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit).

16. Çmimi Rezervë për çdo Produkt në Drejtimin Përpara të Pandërprerë ofrohet si Kapaciteti i Lidhur është totali i Çmimit Rezervë të TAP dhe çmimit rezervë për produktin përkatës të kapacitetit të ofruar nga OST Fqinje sipas rregullave të tarifave të OST Fqinje.

17. Tenderat për Kapacitetin në Drejtimin Përpara Ditor të Pandërprerë, për Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt Ditor dhe për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Pandërprerë do të aplikojnë një algoritëm uniform të çmimit të ankandit, sipas të cilit ka vetëm një raund detyrues, sipas procedurave dhe algoritmit të përcaktuar tek Mekanizmi i Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit.

18. Transportuesi do të pranojë vetëm ofertat të cilat janë sipas Paragrafit 4.4 brenda Kreditit në Dispozicion të Palës së Regjistruar.

19. Transportuesi nuk do të ofrojë produktet brenda ditës që nga Data e Vendosijes në Funkcion. (COD).

Tregu sekondar

20. Transportuesi do të lejojë dhe lehtësojë tregëtimin e Kapacitetit të Rezervuar tek Tregu Sekondar për Palët e Regjistruara në rastin e Transfertave dhe të Delegimeve. Transfera kryhet përmes platformës së rezervimit, ndërkohë që Delegimi kryhet përmes një kërkesë me shkrim që duhet të paraqitet jo më vonë se 33 Ditë Pune para datës së propozuar për këtë Delegim.

Nominimet

21. Nominimet dhe rinominimet mund të paraqiten çdo orë, sipas praktikave më të mira në BE. Nominimet duhet të jenë të balancuara (hyrjet = daljet) dhe duhet të përputhen me nominimet e paraqitura nga ana tjetër e kufirit; në rast mospërputhje aplikohen më pak rregulla.

22. Rinominimet brenda ditësh mund të kryhen tre orë para përfundimit të Ditës së Gazit dhe bëhen efektive dy orë pas përfundimit të ciklit të rinominimit.

23. Tregëtari/Furnizuesi ka opsionin që po ashtu të tregojë një “shkallë përparësie”. Nëse Transportuesit i kërkohet të reduktojë Sasitë e Nominuara të Tregëtarit/Furnizuesit, në shkallën që është e mundur, ai do të përpiqet që të marrë parasysh nivelet e përparësisë kur të caktojë se cilat palë të tjera tek një Çift Tregëtarësh/Furnizuesisht se cilat Pika Interkonjeksioni ose cila Pikë Virtuale Tregëtimi do të reduktohet fillimisht. Pika Virtuale e Tregëtimin

24. Transportuesi vendos në dispozicion të Tregëtarëve/Furnizuesve një Pikë Virtuale Tregëtimi për të lejuar tregëtimet (transferimet e gazit) midis tregëtarëve/furnizuesve brenda Rrjetit të TAP. Kjo Pikë është e aksesueshme për Tregëtarët/Furnizuesit të cilët kanë Kapacitet në Drejtimin Përpara. Balancimi

25. Nominimet e Tregëtarit/Furnizuesit duhet të jenë të balancuara (që do të thotë hyrjet = daljet). Në rast se për ndonjë arsye Tregëtarit/Furnizuesi nuk është i balancuar, ai tarifohet për disbalancën tek çmimi mesatar i ponderuar për çdo shitje (blerje) të Gazit Natyror nga Transportuesi gjatë Ditës së Gazit d. Nëse ky çmim nuk është në dispozicion, me një Çmim Reference të llogaritur në mënyrë transparente dhe të publikuar te faqja e internetit e Transportuesit.

26. Po ashtu Transportuesi duhet të vendosë një marrëveshje neutraliteti duke caktuar një llogari jo reale (Llogari Neutraliteti) përmes të cilës duhet të sigurojë që mbetet financiarisht neutral në lidhje me aktivitetet e balancimit. Balancimi i Llogarisë së Balancimit do të ngarkohet Palëve të Regjistruara të cilët ishin Tregëtarë/Furnizues gjatë atij Muaj Gazi në përfundim të çdo Muaj Gazi dhe duhet të rifillojnë nga zero në fillim të çdo Muaji Gazi. Mirëmbajtja e planifikuar

27. Mirëmbajtjet e planifikuara shpallen brenda datës 30 Shtator të çdo viti gazi ose në çdo rast, jo më pak se 42 ditë para Ditës së parë të Gazit kur do të kryhet Mirëmbajtja e Planifikuar. Transportuesi mund të ndryshojë periudhën e Mirëmbajtjes së Planifikuar në çdo kohë 30 ditë para duke qënë se Transportuesi duhet të sigurojë jo më pak se 30 ditë nga fillimi i rishikimit të Mirëmbajtjes së Planifikuar.

28. Menjëherë pas dhënies ose ndryshimit të Njoftimit të Mirëmbajtjes, Transportuesi njofton në mënyrë të veçantë çdo Tregëtar/Furnizues për Shumën që Transportuesi nuk është në gjendje ti vendosë në dispozicion në çdo Pikë Interkonjeksioni. [A ka një numër maksimal ditësh për mirëmbajtjen e planifikuar?]

29. Në rastin kur mirëmbajtja nuk është e planifikuar, çdo reduktim do të kryhet sipas kriterit të përparësisë për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë më tepër se Kapaciteti Komercial në Drejtim të Kundërt dhe Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ndërprerë dhe Kapaciteti Komercial në Drejtim të Kundërt më tepër se Kapaciteti në Drejtimin Përpara të Ndërprerë; Menaxhim i Kongjestionit

30. Menaxhimi i kongjestioneve parashikon procedurën e Dorrëzimit dhe procedurën Përdore ose Humbe në terma afatgjatë (Long-Term Use-It-Or-Loose-It):

a. Dorrëzimi është procesi sipas të cilit Tregëtari/Furnizuesi mund të lëshojë një pjesë ose të gjithë Kapacitetin e tij në Drejtimin Perpara të Pandërprerë ose Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt tek një Pikë Interkonjeksioni, në mënyrë që Transportuesi ta ofrojë kapacitetin e lëshuar në treg. Procedura e Dorrëzimit menaxhohet brenda platformës së rezervimit. Kapaciteti i lidhur mbetet i lidhur kur ai i ofrohet Dorrëzuesit, megjithatë në disa raste që përmenden tek Kodi i Rrjetit i TAP kjo nuk është e mundur.

b. Me procedurat Përdore ose Humbe në terma afatgjatë, kapaciteti afatgjatë tërhiqet nga Tregëtari/Furnizuesi në rast se ai nuk shfrytëzohet në mënyrë sistematike. Kapaciteti tërhiqet për pjesën e mbetur të vitit pas periudhës së vëzhgimit dhe për vitin e ardhshëm të gazit. Kapaciteti që është Kapaciteti i Lidhur mbetet i lidhur, përveç në disa rrethana kur kjo nuk është e mundur.

c. Tregëtarët/Furnizuesit ruajnë të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit deri kur Kapaciteti i Dorrëzuar ose kapaciteti përdore ose humbe rialokohet për Tregëtarët/Furnizuesit e rinj.

31. Aktualisht nuk parashikohen as rezervimet shtesë dhe ri – blerjet dhe as mekanizmi përdore ose humbe i ditës në avancë.

Gazi Karburant, Energjia elektrike, UFG (që nuk merret në konsideratë për gazin)

32. Gazi Karburant blihet nga Transportuesi përmes një procedure transparente që bazohet tek tregu. Pastaj Gazi Karburant u alokohet Tregëtarëve/Furnizuesve bazuar tek konsumi real i llogaritur në fund të çdo muaji. Megjithatë përqindja maksimale e gazit karburant përcaktohet.

33. Kostot e Energjisë elektrike alokohen në përpjestim me sasi të Alokua të Tregëtarëve/Furnizuesve. Këto kosto publikohen në faqen e internetit.

34. UFG po ashtu shitet ose blihet nga Transportuesi dhe alokohet në përpjestim me sasi të Alokua për tregëtarët/furnizuesit, sipas një limiti (sasia maksimale që mund ti alokohet një Tregëtari/Furnizuesi)

35. Gazi Karburant dhe UFG dhe Disbalancat e Transmetimit blihen ose shiten së bashku nga Transportuesi sipas një procedure transparente.

36. Procedurat e përditësuara për llogaritjen e kostove të Gazit Karburant, Energjisë elektrike, UFG (që nuk merret në konsideratë për gazin) parashikohen në Shtojcën 5 të Kodit të Rrjetit të TAP si zhvillime në të ardhmen për të siguruar siguri më të madhe të kostove për Tregëtarët/Furnizuesit.

Rishpërndarja

Çmimi i ankandit nga Testimi i Tregut ose ankandet e Kapacitetit Komercial në Drejtim të Kundërt të cilat i kreditohen fondit special të Autoriteteve Rregullatore, sipas Pjesës 4.7.10 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët (FJO).

Duke patur parasysh që:

Çështjet kryesore të ngritura gjatë procesit të konsultimit u trajtuan tek drafti përfundimtar i Kodit të Rrjetit. Megjithatë, disa persona po ashtu u pyetën për konceptin e Kapacitetit Komercial në Drejtim të Kundërt për rezervimet dhe nominimet që bëhen pikë më pikë dhe jo tek pika e hyrjes ose e daljes. Marrëveshja çon në një “sistem hybrid” një sistem të plotë me hyrje-dalje duke qënë që kapacitetin në drejtimin përpara përfshihet tek sistemi pikë për pikë (me rrugë të gazit të para caktuara) duke qënë që kapaciteti në drejtim të kundërt është i përfshirë. Një pasojë tjetër e rëndësishme është që mbajtësit e kapaciteteve në drejtim të kundërt nuk mund të shkëmbejnë gaz midis tyre dhe me mbajtësit e kapacitetit në drejtimin përpara tek Pikat Virtuale të Tregëtimit të TAP. Këto marrëveshje shihen si një shkelje e parimit të përgjithshëm të hyrjeve dhe daljeve të përmendura tek Direktiva e BE dhe Kodet e Rrjetit.

Duke patur parasysh që:

1. Kodi i propozuar i Rrjetit i TAP përputhet plotësisht me Rregulloren e BE në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shpërndarë të rrjeteve të gazit dhe është në harmoni me praktikat më të mira brenda tregut European;
2. Për sa kohë Kapaciteti në Drejtim të Kundërt është i përfshirë, zgjidhja e paraqitur nga TAP AG është një pasojë direkte e rregullores së veçantë të parashikuar nga Opinioni Përfundimtar i Përbashkët. Përrjashtimi është bërë sipas disa kushteve dhe midis të cilave është sigurimi që për rrjedhën virtuale në drejtim të kundërt, duke qënë që nuk ka kosto shtesë, procedurat e tregut duhet të fillojnë me një çmim rezervë shumë të ulët, për shembull 5% të Tarifës së TAP. Për më tepër, sistemi i plotë me hyrje dhe dalje (me rezervime të veçanta të kapacitetit midis pikave të hyrjes dhe të daljes) e kërkon, si parakusht një rrjet që nuk është i ngarkuar (uncongested network).

Paraqitja e produkteve të kapacitetit pikë për pikë në drejtim të kundërt me një çmim të ulur është ekuivalente me zbatimin e kushtëzimeve tek rezervimet e kapacitetit (kapaciteti në dalje në pikën A mund të rezervohet vetëm nëse korrespondenti tek kapaciteti në hyrje është rezervuar në pikën B) dhe mund të shihen si një alternativë e thjeshtë (krahasuar me ankandet) për të zgjidhur kongestionet.

Si specifikohet nga Raporti i ACER,³ kushtëzimet ekzistojnë kur një përdorues rrjeti përballet me limitet e rrjedhës së lirë të gazit nga çdo pikë hyrje tek çdo pikë dalje e zonës së tregut të gazit. Kushtëzimet po ashtu ekzistojnë kur përdoruesit e rrjetit zgjedhin të mos përdorin kapacitetin e pandërprerë të alokuar dhe nënshkruajnë një kontratë më kufizuese shkëmbimi për uljet. Në këtë rast, përdoruesit e rrjetit nxiten nga zbritjet për të limituar përdorimin e produkteve që alokohen tek një sistem me hyrje dhe dalje.

³ Raport i datës 5 Prill 2019, <https://www.acer.europa.eu/Media/News/Pages/ACER-reports-on-gasconditional-capacity-products-in-the-EU.aspx>

Në rastin e TAP kur janë përmbushur të dyja kushtet, duke qënë që Kapaciteti Fillestar është rezervuar plotësisht, kapaciteti fizik nuk është i njëjtë përgjatë rrugës. Si pasojë, një rezervim i pavarur i kapacitetit midis pikave të hyrjes dhe daljes, në krye të rezervimeve ekzistuese të kapacitetit të përjashtuar, nuk është i mundur për shkak të limiteve fizike, deri në nënshkrimin e një marrëveshje për të zgjidhur kongestionet e brendshme (që do të thotë një ankand për të alokuar të drejtat e transportit midis Greqisë dhe Shqipërisë, ose në mënyrë alternative një sistem me kapacitet të kushtëzuar).

2. Në një kontekst të tillë, kapacitetet e kushtëzuara i lejojnë rezervimet e tjera të kapacitetit, në krye të atyre ekzistuese duke qënë se përmirësojnë fleksibilitetin në tregëtimin dhe përdorimin e gazsjellësit. Megjithatë marrëveshjet aktuale nuk e ndalojnë TAP AG që të përmirësojë fleksibilitetin e rezervimit të kapacitetit veçanërisht në rastin e zgjerimit, nëse janë hequr kufizimet kryesore (siç janë kongestionet e brendshme).
3. Po ashtu Kodi i Rrjetit i TAP i referohet edhe Kushteve dhe Termave të Përgjithshme (GTC) që ekzistonin më parë tek Kodi i Rrjetit i TAP dhe janë pjesë e Marrëveshjes së Transportit të Gazit me përdoruesit që kanë rezervuar Kapacitetin Fillestar. Kushtet dhe Termet e Përgjithshme janë publikuar nga TAP AG gjatë procesit të konsultimit dhe janë të limituara për kompetencat Autoriteteve, pasi konsiderohen dhe përfshihen tek vlerësimi aktual i përgjithshëm i Kodit të Rrjetit të TAP;
4. Me kërkesë të Autoriteteve TAP AG u ka dërguar atyre një propozim të shqyrtuar të Kodit të Rrjetit, përfshirë një “Shtojcë 5” tek Kodi i Rrjetit i TAP duke treguar zhvillimet në të ardhmen të Kodit të Rrjetit të TAP që mund të përmirësohen ose që aktualisht mungojnë. Arsyet e kësaj shtyrje lidhen me nevojën për të marrë më shumë eksperiencë dhe për sigurimin e më shumë të dhënave kur gazjellësi të jetë në funksion. Çështjet që mbulohen tek Shtojca janë: (i) paraqitja e procedurave afatshkurtra për Menaxhimin e Kongjestionëve (rezervimet shtesë dhe ri-blerjet ose përdore ose humbe i ditës në avancë i pandërprerë), sipas Nenit 2.2.2 dhe 2.2.3 të Vendimit të Komisionit datë 24 Gusht 2012 për ndryshimin e Shtojcës I të Rregullores (EC) nr. 715/2009 (Procedurat e Menaxhimit të Kongjestionëve CMP) (ii) koncepti i rrjedhës në Drejtim të Kundërt dhe (iii) Gazi Karburant, Energjia Elektrike, UFG dhe (IV) të ofrojë produkte të përditshme të kapacitetit

Autoritetet së bashku

1. miratuan zgjerimin që është aplikuar “Kodi i Rrjetit i TAP” dokument i paraqitur propozuar nga TAP AG dhe bashkëlidhur si Shtojca A2.

DRAFT PËR MIRATIM: 12 PRILL 2022

GAZSJELLËSI TRANS ADRIATIK

KODI I RRJETIT TAP

12 PRILL 2022



**Trans Adriatic
Pipeline**

0086072-0000001
IS:1475407.4B

PËRMBAJTJA

Paragrafi	Faqja
1. Hyrje	1
2. Përkufizime	2
3. Palët e Regjistruara.....	22
4. Limitet e Kreditit	26
5. Produktet e Kapacitetit	32
6. Rezervimi i Kapacitetit	34
7. Tregu Sekondar	38
8. Nominimet	43
9. Përputhjet dhe Konfirmimet	48
10. Balancimi dhe Alokimi	51
11. Mirëmbajtja e Planifikuar.....	55
12. Reduktimet e Kapacitetit	58
13. Menaxhim i Mbingarkesave (CMP).....	62
14. Gazi Karburant	68
15. Energjia Elektrike	72
16. UFG (Unallocated for Gas).....	75
17. Matja	78
18. Rishpërndarja	82
19. Faturimi	85
20. Ndërprerja	88
21. Komunikimet.....	89
22. Rishikimi	91
23. Ligji Drejtues dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	96
Shtojcat	
1. Sistemi i Transportit i TAP	97
Pjesa e 1-rë Përshkrimi i Sistemit	97
Pjesa e 2-të Pajisja Matëse	98
2. Pikat e Interkonjeksionit	100
3. Formulari i Regjistrimit	102
4. Specifikimet e Gazit Natyror	111
5. Zhvillimet në të Ardhmen	112

1. HYRJE

1.1 Hyrje

Ky Kod i Rrjetit ka lidhje me Sistemin e Transportimit të TAP, ku përfshihen rregullat dhe procedurat për funksionimin e Sistemit të Transportimit të TAP dhe paraqet në detaje të drejtat dhe detyrimet e Transportuesit, Palëve të Regjistruara dhe Tregëtarit/Furnizuesit në lidhje me rezervimin dhe përdorimin e Produkteve të Kapacitetit. Ky Kod i Rrjetit zbatohet për të gjitha Palët e Regjistruara dhe Tregëtarët/Furnizuesit dhe është pjesë përbërëse e çdo Marrëveshje të Transportit të Gazit.

1.2 Hyrje tek Sistemi i Transportit i TAP

Transportuesi ka përfituar përjashtimin nga dispozitat e aksesit të palës së tretë, tarifës së rregulluar dhe detyrimit të pronës, sipas kushteve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatoreve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG në datën 3 Qershor 2013, dhënë nga Autoritetet Rregullatore sipas Direktivës 2009/73/EC. Autoritetet Rregullatore kanë miratuar Metodologjinë e tarifave të Transportuesit, të vendosur tek Marrëveshja e Transportit të Gazit, Paragrafi 5 i Kushteve dhe Termave të Përgjithshme dhe si kërkohet në Paragrafin 4.1.3 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, procesi gjyqësor miratuar nga Autoritetet Rregullatore për alokimin dhe rialokimin e kapacitetit fillestar (**Mekanizmi i Alokimit të Kapacitetit Fillestar**). Kapaciteti Rezervë është vënë në dispozicion sipas Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit Fillestar dhe gjatë Testimit të parë të Tregut, kryhet para fillimit të ndërtimit të gazsjellësit. Transportuesi përgjatë 25 viteve të kohëzgjatjes së përjashtimit, të bëjë një llogari të kapacitetit tek çdo Pikë Hyrje dhe Pikë Dalje në dispozicion të produkteve me një kohëzgjatje mbi një vit sipas afateve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët.

Kapaciteti tek Sistemi i Transportit i TAP mund të zgjerohet me një kapacitet total prej 20 miliard metër kub në vit përmes hapave të paracaktuar në rritje. Transportuesi do ta ofrojë Kapacitetin e Zgjerimit (**Expansion Capacity**) në treg me anë të Testimeve të Tregut, të cilat duhet të kryhen çdo dy vjet. Rregullat dhe procedurat me anë të të cilave Tregëtarët / Furnizuesit ose Palët e Regjistruara mund të kërkojnë Kapacitet Zgjerimi përcaktohet në Paragrafin 6.9.

1.3 Kodi i Funksionimit dhe Opinioni Përfundimtar i Përbashkët

Ky Kod i Rrjetit:

- (a) përbën “Kodin e Funksionimit” referuar Marrëveshjeve të Transportit të Gazit të nënshkruara nga Transportuesi para datës së publikimit të këtij Kodi të Rrjetit; dhe
- (b) është “Kodi i Rrjetit i TAP” referuar në paragrafin 4.7.1 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët.

2. PËRKUFIZIME

2.1 Përkufizime

Pala Pranuese nënkupton një Palë të Regjistruar që ka pranuar një Transferim të Kapacitetit të Rezervuar.

Tregëtari/Furnizuesi aktiv, nënkupton në lidhje me Nominimet e njëanshme, Tregëtari/Furnizuesi i cili dërgon një nominim si percaktohet sipas Paragrafit 8.1

OST aktive nënkupton në lidhje me Nominimet e Njëanshme, OST-ja e cila merr një nominim nga Tregëtari/Furnizuesi Aktiv sipas Paragrafit 8.1

Kostot Aktuale Energjisë Elektrike kanë kuptimin sipas Paragrafit 15.4

Tarifa Aktuale Mujore nënkupton, "Tarifën Aktuale Mujore" të llogaritur për Kapacitetin e Rezervuar të një Tregëtari/Furnizuesi sipas Marrëveshjes përkatëse të Transportit të Gazit.

OST Fqinje nënkupton një OST që operon në një Sistem të Ndërlidhur.

Filiali ka kuptimin e shpjeguar tek Kushtet dhe Termat e Përgjithshme.

Sasi të Alokua nënkupton sasinë e Gazit Natyror të alokuar për një Tregtar/Furnizues në lidhje me shpërndarjen ose ri-shpërndarjen (sipas rastit) që Tregëtari/Furnizuesi tek një Pikë e Sistemit ose në Pikën Virtuale të Tregtimit për një Ditë Gazi (Gas Day), e shprehur në kWh. Sasi të Alokua në Pikat e Hyrjes ose për tregëtim kur Gazi të dorëzohet në Pikën Virtuale të Tregtimit do të shprehen si numra pozitiv, dhe Sasi të Alokua në Pikat e Daljes ose për tregëtim kur Gazi të shpërndahet prej Pikës Virtuale të Tregtimit do të shprehet si numra negativ.

Kapacitet Mbështetës i Kredituar në mënyrë Alternative nënkupton ndonjë prej:

- (a) një Produkt Kapaciteti i rezervuar para Datës Efektive Fillestare; ose
- (b) një Produkt Kapaciteti i rezervuar si pjesë e Testimit të Tregut, dhe çdo rast e përfshin këtë Kapacitet të Rezervuar rezultat i një Delegimi.

Deklarata Vjetore nënkupton çdo Deklaratë që i dërgohet Palëve të Regjistruara në Mars të çdo Viti Gazi sipas Paragrafit 19.2.

Dokumentet e Aplikimit kanë kuptimin që i është dhënë atyre në Nenin 3.1 (b).

Agjensi e Miratuar e Vlerësimit të Kreditit nënkupton një agjenci e vlerësimit të kreditit siç është S&P, Moody's, Fitch (nëse ka një të tillë) që përfshihet në një listë, e cila mund të publikohet tek faqja e internetit e Transportuesit dhe e përditësuar herë pas here, të agjencive të vlerësimit të kredisë që janë, sipas gjykimit të Transportuesit, dhe të pranueshme nga Transportuesi për qëllime të caktimit të një Limiti Kredie për Palët e Regjistruara.

Kapaciteti i Deleguar nënkupton çdo Kapacitet të Rezervuar (ose një pjesë e tij) që i nënshtrohet një Delegimi.

Delegim nënkupton kalimin nga një Tregtar/Furnizues të të gjithë ose një pjese të Kapacitetit të tij të Rezervuar tek një Palë tjetër e Regjistruar, që kryhet me anë të një delegimi të të gjitha të drejtave të tij

për atë Kapacitet të Rezervuar (ose të një pjese të tij) dhe një marrje përsipër të të gjitha detyrimeve të ndërlidhura nga ajo Palë e Regjistruar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit. Delegimi i një pjese të Kapacitetit të Rezervuar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit mund të përbëhet nga (a) një delegim i një pjese por jo i të gjithë Kapacitetit të Rezervuar për çdo Ditë Gazi, (b) një delegim i të gjithë Kapacitetit të Rezervuar vetëm gjatë një periudhe të caktuar, ose (c) një kombinim i sa më sipër.

Formulari i Delegimit nënkupton një formular që duhet të paraqitet nga një Tregtar/Furnizues Ofertues dhe një palë e regjistruar, që dëshiron të tregtojë të drejtat dhe detyrimet për Kapacitetin Rezervë me anë të një Delegimi, formulari i të cilit do të vihet në dispozicion nga Transportuesi në faqen e tij të internetit.

Çmim i Ankandit nënkupton çdo vlerë mbi çmimin fillestar minimal të shitjes që rezulton nga një ankand i çdo Produkti të Kapacitetit.

Kapaciteti në Dispozicion nënkupton, aftësinë për të transportuar Gaz Natyror që mund të vihet në dispozicion nga Transportuesi tek Palët e Regjistruara, për ta blerë si Produkt Kapaciteti për atë periudhë sepse nuk ka qenë i rezervuar me pare si Kapacitet i Rezervuar ose sepse është liruar për rezervim si Kapacitet i Dorëzuar ose Kapaciteti i Tërhequr në lidhje me një Pikë Interkonjeksioni të caktuar, në një drejtim të caktuar dhe për një periudhë të caktuar kohore. Për të siguruar lidhjen me OST fqinje, Transportuesi do të përjashtojë kërkesën minimale për produktet afatshkurtra sipas Paragrafit 4.1.10 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët kur të përcaktojë Kapacitetin në Dispozicion për Kapacitetin e Sigurt Vjetor me Drejtim Përpara dhe për Kapacitetin e Sigurt Vjetor me Drejtim të Kundërt tek Pika e Interkonjeksionit me Drejtimin Para.

Kreditim në Dispozicion nënkupton një shumë në Euro që përfaqëson Borxhin e mëtejshëm që mund të marrë një Palë të Regjistruar, e llogaritur në përputhje me Nenin 4.4.

Përdorimi Mesatar ka kuptimin dhënë në Paragrafin 13.3.

I Balancuar nënkupton atë Tregtar/Furnizues të veçantë dhe Sasitë e tij të Nominuara dhe Sasitë e Tregtuara (ose, pas përfundimit të një Proçesi Përputhje, Sasitë e tij të Përkohshme) për një Ditë të veçantë të Gazit që:

(a) në lidhje me Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) :

(i) totali i të gjitha Sasive të Nominuara (ose, nëse aplikohet Sasitë e Përkohshme) për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) për shpërndarjen nga ai Tregtar/Furnizues në Pikat e Hyrjes dhe Sasitë e Tregtuara në total (ose, nëse është e aplikueshme, Sasitë Provizore) për t'u transferuar nga ai Tregtar/Furnizues tek një Tregtar/Furnizues tjetër në Pikën Virtuale të Tregtimit, në secilin rast në atë Ditë të Gazit;

është i barabartë me:

(ii) vlerën absolute në total të të gjitha Sasive të Nominuara (ose, nëse aplikohet, Sasitë e Përkohshme) për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) për ri-dërgim tek ai Tregtar/Furnizues në Pikat e Daljes dhe Sasitë në total të Tregtuara (ose, nëse aplikohet, Sasitë e Përkohshme) që do të merren nga ai Tregtar/Furnizues tek një Tregtar/Furnizues tjetër në Pikën Virtuale të Tregtimit, në secilin rast në atë Ditë të Gazit; dhe

(b) në lidhje me Kapacitetin e Sigurt në Drejtim të Kundërt:

(i) totali i të gjitha Sasive të Nominuara (ose, nëse aplikohet, Sasitë e Përkohshme) për Kapacitetin e Sigurt në Drejtim të Kundërt (Revers) për tu shpërndarë nga ai Tregtar/Furnizues në Pikat e Hyrjes në atë Ditë të Gazit; është e barabartë me:

- (ii) vlerën absolute në total të të gjitha Sasive të Nominuara (ose, nëse aplikohet, Sasitë e Përkohshme) për Kapacitetin e Sigurt në Drejtim të Kundërt (Revers) për ri-shpërndarje tek ai Tregtar/Furnizues në Pikat e Daljes në atë Ditë të Gazit.

Kapaciteti i Lidhur (bundled capacity) nënkupton një Produkt Kapaciteti për Kapacitetin e Sigurt në Drejtimin Përpara (**Forward Firm Capacity**) që u ofrohet Palëve të Regjistruara si një kombinim i kapacitetit të hyrjes dhe daljes në një Pikë të veçantë Interkonjeksioni në çdo Pikë Interkonjeksioni në çdo Sistemi të Transportit të TAP dhe Sistemeve përkatëse të Ndërlidhura.

Ditë Pune do të thotë çdo Ditë përveç ditës së Shtunë, të Dielë ose festë. zyrtare

Kalibrimi ka kuptimin që i është dhënë atij në Fjalorin Ndërkombëtar të Metrologjisë - Konceptet Themelore dhe të Përgjithshme dhe Termat Shoqërues (botimi i 3-të VIM) - JCGM 200: 2012 dhe termat **Kalibroj** dhe **i Kalibruar** do të kenë kuptime ekuivalente.

Kodi i Rrjetit CAM nënkupton Rregulloren e 2017/459 (EC).

Platforma e Rezervimit të Kapacitetit nënkupton platformën në internet për rezervimin dhe tregtimin e Produkteve të Kapaciteti që janë përzgjedhur nga Transportuesi për t'u përdorur në secilën Pikë Interkonjeksioni, që në Datën Fillestare Efektive duhet të sigurohet nga PRISMA Platforma Europiane e Kapacitetit GmbH.

Produkte Kapaciteti nënkupton çdo produkt për transportimin e Gazit Natyror në Sistemin e Transmetimit të TAP që ofrohen për blerje për Palët e Regjistruara nga Transportuesi, që konsistojnë në secilin prej produkteve të ndryshme që përbëjnë Kapacitetin e Sigurt në drejtimin Përpara (Forward), Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë dhe Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (**Revers**).

Kufizim i Kapacitetit nënkupton ndodhjen e çdo rasti, përveç Mirëmbajtjes së Planifikuar, e cila zvogëlon aftësinë e Transportuesit për të ofruar Kapacitet të Rezervuar në një Pikë Interkonjeksioni.

Njoftimi për Kufizim Kapaciteti nënkupton një njoftim për një Kufizim të Kapacitetit të prishëm në rastin kur Kapaciteti i Rezervuar zvogëlohet nga Transportuesi në një Pikë Interkonjeksioni dhe ku specifikohet:

- (a) data dhe koha në të cilën fillon Kufizimi i Kapacitetit;
- (b) data dhe ora (e rrumbullakosur në orën më të afërt) në të cilën Transportuesi pret që të përfundojë Kufizimi i Kapacitetit;
- (c) pika e prekur e Sistemit;
- (d) shkaku i Kufizimit të Kapacitetit; dhe
- (e) kapaciteti i mbetur në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë që Transportuesi mund të vendosë në dispozicion në atë Pikë Interkonjeksioni.

Njoftimi i Përfundimit të Kufizimit të Kapacitetit nënkupton një njoftim që u dërgohet për të informuar të gjithë Palët e Regjistruara se Kufizimi i Kapacitetit që kërkon se Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) i Pandërprerë të reduktohet nga Transportuesi në një Pikë Interkonjeksioni, ka përfunduar dhe ku specifikohet:

- (a) koha dhe data në të cilën çdo Kapaciteti i plotë i Rezervuar i çdo Tregtari/Furnizuesi në atë Pikë Interkonjeksioni do të vihet në dispozicion të tij; dhe
- (b) çdo informacion tjetër që Transportuesi beson se është i nevojshëm në lidhje me heqjen e këtij Kufizimi të Kapacitetit.

Kolaterali në para nënkupton një shumë që depozitohet nga Pala e Regjistruar ose një Person që po aplikon për tu bërë Palë e Regjistruar tek Llogaria Kolaterale në para të cilën Transportuesi mund ta përdorë për të shlyer detyrimet që mbeten të papaguara nga ajo Palë e regjistruar.

Llogari Kolaterale në Para nënkupton një llogari në Euro të Transportuesit ku Palët e Regjistruara ose Personat që aplikojnë për tu bërë palë e Regjistruar mund të depozitojnë fonde për të vepruar si kolateral ndaj detyrimeve të tyre të pagesës kundrejt Transportuesit. Çdo interes ose tarifë aplikimi në llogarinë e kolateralit në para do të kreditohet ose debitohet në ose nga ajo llogari.

Gjendja e kolateralit në para nënkupton, në lidhje me një Palë të Regjistruar ose një person që aplikon të jetë Pala e regjistruar, shumën e përgjithshme të Kolateralit në para të depozituara nga ajo Palë ose personi i regjistruar:

- (a) plus shumën e çdo interesi të kredituar në Llogarinë e Kolateralit në para siç përcaktohet nga Transportuesi;
- (b) minus shumën e çdo tarife ose interesi negativ të debituar nga Llogaria e Kolateralit në para siç përcaktohet nga Transportuesi; dhe
- (c) minus çdo shumë të debituar nga Llogaria e Kolateralit në para për të (i) paguar shumën që mbetet e papaguar që duhet të paguhet nga Pala e Regjistruar ose (ii) që duhet ti kthehet Palës ose Personit të Regjistruar.

CET do të thotë (Central European Time) Koha e Evropës Qëndrore e cila është një orë përpara UTC.

CEST do të thotë Koha Verore e Evropës Qëndrore e cila është një orë përpara CET dhe dy orë përpara UTC.

Data Tregtare e Fillimit të Punimeve nënkupton Ditën e Gazit kur Transportuesi njofton çdo Palë të Regjistruar, dhe është dita kur fillon operimi i Sistemit të Transportit të TAP e cila publikohet edhe tek faqja e internetit të Transportuesit.

Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) nënkupton kapacitetin transportues në Sistemin e Transportit të TAP për transportin në drejtim të Lindjes (Komerical) të Gazit Natyror që u vihet në dispozicion Tregtarëve/Furnizuesve sipas kësaj Marrëveshje të Transportit të Gazit në një Pikë të veçantë Interkonjeksioni dhe që Transportuesi lejohet ta ndërpresë sipas Paragrafit 12.4. Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) në një Pikë të veçantë Interkonjeksioni mund të jetë në drejtim të Pikës së Interkonjeksionit (Forward) ose në drejtim të kundërt Tregtar (Revers) të Pikës së Interkonjeksionit por duhet të rezultojë në një Rrjedhë të përgjithshme Tregtare në drejtim të lindjes (Eastward). Kapaciteti Tregtar në drejtim të kundërt nga:

- (a) Kapacitet Tregtar Vjetor në Drejtim të Kundërt;
- (b) Kapacitet Tregtar Tre Mujor në Drejtim të Kundërt;
- (c) Kapacitet Tregtar Mujor në Drejtim të Kundërt; dhe
- (d) Kapacitet Tregtar Ditor në Drejtim të Kundërt.

Kapaciteti Tregtar Ditor në drejtim të kundërt (reverse) nënkupton Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Reverse) të disponueshëm në bazë të Ditës në Avancë.

Kapaciteti Tregtar Mujor në Drejtim të Kundërt nënkupton Kapacitetin në Drejtim të Kundërt (Revers) të disponueshëm për çdo ditë Gazi në një Muaj të Caktuar Gazi.

Kapacitet Tregtar Tre Mujor në Drejtim të Kundërt (Revers) nënkupton Kapacitetin në Drejtim të Kundërt në një Tremujor të caktuar Gazi.

Rruga ne Drejtim të Kundert nënkupton çdo kombinim tek një Pikë Hyrje dhe Dalje për Kapacitetin në Drejtim të Kundert (Revers) i cili lejohet sipas Tabelës B, Shtojca 2.

Kapacitet Tregtar Vjetor në Drejtim të Kundert nënkupton Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundert në dispozicion për çdo Ditë Gazi në një Vit të caktuar të Gazit.

Stacioni i Kompresorëve nënkupton një objekt që është pjesë e Sistemit të Transportit të TAP që ka si qëllim kompesimin e Gazit Natyror në Sistemin e Transportit të TAP për të ndihmuar rrjedhën e këtij Gazi Natyror.

Marrëveshje Konfidencialiteti nënkupton një marrëveshje konfidencialiteti e lidhur nga një Person i cili po aplikon për të qënë një Palë e Regjistruar, dhe që do të kërkojë trajtimin e informacionit si konfidencial në lidhje me procesin e aplikimit dhe nëse rezulton e suksesshme marrëdhënien e atij Personi si Palë e Regjistruar me Transportuesin. Forma më e fundit e marrëveshjes së konfidencialitetit do të publikohet nga Transportuesi në faqen e tij të internetit. Marrëveshja e Konfidencialitetit nuk zbatohet për informacionin e shkëmbyer sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit, ndaj të cilës do të aplikohen termat e Marrëveshjes së Transportit të Gazit.

Sasi të Konfirmuara nënkupton sasinë e Gazit Natyror që duhet të shpërndahe ose rishpërndahe tek një Tregtar/Furnizues në një Pikë Interkonjeksioni ose në Pikën Virtuale të Tregtimit pas përfundimit të të gjitha Proçeseve të Përputhjes të shprehura në kWh për Ditën e Gazit. Sasitë e Konfirmuara në Pikat e Hyrjes do të shprehen si një numër pozitiv dhe Sasitë e Konfirmuara në Pikat e Daljes do të shprehen si numër negativ.

Njoftimi i Konfirmuar i Sasisë nënkupton një njoftim të dërguar nga Transportuesi për çdo Tregtar/Furnizues pas përlogaritjes së Sasive të Konfirmuara që përcakton Sasitë e Konfirmuara të Tregtarëve / Furnizuesve në çdo Pikë Interkonjeksioni.

Menaxhimin e mbingarkesave (CMP) ka kuptimin që i është dhënë në Paragrafin 13.4 (a).

Regjistrimi Kontraktual (Timestamp-Data) nënkupton kohën e saktë në të cilën një Tregtar/Furnizues ka kontraktuar një Produkt Kapaciteti me Transportuesin.

Limiti i Kreditit ka kuptimin në lidhje me çdo Palë të Regjistruar, shumën në Euro që përfaqëson marjen maksimale të borxhit që mund të përballojë, si përcaktohet në Paragrafin Nenin 4.3.

Kriteret e Limitit të Kreditit kanë kuptimin që i është dhënë në Paragrafin 4.1 (b).

 - (iv) titujt janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretim dhe nuk kanë asnjë efekt juridik;
 - (v) referenca për paragrafë, Nene dhe Shtojca do të thotë paragrafë të Neneve dhe Shtojcave të këtij Kodi të Rrjetit
 - (vi) referencat në këtë Kod të Rrjetit përfshijnë çdo Modifikim të këtij Kodi të Rrjetit, në përputhje me Nenin 22;
 - (vii) referenca për ndonjë marrëveshje tjetër ose për ndonjë ligj, statut, rregull, ose rregullore do të thotë e njëjta me ndryshimin, modifikimin, ose zëvendësimin herë pas here;
 - (viii) referencat për një palë ose ndonjë Person përfshijnë pasardhësit e saj dhe të deleguarve të lejuar;
 - (ix) fjalët "përfshijnë" dhe "përfshirë" konsiderohen të kualifikuara nga një referencë për "pa kufizim";
 - (x) një reduktim i një Sasie të Nominuar, Sasie të Konfirmuar ose Sasie të Alokuar nënkupton një reduktim të vlerës absolute të një sasive të tillë dhe në krahasimin e ndonjë sasive të tillë, sasia më e vogël do të thotë më e vogla e vlerave absolute të sasive të tilla;
 - (xi) një reference tek faqja e internetit e Transportuesit nënkupton faqen e internetit të korporatës së Transportuesit tek <http://www.tap-ag.com/>; dhe
 - (xii) fjalët, frazat ose shprehjet që nuk përcaktohen në këtë Kod të Rrjetit, por që kanë një kuptim të pranuar përgjithësisht në praktikën e matjes dhe metrimin në bizneset ndërkombëtare të prodhimit, transportit, shpërndarjes dhe shitjes së Gazit Natyror kanë atë kuptim.

3. PALËT E REGJISTRUARA

3.1 Aplikimi për tu bërë një Palë e Regjistruar

- (a) Çdo Person që dëshiron të bëhet një Palë e Regjistruar duhet të aplikojë për t'u bërë një Palë e Regjistruar duke paraqitur Dokumentat e Aplikimit tek Transportuesi dhe duke paguar Tarifën e Regjistrimit tek Transportuesi. Një Person do të bëhet një Palë e Regjistruar vetëm pasi të marrë një Konfirmim Regjistrimi nga Transportuesi.
- (b) Çdo Person që aplikon për tu bërë një Palë e Regjistruar fillimisht duhet të plotësojë “Formularin e ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit (**OnBoarding Form**)” që ndodhet tek faja e internetit e Transportuesit, ku përfshihet emri, adresa dhe detajet e kontaktit të Personit, si dhe duhet të plotësojë pyetësonin e ekzaminimit të personit në tërësi (IDD), një faqe interneti e cila duhet të ofrohet nga Transportuesi për personin që aplikon përmes pajisjes për ekzaminimin e personit në tërësi me plotësimin e “formularit të ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit nga aplikuesi”. Me dorëzimin e “formularit të ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit (**Onboarding Form**)” dhe kthimit të përgjigjes për Transportuesin nëpërmjet internetit të pyetësonit për ekzaminimin e personit në tërësi (IDD), Personi që aplikon për Palë të Regjistruar duhet të dorëzojë dokumentat e mëposhtme tek adresa e Transportuesit, (ose, nëse ato janë firmosur në mënyrë elektronike në një mënyrë që aplikohet nga Transportuesi, në adresën e emailit të Transportuesit), e cila do të vendoset tek Formulari i Regjistrimit:
- (i) një Formular Regjistrimi të plotësuar dhe të nënshkruar;
 - (ii) të gjitha dokumentet mbështetëse të specifikuar në Formularin e Regjistrimit, përfshirë një Marrëveshje Konfidencialiteti, konfirmimin e plotësimit online të pyetësonit për ekzaminimin i personit në tërësi (**due diligence questionnaire**) dhe vërtetim se Personi përmbush/plotëson një ose më shumë nga Kriteret e Limitit të Kreditit të specifikuar në Paragrafin 4.1 (b); dhe
 - (iii) konfirmimin me shkrim në formatin e ofruar nga Transportuesi, nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar, që ai Person njih afatet dhe është dakord se me rezervimin do të jetë i lidhur çdo Kapacitet i Rezervuar, Kushtet dhe Termat e Përgjithshme dhe Konfirmimi i Transportit pjesë e Marrëveshjes aktuale të Transportit të Gazit (GTA).

së bashku me **Dokumentat e Aplikimit** (përfshirë përgjigjen për pyetësonin e ekzaminimit të personit në tërësi IDD).

- (c) Transportuesi do të njoftojë çdo Person që ka paraqitur Dokumentet e Aplikimit mbi plotësimin ose mos plotësimin e këtyre dokumenteve, jo më vonë se pesë Ditë Pune pas marrjes së dokumenteve nga ana e Transportuesit.
- (d) Nëse njoftimi i përmendur në paragrafin (c) më lart:
- (i) përmban konfirmimin nga Transportuesi se Dokumentet e Aplikimit nuk janë të plota, atëherë kërkesa do të refuzohet, por Personi përkatës mund, në çdo kohë, të plotësojë dhe ri-dorëzojë ato dokumente pa pasur nevojë të paguajë Tarifën e Regjistrimit; ose
 - (ii) përmban konfirmimin nga Transportuesi se Dokumentet e Aplikimit janë të plota, Transportuesi (duke vepruar në fshehtësi të plotë) vlerëson nëse Personi përkatës i ka përmbushur të gjitha kërkesat për t'u bërë një Palë e Regjistruar.
- (e) Pas marrjes së një njoftimi mbi përmbushjen e përmendur në paragrafin (c) më lart, Personi përkatës duhet të sigurojë që Personi i emëruar prej tij në Formularin e Regjistrimit për të menaxhuar komunikimet e këtij Personi (i cili mund të jetë një kompani shërbimesh profesionale palë e tretë) të kalojë një provë komunikimi që do të organizohet nga Transportuesi si pjesë e procesit të aplikimit.

- (f) Nëse Transportuesi përcakton që Personi përkatës i ka përbushur të gjitha kërkesat për t'u bërë një Palë e Regjistruar, Transportuesi do t'i paraqesë një konfirmim me shkrim Personit përkatës (**Konfirmimi i Regjistrimit**) brenda 30 Ditëve Pune (ose një periudhë më të shkurtër kohore të përcaktuar nga Transportuesi duke vepruar në diskrecionin e tij të plotë) për një njoftim mbi plotësimin e referuar në paragrafin (c) më lart, duke deklaruar:
- (i) që një Person i tillë është pranuar si Palë e Regjistruar dhe është regjistruar në Regjistër; si dhe emrin e tij të publikuar tek lista e Palëve të Regjistruara në faqen e internetit të Transportuesit;
 - (ii) Limitin e Kreditit që është i zbatueshëm për atë Person;
 - (iii) një Kod Llogarie të Tregtarit/Furnizuesit që do të përdoret nga ai Person në lidhje me çdo blerje të Kapacitetit në drejtimin Përpara të Pandërprerë ose të Kapacitetit në drejtimin Përpara të Ndërprerë dhe
 - (iv) kode të veçanta të Llogarisë së Tregtarit /Furnizuesit për çdo Rrugë Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) që do të përdoret nga ai Person në lidhje me çdo blerje të Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers).
- (g) Personat që kanë Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjes për Transportin e Gazit të nënshkruar para Datës Efektive Fillestare do të regjistrohen automatikisht në Regjistër si Palë e Regjistruar pa qenë nevoja për të dorëzuar një Formular Regjistrimi. Megjithatë, deri atëherë këta Persona do të paraqesin dokumentat që janë të specifikuar në Formularin e Regjistrimit dhe që kërkojnë si dëshmi të Personit për plotësimin e një ose më shumë të Kriterëve të Limitit të Kreditit, Limiti i Kreditit që do të aplikohet për këta Persona si Palë të Regjistruara do të jetë zero.

3.2 Përditësime të informacionit

- (a) Çdo Palë e Regjistruar duhet, sipas kërkesës së Transportuesit (e cila pritet të jetë jo më vonë se 15 Ditë Pune para fillimit të çdo Viti Gazi), t'i sigurojë një njoftim me shkrim Transportuesit:
- (i) duke konfirmuar që asnjë informacion i dhënë nga ajo Palë e Regjistruar në Dokumentet e Aplikimit nuk ka ndryshuar që nga konfirmimi i fundit i dhënë nga ajo Palë e Regjistruar;(që në rastin e pyetësorit IDD mund të kërkojë që Pala e Regjistruar të dorëzojë përsëri përgjigjen për këtë pyetësor nëse kërkohet nga Transportuesi); ose
 - (ii) identifikimin e informacionit të dhënë nga ajo Palë e Regjistruar në Dokumentat e Aplikimit që ka ndryshuar
- (b) Secila Palë e Regjistruar, përveç detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (a) më sipër, duhet t'i sigurojë një njoftim me shkrim Transportuesit duke identifikuar çdo ndryshim material në informacionin e dhënë nga ajo Palë e Regjistruar në Dokumentet e Aplikimit, menjëherë pasi të marrë dijeni mbi çdo ndryshim të tillë material.
- (c) Secila Palë e Regjistruar që njofton Transportuesin për një ndryshim të ndonjë prej informacioneve të ofruara nga ajo Palë e Regjistruar në Dokumentat e Aplikimit, duhet të paraqesë versionet e rishikuara të Dokumentave të Aplikimit që preken nga ai ndryshim brenda 5 (pesë) Ditëve Pune të këtij njoftimi dhe duhet të bashkëpunojnë me çdo kërkesë që Transportuesi mund të bëjë për informacion të mëtejshëm ose dokumentacion në lidhje me atë ndryshim.
- (d) Pas marrjes së Dokumentave të rishikuar të Aplikimit (ose nëse nuk është vendosur një njoftim poshtë paragrafit (a) të përmendur më sipër), Transportuesi do të vlerësojë nëse Pala përkatëse e Regjistruar i përbush detyrimet për tu bërë një Palë e Regjistruar dhe nëse nuk i plotëson mund të veprojë sipas përcaktimeve të Paragrafit 3.4.

3.3 Të drejtat dhe detyrimet e Palëve të Regjistruara

- (a) Vetëm Palët e Regjistruara kanë të drejtë:
- (i) të marrin pjesë në ankande dhe të blejnë Produkte Kapaciteti, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Paragrafin 6;
 - (ii) të tregojnë Produkte Kapaciteti me Palët e tjera të Regjistruara në përputhje me Paragrafin 7; dhe
 - (iii) të kenë akses tek Platforma Elektronike e të Dhënave e TAP dhe, sipas Paragrafit 6.1(a) në Platformën e Rezervimit të Kapaciteteve.
- (b) Çdo Palë e Regjistruar duhet të mbajë në çdo kohë një Limit Krediti jo më pak se Limiti Minimal i Kreditit duke përbushur vazhdimisht një ose më shumë Kriteretë të Limitit të Kreditit përveç nëse ajo Palë e Regjistruar mban Kapacitetin Alternativ të Mbështetjes së Kreditit.
- (c) Një Palë e Regjistruar që bëhet një Tregtar/Furnizues, përveçse bëhet Tregtar/Furnizues, do të mbetet një Palë e Regjistruar për qëllimet e këtij Kodi të Rrjetit.

3.4 Heqja nga Regjistri

- (a) Një Palë e Regjistruar që dëshiron të pushojë së qeni një Palë e Regjistruar mund të njoftojë me shkrim Transportuesin për qëllimin e saj për të pushuar së qeni një Palë e Regjistruar nëse nuk ka më ndonjë Kapacitet të Rezervuar. Transportuesi, jo më vonë se dhjetë Ditë Pune, pas marrjes së një njoftimi të tillë, do ta heqë atë Palë të Regjistruar nga Regjistri dhe do t'i konfirmojë me shkrim Palës së Regjistruar se nuk është më një Palë e Regjistruar.
- (b) Transportuesi mund të heqë një Palë të Regjistruar nga Regjistri dhe ti konfirmojë me shkrim asaj Palë të Regjistruar se nuk është më Palë e Regjistruar nëse:
- (i) pala e Regjistruar pushon së mbajturi një Limit të Kreditit të paktën prej Limitit Minimal të Kreditit derisa ky Person ka ndonjë Kapacitet Alternativ të Mbështetjes së Kreditit;
 - (ii) Marrëveshja e Transportit të Gazit ku kjo Palë e Regjistruar është një palë, duhet të ndërpritet nga Transportuesi para përfundimit të mandatit të saj dhe ajo Palë e Regjistruar nuk është palë në asnjë Marrëveshje tjetër për Transportin e Gazit;
 - (iii) një Palë e tillë e Regjistruar nuk dorëzon një përgjigje tek Transportuesi brenda 15 Ditë Pune që nga njoftimi i Transportuesit bazuar në Paragrafin 3.2 (a) ose, pas dorëzimit të çdo Dokumenti të rishikuar të Aplikimit nga një Palë e Regjistruar, Transportuesi (duke vepruar në diskrecionin e tij të plotë) vendos nëse versionet e rishikuara të atyre dokumentave vërtetojnë që ajo Palë e Regjistruar nuk i plotëson më kërkesat e përmendura më lart për tu bërë një Palë e Regjistruar; ose
 - (iv) nëse ajo Palë e Regjistruar nuk është një palë tek Marrëveshja e Transportit të Gazit, atëherë në lidhje me atë Palë të Regjistruar:
 - (A) ajo Palë e Regjistruar fillon vullnetarisht ndonjë procedurë ose paraqet ndonjë peticion që kërkon likuidimin, riorganizimin, shpërbërjen, prishjen, përbërjen, ose asistencë/lehtësi tjetër (përfshirë çdo peticion që kërkon shtyrjen e procesit të tillë ose dhënien e një moratoriumi) si pas çdo falimenti, paaftësie paguese, marrje në dorëzim, ose ligje të ngjashme, që zbatohen për atë Palë të Regjistruar ose që bie dakord me fillimin e ndonjë procesi ose paraqitjen e ndonjë peticioni ndaj saj, sipas ndonjë ligji të ngjashëm;
 - (B) ndonjë veprim të korporatës, procedurë ligjore ose ndonjë procedurë ose hap tjetër të ndërmarrë në lidhje me caktimin për përfitim të kreditorëve të asaj Palë të Regjistruar në kontekstin e paaftësisë paguese ose ajo pranon me shkrim paaftësinë e saj për të paguar borxhet e saj përgjithësisht në momentin që ato duhet të shlyhen, nuk paguan

- me borxhet e saj përgjithësisht kur ato duhet të shlyhen ose kur ato mbivendosen në kuptim Ligjeve në fuqi;
- (C) ajo Palë e Regjistruar miraton emërimin e një marrësi, personi të besuar, ose likuiduesi mbi pjesën e saj ose të ndonjë pjese të pasurive ose ndërmarrjeve të saj;
 - (D) një person paraqet një kërkesë ku kërkon likuidimin, riorganizimin, shpërbërjen, prishjen, përbërjen ose ndonjë lehtësim tjetër për atë Palë të Regjistruar ose dhënien e një moratoriumi në lidhje me atë Palë të Regjistruar sipas dispozitave të falimentimit, paaftësisë paguese, marrje, ose ligje të ngjashme që zbatohen për të, dhe kërkesa nuk hidhet poshtë brenda 60 ditëve pas dorëzimit;
 - (E) gjykata kompetente nxjerr një urdhër ose dekret që cakton një marrës, likuidues, ose një përfaqësues të besuar për atë Palë të Regjistruar ose ndonjë prej pronave të tij dhe marrësi, likuiduesi, ose përfaqësuesi i besuar nuk shkarkohet brenda 60 ditëve nga data e urdhrit ose dekretit;
 - (F) gjykata kompetente nxjerr një urdhër ose dekret që gjykon që Pala e Regjistruar që do të falimentojë ose nuk ka aftësi paguese ose do të japë një moratorium në lidhje me atë Palë të Regjistruar dhe urdhri ose dekreti nuk mbetet në fuqi ose anulohet brenda 60 ditëve nga data lëshimit të urdhërit ose dekretit;
 - (G) ajo Palë e Regjistruar shkakton ose i nënshtrohet ndonjë ngjarje në lidhje me të, e cila, sipas Ligjeve në fuqi të çdo juridiksioni, ka efekt analog me ndonjë nga ngjarjet e specifikuar në paragrafët (A) deri (F) më lart; ose
 - (H) ndonjë prej rrethanave të përcaktuara në Paragrafin 20.2 (a).
- (c) Heqja e një Personi nga Regjistri nuk ndikon tek të drejtat dhe detyrimet e këtij Personi si Tregtar/Furnizues ose Palë e Regjistruar të llogaritura para kësaj heqje duke përfshirë të drejtat e tij për ti kthyer Garancinë për Vlerësimin e Subjektit ose Kolateralin në para (**Cash**) sipas Paragrafit 4.6.

4. LIMITET E KREDITIT

4.1 Caktimi i një Limiti fillestar të Kreditit

- (a) Transportuesi, në lidhje me secilin Person që aplikon për t'u bërë një Palë e Regjistruar sipas Paragrafit 3.4 (a) dhe që përmbush një ose më shumë prej Kritereve të Limitit të Kreditit, do të vendosë një Limit të Kreditit për atë Person në përputhje me Nenin 4.3 dhe do të njoftojë atë Person mbi Limitin e Kreditit së tij tek Konfirmimi i Regjistrimit.
- (b) Personat që aplikojnë për t'u bërë një Palë e Regjistruar duhet të plotësojnë një ose më shumë prej kritereve të mëposhtme (së bashku, **Kriteret e Limitit të Kreditit**) përpara se t'i caktohet një Limiti Krediti nga Transportuesi në përputhje me Paragrafin 4.3:
- (i) ai Person ka një vlerë krediti që është e barabartë ose më e lartë se Vlera/Përqindja Minimale e Kreditit;
 - (ii) ai Person ka blerë një Garanci të Vlerësuar të Subjektit; ose
 - (iii) ai Person ka paguar të paktën Limitin Minimal të Kreditit të Kolateralit në para.
- (c) Një Person që ka plotësuar kriteret e kreditit bazuar tek të ardhurat neto për ofrimin e një garancie për Kapacitetin Alternativ të Mbështetjes së Kreditit do të konsiderohet se ka një Përqindje Minimale të Kreditit për këtë Kod të Rrjetit nëse ky Person plotëson kriterin për tu bërë një Garant i Vlerësuar i Subjektit (Rated Entity Guarantor).

4.2 Përditësim i Limiteve të Kreditit

Limiti i Kreditit të një Pale të Regjistruar mund të rristohet dhe rishikohet, për nivelin më të lartë ose më të ulët:

- (i) në çdo kohë, me kërkesë të asaj Pale të Regjistruar, nëse ajo Palë e Regjistruar:
 - (A) ka vendosur ose ka për qëllim të vendosë një mbështetje të re të kreditit e cila plotëson një ose më shumë prej Kritereve të Limitit të Kreditit; ose
 - (B) dëshiron të zvogëlojë mbështetjen e kreditit që ka, me kusht që ky zvogëlim nuk e ul Limitin e Kreditit poshtë Limitit Minimal të Kreditit ose të rezultojë në një Kredit të Disponueshëm më pak se zero;
 - (ii) në çdo kohë, nga Transportuesi, nëse në mënyrë të arsyeshme beson që një rivlerësim i Limitit të Kreditit aktualisht të caktuar për një Palë të Regjistruar do të çojë në zbritje të atij Limiti të Kreditit; dhe
 - (iii) si pjesë e një rivlerësimi vjetor të Limitit të Kreditit të caktuar tek të gjitha Palët e Regjistruara të cilën Transportuesi do ta zhvillojë në ose para datës 30 Qershor për çdo Vit Gazi.
- (b) Nëse Limiti i Kreditit i një Pale të Regjistruar duhet të rivlerësohet dhe rishikuar, si përshkruhet në paragrafët (a) (i) më sipër:
- (i) Pala e Regjistruar që kërkon rishikimin e Limitit të Kreditit duhet të njoftojë me shkrim Transportuesin që kërkon rishikimin e Limitit të tij të Kreditit dhe të përshkruajë me detaje tek njoftimi mbështetjen për kreditin e ri që plotëson një ose më shumë nga Kriteret e Limitit të Kreditit tashmë të përcaktuar ose që Pala e Regjistruar synon të përcaktojë;
 - (ii) Transportuesi duhet jo më vonë se dhjetë Ditë Pune pas marrjes së informacionit të dhënë në paragrafin (i) më lart, do të njoftojë Palën e Regjistruar:

- (A) në rastin e mbështetjes së re të kreditit që zbatohet aktualisht e vendosur e cila plotëson një ose më shumë nga Kriteret e Limitit të Kreditit, Limiti i rishikuar i Kreditit që aplikohet për Palët e Regjistruara nga Transportuesi; ose
 - (B) në rastin e mbështetjes së re të kreditit që Pala e Regjistruar synon të zbatojë në mënyrë që të plotësojë Kriteret e Limitit të Kreditit sapo të vendoset, Limiti i rishikuar i Kreditit që do të aplikohet për atë Palë të Regjistruar nga Transportuesi nëse vendoset mbështetja e re e propozuar e kreditit;
- (iii) pas marrjes së njoftimit të përcaktuar në paragrafin (ii) (B) më sipër, Pala e Regjistruar duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e kërkuara për të realizuar mbështetjen e re të kreditit dhe kur këto hapa të ndërmerren, duhet të njoftojë Transportuesin për realizimin e këtyre hapave, pas të cilave Transportuesi, brenda 10 Ditë Pune, duhet të njoftojë Palën e Regjistruar në lidhje me Limitin e rishikuar të Kreditit që i aplikohet asaj Pale të Regjistruar nga Transportuesi.
- (c) Nëse Limiti i Kreditit të një Pale të Regjistruar duhet të rivlerësohet, si përshkruhet në paragrafin (a) (ii) më sipër:
- (i) pala e Regjistruar duhet të bashkëpunojë me Transportuesin dhe ta sigurojë informacionin brenda kontrollit të saj pasi Transportuesi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për rivlerësim të atij Limiti të Kreditit; dhe
 - (ii) nëse një vlerësim i tillë rezulton në rishikim të Limitit të Kreditit, Transportuesi duhet të njoftojë Palën përkatëse të Regjistruar për:
 - (A) Arsyet se pse Transportuesi ka vendosur të rivlerësojë Limitin e Kreditit të Palës së Regjistruar; dhe
 - (B) Limitin e rishikuar të Kreditit që vjen si rezultat i atij rivlerësimi.
- (d) Nëse Limiti i Kreditit të një Pale të Regjistruar duhet riestuar dhe rishikuar, si përshkruhet në paragrafin (a) (iii) më lart, Transportuesi duhet të njoftojë çdo Palë të Regjistruar që i është rishikuar Limiti i Kreditit pas rivlerësimit të Limitit të rishikuar të Kreditit që rezulton nga ai rivlerësim.
- (e) Pa paragjykuar ndonjë të drejtë ose mjet juridik në dispozicion të Transportuesit sipas Marrëveshjeve për Transportin e Gazit, nëse një Palë e Regjistruar e ka Limitin e saj të Kreditit të rishikuar dhe si rezultat i atij Limiti të Kreditit, Krediti i Disponueshëm është më pak se zero, atëherë ajo Palë e Regjistruar duhet të ndërmarrë hapat e nevojshme për të rritur Limitin e saj të Kreditit në mënyrë që Krediti i saj i Disponueshëm të jetë të paktën zero.

4.3 Përcaktimi i Limitit të Kreditit

- (a) Nëse një Palë e Regjistruar ose një Person që po aplikon për tu bërë një Palë e Regjistruar plotëson të gjitha Kriteret e Limitit të Kreditit duke paraqitur një Përqindje Minimale të Kreditit, Limiti i Kreditit që do të aplikohet për atë Palë të Regjistruar ose Person (ose, nëse aplikohet, pjesa e Limitit të Kreditit që do ti atribuohet atij Kriteri të Limitit të Kreditit që do ti atribuohet Kriterit të Limitit të Kreditit), do të jetë më pak se:
- (i) Përqindja e Limitit të Kreditit e të Ardhurave Neto të asaj Pale të Regjistruar;
 - (ii) € 50,000,000 (pesëdhjetëmilion) (ose një shumë më e lartë duke qënë që Transportuesi mund të miratojë shprehimisht me shkrim së bashku me Palën e Regjistruar ose me Personin); dhe (iii) shuma (nëse ka një të tillë) që njoftohet nga Pala e Regjistruar ose Personi për Transportuesin si Limiti maksimal i Kreditit që dëshiron të ketë.
- (b) Nëse një Palë e Regjistruar ose Person që po aplikon për tu bërë një Palë e Regjistruar plotëson Kriterin e Limitit të Kreditit duke dhënë një ose më shumë Garanci të vlerësuar të Subjektit, Limiti i Kreditit

që do ti aplikohet asaj Pale të Regjistruar ose Personit (ose, nëse është e aplikueshme, pjesa e Limitit të Kreditit që do ti atribuohet atij Kriteri të Limitit të Kreditit) në lidhje me çdo garanci të tillë të një entiteti të vlerësuar do të jetë:

- (i) nëse ai Garantues i Vlerësuar i Subjektit (**Rated Entity Guarantor**) është një institucion i njohur financiar, çdo kufi mbi shumën në Euro që mund të kërkohet sipas asaj Garancie në përqindje të Subjektit (**Rated Entity Guarantee**); ose
- (ii) nëse ai Garantues i Vlerësuar i Subjektit nuk është një institucion i njohur financiar, limiti më i vogël nga:
 - (A) çdo limit i shumës në Euro që mund të kërkohet sipas Garancisë Financiare të Subjektit;
 - (B) Përqindja e Limitit të Kredisë të vlerës neto të garantuesit të një subjekti të vlerësuar;
 - (C) €50,000,000 (pesëdhjetëmilion) (ose një shumë më e lartë për të cilën Transportuesi mund të bie dakord shprehimisht me shkrim me Palën e Regjistruar ose me Personin); dhe
 - (D) shuma (nëse ka) që njoftohet nga Pala e Regjistruar ose Personi për Transportuesin si Limiti maksimal i Kreditit që dëshiron të ketë.
- (b) Nëse një Palë e Regjistruar ose një Person që po aplikon për tu bërë një Palë e Regjistruar plotëson Kriteret e Limitit të Kreditit duke përdorur Kolateral në para, Limiti i Kreditit që do ti aplikohet asaj Pale të Regjistruar ose Personi (ose, nëse është e aplikueshme, pjesa e Limitit të Kreditit që do ti atribuohet atij Kriteri të Limitit të Kreditit) do të jetë Balanca në para (Cash) e Palës së Regjistruar ose Personit. Përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht me shkrim ndryshe nga Transportuesi, një Palë e Regjistruar ose një Personi që po aplikon për tu bërë Palë e Regjistruar nuk mund të depozitojë Kolateral në para që do të rezultojë në bilancin e kolateralit në para të asaj pale ose personit të regjistruar mbi [500,000 €] (pesëqindmijë).
- (d) Nëse një Palë e Regjistruar ose një Person që po aplikon për tu bërë një Palë e Regjistruar plotëson më shumë se një Kriter të Limitit të Kreditit, Limiti i Kreditit që do të aplikohet për atë Pale të Regjistruar ose Person, do të jetë totali i pjesëve të Limitit të Kreditit që i aplikohen asaj Pale të Regjistruar sipas paragrafëve (a), (b) dhe (c) më sipër (sipas rastit).

4.4 Krediti në Dispozicion

- (a) Një Palë e Regjistruar që nuk ka asnjë Kapacitet të Rezervuar ose që ka vetëm Kapacitet Alternativ për Mbështetjen e Kreditit do të ketë Kredit të Disponueshëm të barabartë me Limitin e tij të Kreditit.
- (b) Krediti në Dispozicion i një Pale të Regjistruar do të zvogëlohet nga çdo sasi e Kapacitetit të Rezervuar (me përjashtim të Kapacitetit Alternativ të Mbështetjes së Kreditit) që kjo Palë e Regjistruar rezervon përmes ankandit ose merr me anë të Delegimit sipas llogaritjes së përcaktuar në Paragrafin 4.5.
- (c) Asnjë Palë e Regjistruar nuk mund të rezervojë përmes ankandit ose të marrë përmes Delegimit Kapacitet të Rezervuar që do të zvogëlonte Kreditin e tij të Disponueshëm në më pak se zero, pas llogaritjes së përcaktuar në Pjesën 4.5.
- (d) Nëse një Palë e Regjistruar rezervon Kapacitet të Rezervuar për një Tremujor të plotë të Gazit ose për Vit Gazi të ardhshëm i cili vjen menjëherë pas, llogaritja e Detyrimit të Palës së Regjistruar me qëllim përcaktimin nëse kushti në paragrafin (c) më sipër plotësohet për atë ankand do të llogaritet si më poshtë:
 - (i) detyrimi do të llogaritet sipas Pjesës 4.5 pa marrë parasysh Kapacitetin e Rezervuar; dhe
 - (ii) detyrimi do të rritet sipas një shumeje e cila është e barabartë me Detyrimin e llogaritur sipas Pjesës 4.5 por në rastin kur:
 - (A) M është Muaji i Gazit menjëherë pas fillimit të atij rezervimi; dhe

- (B) Detyrimet e vetme Mujore që merren parasysh janë Detyrimet Mujore për Kapacitetin që është Rezervuar.

Për të shmangur dyshimet, rregullimet e mësipërme do të aplikohen vetem në lidhje me ankandin ku është Rezervuar Kapaciteti dhe për qëllim të llogaritjes së paragrafit (c) më sipër. Sipas atij ankandi, çdo Kapacitet i Rezervuar do të merret parasysh për llogaritjen e Detyrimeve sipas Pjesës 4.5 pa rregullime.

4.5 Llogaritja e Kreditit të Disponueshëm

- (a) Krediti i Disponueshëm i një Pale të Regjistruar do të përditësohet çdo Ditë Gazi dhe menjëherë pas (i) rezervimit përmes ankandit të asaj Pale të Regjistruar ose marrjen përmes Delegimit të një Produkti të Kapacitetit (përveç Kapacitetit Alternativ të Mbështetjes së Kreditit) ose (ii) përditësimi i Limitit të Kreditit të asaj Pale të Regjistruar sipas Paragrafit 4.2 në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Krediti i Disponueshëm} = \text{Limiti i Kreditit} - \text{Borxhi}$$

ku:

Borxh nënkupton totalin (pa numërim të dyfishtë) të:

- (A) të gjitha shumave të papaguara të përcaktuara në Deklaratën Mujore që Transportuesi i ka lëshuar Tregtarëve/Furnizuesve; dhe
- (B) të gjitha Tarifave Mujore për të gjithë Kapacitetin e Rezervuar që Tregëtari/Transportuesi mban për çdo Muaj paraprak të Gazit (për të cilin nuk është nxjerrë një Deklaratë Mujore), Muajin aktual të Gazit dhe secilin nga 12 muajt pasardhës të Gazit, me një Shumëfish Krediti që aplikohet për secilin Tarifë Mujore për Muajt e Gazit deri në Muajin e tretë të Gazit pas muajit aktual të Gazit,
- në çdo rast duke përjashtuar çdo Detyrim Mujor për Kapacitetin Alternativ të Mbështetjes së Kreditit.
- (b) Për të llogaritur Borxhin e Tregëtarit/Furnizuesit do të aplikohet formula e mëposhtme:

$$\text{Borxhi} = \left[\sum_{m=X}^{M-1} UI_m \right] + \left[\sum_{m=M-1}^{M+3} MC_m \times \text{Credit Multiplier} \right] + \left[\sum_{m=M+4}^{M+12} MC_m \right]$$

ku:

- (i) **M** është muaji aktual i Gazit;
- (ii) **X** është muaji i hershëm i Gazit për të cilin ka Tarifa Mujore të papaguara;

UI_m është totali i shumave të papaguara në lidhje me çdo Deklaratë Mujore të nxjerrë për Kapacitetin e Rezervuar në një muaj **M** (përveç Kapacitetit Alternativ të Mbështetjes së Kreditit);

- (iii) **MC_m** është totali i të gjitha Tarifave Mujore për Tregëtarin/Transportuesin në lidhje me muajin **M** për të gjithë Kapacitetin e Rezervuar (përveç Kapacitetit Alternativ të Mbështetjes së Kreditit) i cili akoma nuk është përfshirë në Deklaratën Mujore të lëshuar për Tregëtarin/Furnizuesin; dhe
- (iv) **Credit Multiplier (shumëfishi i Kreditit)** nënkupton shumëfishin e kreditit që duhet aplikuar për Tarifat Mujore për çdo Produkt Kapaciteti deri në Muaj Gazi **M +3** të përcaktuar sikurse specifikohet më poshtë.

- (c) Shumëfishi i Kreditit pasqyron kostot në lidhje me Tarifat Mujore që Tregtarët/Furnizuesit do të kenë kur të përdorin Produktet e Kapacitetit, duke përfshirë kostot e Gazit Karburant, Gazin që nuk merret në konsideratë (UFG), Energjisë Elektrike dhe balancimit.

Shumëfishi i Kreditit do të jetë:

- (d) shifra e fundit e publikuar herë pas here në faqen e internetit të Transportuesit.
- (e) Vlera e Shumëfishit të Kreditit do të përditësohet në mënyrë periodike dhe të paktën çdo vit për të pasqyruar kostot aktuale dhe do të publikohet në faqën e internetit të Transportuesit.

4.6 Lëshimi i mbështetjes së kreditit (Aktit të garancisë)

Nëse një Person pushon së qeni një Palë e Regjistruar, Transportuesi do t'i kthejë atij Personi çdo Garanci të Vlerësuar të Subjektit të marrë nga ky Person dhe cdo Gjendje/Balance Kolaterale në para në lidhje me atë Person brenda 30 ditëve pas likuidimit në kohë të pagesave nga ky Person janë lëshuar plotësisht në mënyrë të pakthyeshme dhe asnjë shumë tjetër nuk mund të bëhet e pagueshme.

4.7 Garancitë e Vlerësuara të Subjektit me një datë përfundimi

- (a) Ne pjesën 4.7:

Shuma e zëvendësimit nënkupton, në lidhje me Garancinë e Vlerësuar të Subjektit, më e vogël se:

- (i) shumën e mbetur e pa tërhequr e Garancisë së Vlerësuar të Subjektit; dhe
 - (ii) shumën që kërkohet për të siguruar që pas datës së përfundimit të Garancisë së Vlerësuar të Subjektit Limiti i Kreditit të Palës përkatëse të Regjistruar mbahet në fuqi me atë datë përfundimi (në rastet kur është e përshtatshme ulet në përputhje me Paragrafin 4.2(a) (i) (B)) duke patur parasysh çdo mbështetje krediti në fuqi në atë kohë.
- (b) Përveç marrëveshjes paraprake me shkrim të Transportuesit, Garancia e Vlerësuar e Subjektit mund të përmbajë një datë skadimi vetëm nëse:
- (i) Garantuesi përkatës i Vlerësuar i Subjektit është një institucion financiar i njohur me reputacion;
 - (ii) data e përfundimit nuk është më herët se 364 ditë pas datës së lëshimit të Garancisë së Vlerësuar të Subjektit; dhe
 - (iii) kjo Garanci e Vlerësuar e Subjektit lejon kryerjen e kërkesës sipas paragrafit (d) më poshtë dhe është në përputhje me kërkesat e tjera të këtij Kodi të Rrjetit.
- (c) Nëse ofrohet nga Pala e Regjistruar dhe pranohet nga Transportuesi, Garancia e Vlerësuar e Subjektit me një datë përfundimi, atëherë Pala përkatëse e Regjistrimit duhet ti ofrojë Transportuesit një Garanci zëvendësuese të Vlerësuar të Subjektit jo më vonë se 20 ditë para datës së përfundimit të Garancisë së Vlerësuar të Subjektit e cila:
- (i) është në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit;
 - (ii) ka një vlerë nominale të paktën të barabartë me shumën e zëvendësimit dhe hyn në fuqi jo më vonë se përfundimi i Garancisë së Vlerësimit të Subjektit.

(d) Nëse Pala e Regjistruar nuk e zëvendëson Garancinë për Vlerësimin e Subjektit kur kjo kërkohet sipas paragrafit (c) më sipër, Transportuesi duhet të kryejë një kërkesë për përfundimin e Garancisë së Vlerësimit të Projektit për Shumën e Zëvendësimit. Procedurat për këtë kërkesë duhet të paguhet tek Llogaria Kolaterale në para dhe duhet të trajtohen si Kolateral në Para që depozitohet nga Pala përkatëse e Regjistruar.

5. PRODUKTET E KAPACITETIT

5.1 Kapaciteti i Disponueshëm si Produkt i Kapacitetit

- (a) Transportuesi, që nga Data e Fillimit të Funkcionimit e në vazhdim, do të:
- (i) ofrojë Kapacitet të Disponueshëm për Palët e Regjistruara për të blerë në formën e Produkteve të Kapacitetit, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi të Rrjetit;
 - (ii) sigurojë që Kapaciteti i Disponueshëm në lidhje me çdo Pikë Interkonjeksioni të jetë, për secilin ankand të publikuar në Platformën e Rezervimit të Kapaciteteve; dhe
 - (iii) sigurojë që Tarifa që është e aplikueshme për çdo Produkt të Kapacitetit që ofrohet nga Transportuesi të jetë e publikuar në faqen e tij të internetit.
- (b) Palët e Regjistruara duhet të nënshkruajnë një Marrëveshje për Transportin e Gazit me Transportuesin në mënyrë që të blejnë Produktet e Kapacitetit. Proçedura për rezervimin e Produkteve të Kapacitetit dhe nënshkrimin të Marrëveshjeve për Transportin e Gazit është e përcaktuar në Nenin 6.

5.2 Kapaciteti në drejtimin përpara i sigurt

- (a) Transportuesi do të vërë në dispozicion Kapacitetin në drejtimin përpara të pandërprerë afatgjatë në secilën Pikë Interkonjeksioni nëse kërkohet në përputhje me Testimet e Tregut.
- (b) Transportuesi do t'i ofrojë Produktet e mëposhtme të Kapacitetit për Kapacitet në drejtimin Përpara të pandërprerë afatshkurtër për blerje nga Palët e Regjistruara, me kusht që të ketë mjaftueshëm Kapacitet të Disponueshëm:
- (i) Kapaciteti vjetor në drejtimin përpara të pandërprerë;
 - (ii) Kapaciteti tremujor në drejtimin përpara i pandërprerë;
 - (iii) Kapaciteti mujor në drejtimin përpara i pandërprerë; dhe
 - (iv) Kapaciteti ditor në drejtimin përpara i pandërprerë.
- (c) Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Pandërprerë ofrohet në mënyrë të pavarur në çdo Pikë të Interkonjeksionit dhe si pasojë Palët e Regjistruara duhet të rezervojnë në mënyrë të veçantë Kapacitetin në drejtimin përpara të pandërprerë në Pikat e kërkuara Hyrëse dhe/ose Dalëse.

5.3 Kapaciteti në drejtimin përpara i ndërprerë

- (a) Produkti i vetëm i Kapacitetit në drejtimin përpara të ndërprerë ofruar nga Transportuesi është Kapaciteti në Drejtimin Përpara për ditën në avancë. Ky kapacitet për Drejtimin Përpara të Pikës së Interkonjeksionit do të ofrohet për blerje Palëve të Regjistruara nga Transportuesi në një Pikë Interkonjeksionit vetëm në rastin kur nuk ka Kapacitet në Dispozicion për Kapacitetin në drejtimin përpara të ndërprerë në atë Pikë të Interkonjeksionit.
- (b) Kapaciteti në drejtimin përpara i ndërprerë ofrohet në mënyrë të pavarur në çdo Pikë të Interkonjeksionit dhe si pasojë Palët e Regjistruara duhet të rezervojnë në mënyrë të veçantë Kapacitetin në drejtimin përpara të ndërprerë në Pikat e kërkuara Hyrëse dhe/ose Dalëse.
- (c) Kapacitet në Drejtimin Përpara i Ndërprerë është një produkt i ndërprerë sipas Paragrafit 12.5.

5.4 Kapaciteti Tregtar në drejtim të kundërt (Revers)

- (a) Transportuesi do të ofrojë Kapacitet Tregtar në drejtim të kundërt (Revers) i cili rezulton në një Rrjedhë (Tregtare) në drejtim të Lindjes sipas çdo Rruge Tregtare në drejtim të kundërt (Revers).

- (b) Transportuesi, duke qenë se aty ka mjaftueshëm Kapacitet të Disponueshëm, do të ofrojë Produktet e mëposhtme të Kapacitetit për Kapacitetin Tregtar në drejtim të kundërt për tu blerë nga Palët e Regjistruara:
- (i) Kapacitet Tregtar në drejtim të kundërt (Revers) Vjetor;
 - (iii) Kapacitet Tregtar në drejtim të kundërt (Revers) Tremujor;
 - (iv) Kapacitet Tregtar në drejtim të kundërt (Revers) Mujor dhe
 - (v) Kapacitet Tregtar në drejtim të kundërt Ditor.
- (c) Një Palë e Regjistruar që dëshiron të rezervojë Kapacitetin Tregtar në drejtim të kundërt (Revers) duhet ta rezervojë si një kombinim të sasive të barabarta të Kapacitetit të Rezervuar tek një Pikë Hyrëse dhe një Pikë Dalëse. Kombinimet e lejueshme të Pikave Hyrëse dhe atyre Dalëse janë të përcaktuara në Tabelën B në Shtojcën 2. Çdo kombinim i tillë njihet si Rruga Tregtare në drejtim të kundërt (Revers).
- (d) Kapaciteti Tregtar në drejtim të kundërt (Revers) është një produkt i ndërprerë sipas Paragrafit 12.4.

5.5 Rrjedha në drejtim të kundërt (Reverse)

Transportuesi do të sigurojë Rrjedhë në drejtim të kundërt (Revers) vetëm në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme. Rrjedha në drejtim të kundërt (Revers) nuk ofrohet si Produkt Tregtar.

6. REZERVIMI I KAPACITETIT

6.1 Aksesi tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit

- (a) Përvec (i) si përcaktohet në Paragrafin 1.2 në lidhje me Mekanizmin e Alokimit të Kapacitetit Fillestar dhe (ii) për Produktet e Kapacitetit të rezervuara sipas një Testimi të Tregut, nëse një Palë e Regjistruar dëshiron të rezervojë Kapacitet të Rezervuar duhet ta bëjë nëpërmjet Platformës së Rezervimit të Kapacitetit. Është përgjegjësia e çdo Pale të Regjistruar për të pranuar dhe për tu pajtuar me kërkesat për aksesin tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit, si përcaktohet tek termat dhe kushtet e Platformës së Rezervimit të Kapacitetit.
- (b) Nëse Transportuesi publikon një formular të ri të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme ose Konfirmimin e Transportit në faqen e tij të internetit atëherë një Palë e Regjistruar mund të mos rezervojë Produkte të reja të Kapacitetit në asnjë ankand që zhvillohet pas datës në të cilën Transportuesi lajmëron Palët e Regjistruara se një Marrëveshje e tillë Aktuale për Transportin e Gazit do të aplikohet vetëm nëse bie dakord me termat e kësaj Marrëveshjeje për Produktet e reja të Kapacitetit. Çdo Palë e Regjistruar që nuk jep konfirmimin e saj tek formulari i dhënë nga Transportuesi nuk mund të rezervojë Produkte të Reja të Kapacitetit pas asaj date deri sa të jepet një konfirmim i tillë.
- (c) Duke pranuar Produktet e Kapacitetit tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit, Tregëtarët/ Furnizuesit ekzistues me një Marrëveshje aktuale në fuqi për Transportin e Gazit për të njëjtin lloj të Produktit të Kapacitetit (Kapacitet Afatgjatë në drejtimin përpara të Pandërprerë, Kapacitet Afatshkurtër në drejtimin përpara të Pandërprerë, Kapacitet në drejtimin përpara të Ndërprerë ose Kapacitet Tregtar në drejtim të kundërt (Revers)), do të shtojnë Kapacitet Rezervë tek Marrëveshjet e tyre ekzistuese për Transportin e Gazit e cila është një Marrëveshje aktuale për Transportin e Gazit.
- (d) Palët e Regjistruara të cilat nuk kanë një Marrëveshje Aktuale në fuqi për Transportin e Gazit për të njëjtin lloj Produkti të Kapacitetit, kur të pranojnë Produktet e Kapacitetit tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit, do të nënshkruajnë një Marrëveshje për Transportin e Gazit me Transportuesin në formën e një Marrëveshje Aktuale për Transportin e Gazit.
- (e) Transportuesi do të publikojë procedurat për alokimin e kapacitetit të kthyer mbrapsht në faqen e tij të internetit për të aplikuar në rast se nuk është në dispozicion Platforma për Rezervimin e Kapacitetit.

6.2 Kalendari i Ankandit

Produktet e Kapacitetit do të ofrohen për tu pranuar nëpërmjet Platformës për Rezervimin e Kapacitetit sipas Paragrafit 6 dhe Kalendarit të Ankandit ENTSOG i cili përditësohet çdo vit dhe do të publikohet në faqen e internetit të Transportuesit.

6.3 Rezervimi i Kapacitetit në Drejtimin Para

- (a) Palët e Regjistruara mund të blejnë Produkte të Kapacitetit për Kapacitetin në drejtimin përpara nëpërmjet ankandeve të zhvilluara sipas Platformës për Rezervimin e Kapaciteteve.
- (b) Transportuesi do të ofrojë Produktet e mëposhtme të Kapacitetit për Kapacitetin në drejtimin përpara të pandërprerë të renditura më poshtë sipas përparësisë në secilën Pikë Interkonjeksioni për aq sa të ketë mjaftueshëm Kapacitet të mbetur të Disponueshëm për të vendosur ato Produkte të Kapacitetit duke ju nënshtruar kufizimeve të konkurrencës të përcaktuara në paragrafin (d) më poshtë:
 - (i) Kapacitet në drejtimin përpara të pandërprerë Vjetor për çdo 15 vitet pasardhëse të Gazit në ankandet vjetore;
 - (ii) Kapacitet në drejtimin përpara të pandërprerë Tremujor për çdo Tremujor të Gazit në të njëjtin Vit Gazi në ankandet tremujore që përsëriten;
 - (iii) Kapacitet në drejtimin përpara të pandërprerë Mujor për Muajin pasardhës të Gazit në ankandet mujore; dhe
 - (iv) Kapacitet në drejtimin përpara të pandërprerë Ditor në bazë të Ditës në Avancë tek ankandet ditore.

- (c) Transportuesi do të ofrojë Kapacitet në drejtimin përpara të ndërprerë të Ditës në Avancë në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkonjeksionit për një pikë të caktuar Interkonjeksioni dhe Ditë Gazi nëpërmjet një ankandi ditor vetëm nëse i gjithë Kapaciteti i Disponueshëm për Kapacitetin në drejtimin përpara të pandërprerë për atë Pikë të Interkonjeksionit dhe Ditë Gazi është rezervuar i gjithi. Transportuesi do të ofrojë Kapacitet në Drejtimin Përpara të Ndërprerë të Ditës në Avancë në Drejtim të Kundërt të Pikës së Interkonjeksionit për Pikat e Interkonjeksionit në Komotini dhe Nea Mesimvria për një Ditë të veçantë të Gazit përmes ankandit ditor për aq kohë sa ka Kapacitet të mjaftueshëm në Dispozicion për të akomoduar këtë ofertë dhe sipas limiteve të konkurimit të vendosura në Paragrafin 6.4(d).
- (d) Duke qenë se disponueshmëria e produkteve të Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Pandërprerë në një Pikë të caktuar Interkonjeksioni mund të kufizohet nga disponueshmëria e plotë e një Rrjedhjeje në drejtim të perëndimit (Westward Flow) dhe rezervimi i produkteve të Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Pandërprerë në Pika të tjera Interkonjeksioni përgjatë rrugës së Sistemit të Transportit të TAP, Transportuesi nuk mund të sigurojë të gjithë Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë të ofruar për një Produkt specifik të Kapacitetit dhe Pike Interkonjeksioni në një ankand. Si pasojë e këtyre kufizimeve në Rrjedhën në drejtim të Perëndimit, rezervimi i Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Pandërprerë për çdo Produkt të Kapacitetit dhe Pikë Interkonjeksioni do t'i nënshtrohet ankandëve konkurruese me të njëjtin Produkt të Kapacitetit për Pikat e tjera Dalëse. Ankandet konkurruese do të drejtohen në përputhje me rregullat e Platformës së Rezervimit të Kapacitetit dhe me kriterin e vendosur nga Transportuesi, të miratuar nga Autoritetet Rregullatore dhe të publikuar në faqen e internetit të Transportuesit.

6.4 Rezervimi i Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers)

- (a) Palët e Regjistruara mund të blejnë Produkte të Kapacitetit për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) nëpërmjet ankandëve të zhvilluara sipas Platformës së Rezervimit të Kapaciteteve. Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) duhet rezervuar si një kombinim i veçantë i Kapacitetit të Rezervuar në çdo Pikë Hyrëse dhe Dalëse që formojnë një Rrugë Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers). Ankandet do të zhvillohen për çdo Rrugë të mundshme Tregtare në Drejtim të Kundërt.
- (b) Transportuesi do të ofrojë Produktet e mëposhtme të Kapacitetit për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë për çdo Rrugë Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) për aq sa të ketë mjaftueshëm Kapacitet të mbetur në Dispozicion në të dyja Pikat e Interkonjeksionit të cilat formojnë një Rrugë Komerciale në Drejtim të Kundërt (Revers) për të vendosur ato Produkte të Kapacitetit dhe ti nënshtrohet kufizimeve të konkurrencës të përcaktuara në paragrafin (c) më poshtë:
- (i) Kapacitet Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) Vjetor për secilin nga 15 Vitet Pasardhëse të Gazit në ankandet vjetore;
- (ii) Kapacitet Komercial Tremujor në Drejtim të Kundërt (Revers) për çdo Tremujor të Gazit në ankandet vjetore;
- (iii) Kapacitet Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) Mujor për Muajin pasardhës të Gazit në ankandet mujore; dhe
- (iv) Kapacitet Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) në bazë të Ditës në Avancë në ankandet ditore.
- (c) Duke qenë se ankandet për Rrugë të ndryshme Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) mund të jenë duke konkuruar për të njëjtin Kapacitet të Disponueshëm në një Pikë specifike të Interkonjeksionit, Transportuesi mund të mos sigurojë të gjithë Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) të ofruar për një Rrugë Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) në një ankand. Si pasojë e këtyre kufizimeve në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkonjeksionit, rezervimi i Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) për çdo Produkt të Kapacitetit dhe Rrugë Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) do të nënshtrohet ankandëve konkurruese me të njëjtin Produkt të Kapacitetit për Rrugë të tjera Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) të cilat përfshijnë një Pikë të përbashkët Interkonjeksioni në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkonjeksionit. Kufizimet e kapacitetit do të dakordësohen me OST Fqinj

dhe do të njoftohen nga Transportuesi tek Platforma e Rezervimit të Kapaciteteve, e cila do të marrë në konsideratë këto kufizime si pjesë të ankandeve konkurruese për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers). Ankandet konkurruese do të drejtohen në përputhje me rregullat e Platformës së Rezervimit të Kapaciteteve dhe kritereve të dhëna nga Transportuesi, të miratuara nga Autoritetet Rregullatore dhe të publikuara në faqen e internetit të Transportuesit.

- (d) Duke qenë se ankandet për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në avancë të Ndërprerë për Drejtimin e Kundërt (Revers) të Interkonjeksionit në Nea Mesimvria mund të konkurojnë për të njëjtin Kapacitet në Dispozicion si Pikë Tregtare në Drejtim të Kundërt që ka Nea Mesimvria si Pikë Interkonjeksioni, Transportuesi mund të mos jetë në gjendje të ofrojë të gjithë Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë dhe Kapacitetin Tregtar Ditor në Drejtim të Kundërt të ofruar për Nea Mesimvria si Pikë Hyrje. Si rezultat i këtyre kufizimeve, rezervimi i Kapacitetit Tregtar Ditor në Drejtim të Kundërt për Pikën Tregtare në Drejtim të Kundërt që përfshin Nea Mesimvria si Pikë Hyrje do të nënshtrohet ankandeve konkurruese për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë në Drejtimin e Kundërt të Pikës së Interkonjeksionit në Nea Mesimvria. Kufimet e kapacitetit do të dakordësohen me OST fqinje dhe do të njoftohen nga Transportuesi tek Platforma për Rezervimin e Kapacitetit, që do të marrë parasysh këto kufizime si pjesë e ankandeve konkurruese. Ankandet Konkurruese do të drejtohen sipas rregullave të Platformës së Rezervimit të Kapacitetit dhe kritereve që do të zhvillohen nga Transportuesi, të miratuara nga Autoritetet Rregullatore dhe do të publikohen në faqen e internetit të Transportuesit.

6.5 Grupimi i Kapaciteteve (Bundling)

- (a) Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Pandërprerë do të ofrohet si Kapacitet i Grupuar në çdo Pikë Interkonjeksioni me përjashtim të pikës Kipoi, në atë shkallë që kapaciteti të jetë i disponueshëm në të dyja anët e Pikës së Interkonjeksionit. Nëse sasia e një Produkti specifik të Kapacitetit për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë e ofruar në një Pikë Interkonjeksioni nga Transportuesi ndryshon nga sasia e ofruar nga OST Fqinje për të njëjtin produkt standart të kapacitetit, zbritja e të dyja sasive do të ofrohet si Kapacitet i Grupuar dhe kapaciteti që do të mbetet do të ofrohet si kapacitet jo i Grupuar në anët përkatëse të Pikës së Interkonjeksionit.
- (b) Kapaciteti i Grupuar në secilën Pikë përkatëse të Interkonjeksionit do të ofrohet përmes ankandeve të zhvilluara sipas Platformës së Rezervimit të Kapacitetit. Palët e Regjistruara mund të rezervojnë kapacitet në drejtimin përpara në secilën anë të një Pike përkatëse të Interkonjeksionit si Kapacitet të Grupuar nëpërmjet një procedure të vetme rezervimi për çdo Pikë Interkonjeksioni.
- (c) Çmimi Fillestar për çdo Kapacitet në Drejtimin Përpara të Pandërprerë ofruar si Kapacitet i Grupuar do të jetë totali i Çmimit Fillstar të TAP dhe çmimit rezerve për produktet përkatëse të kapacitetit të ofruara nga OST Fqinje në përputhje me rregullat tarifore të OST Fqinje përkatëse.
- (d) Transportuesi do të bashkëpunojë me OST Fqinje përkatëse për të rritur Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pandërprerë që është në dispozicion si Kapacitet i Grupuar i ofruar në çdo Pikë Interkonjeksioni përveç pikës Kipoi.
- (e) Transportuesi synon që Kapaciteti i Dorëzuar dhe ai i Tërhequr që formojnë Kapacitetin e Grupuar të mbeten të grupuar kur të ofrohet si Kapacitet në Dispozicion. Megjithatë, si rezultat i procesit të ankandit në të cilin Kapaciteti i Dorëzuar ose i Tërhequr ofrohet, ky Kapacitet i Grupuar mund të mos jetë i tillë në rastet kur:
- (i) sasia e Kapacitetit në Dispozicion që nuk është Kapacitet i Dorëzuar ose i Tërhequr ofruar nga Transportuesi ndryshon nga kapaciteti ekuivalent i disponueshëm i ofruar nga OST Fqinje në atë ankand;
- (ii) rendi i alokimit të kapacitetit të disponueshëm të OST Fqinje ndryshon nga rendi i përcaktuar në Paragrafin 13.2(e); ose

- (iii) proçedurat që aplikohen për rialokimin e Kapacitetit të Tërhequr si Kapacitet i Tërhequr nga Transportuesit duke u ofruar në ankande të ndryshme si Kapaciteti i tërhequr ekuivalent e ofruar nga OST Fqinje.
- (f) Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) dhe Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Ndërprerë nuk do të ofrohen si Kapaciteti i Grupuar.

6.6 Proçedura e Ankandëve

- (a) Ankandet e Kapacitetit në drejtimin Përpara të Pandërprerë, përveç Kapacitetit në drejtimin Përpara të Pandërprerë Ditor, do të aplikojnë një algoritëm “**ascending clock auction algorithm**” që lejon Palët e Regjistruara të vendosin ofertat e sasisë ndaj çmimeve të përshkallëzuara të shpallura në raundet e njëpasnjëshme të ankandit, duke filluar nga Çmimi Fillestar. Ankandet “**ascending clock**” do të zhvillohen në përputhje me proçedurat dhe algoritmin e përcaktuar tek Kodi i Rrjetit CAM.
- (b) Ankandet për Kapacitetin në drejtimin Përpara të Pandërprerë Ditor, Kapacitetin në drejtim të kundërt (Revers) Ditor dhe Kapacitetin në drejtimin Përpara të Ndërprerë të Ditës në Avancë do të aplikojnë një algoritëm ankandi për një çmim të përbashkët, sipas të cilit ekziston një raund i vetëm ofertash tek i cili Palët e Regjistruara ofertojnë Çmimin, si dhe sasinë e kapacitetit. Ankandet për këto çmime do të bëhen në përputhje me proçedurat dhe algoritmin e përcaktuar në Kodin e Rrjetit të Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit (EU) 2017/459 / Kodin e Rrjetit CAM.
- (c) Transportuesi do të pranojë vetëm oferta që janë, në përputhje me Paragrafin 4.4, brenda Kreditit të Disponueshëm të Palës së Regjistruar.

6.7 Publikimi i rezultateve të ankandit

Rezultatet e ankandit do të publikohen tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit pasi të mbyllet çdo raund ofertash sipas afateve të Platformës së Rezervimit të Kapacitetit. Palët e Regjistruara do të njoftohen individualisht në lidhje me Kapacitetin e Rezervuar që ata kanë rezervuar në ankandin përkatës. Transportuesi do të vërë në dispozicion informacione për rezultatet e ankandit duke e publikuar informacionin në faqen e tij të internetit.

6.8 Çmimi i Ankandit

- (a) Për Kapacitetin e Grupuar, nëse një ankand rezulton në një Çmim Ankandi, atëherë Çmimi i Ankandit do të ndahet midis Transportuesit dhe OST Fqinje sipas një alokimi në përqindje që njoftohet nga Platforma e Rezervimit të Kapacitetit. Ky alokim në përqindje do të dakordësohet midis Transportuesit dhe OST-së Fqinje përkatëse dhe do të nënshtrohet miratimit nga Autoritetet Rregullatore përkatëse. Për Produktet e Kapacitetit që nuk ofrohen si Kapaciteti i Grupuar, shumata e plotë e Çmimit të Ankandit do të kalohet për Transportuesin.
- (b) Pjesa e Transportuesit për çdo Çmim Ankandi, së bashku me Çmimin Fillestar të TAP, do të bëhet pjesë e Tarifës që do paguhet nga Tregëtarët / Furnizuesit sipas Marrëveshjes për Transportin e Gazit.

6.9 Testimi i Tregut për Kapacitetin e Zgjerimit

- (a) Transportuesi do të zhvillojë Testime të Tregut të paktën çdo dy vjet që nga data e fillimit e operacioneve Tregtare, sipas udhëzimeve të miratuara nga Autoritetet Rregullatore dhe të publikuara herë pas here në faqen e internetit të Transportuesit.
- (b) Proçedurat e Testimit të Tregut do të jenë specifike për Sistemin e Transportit të TAP dhe do të zhvillohen duke marrë në konsideratë rregullat dhe kërkesat e aplikueshme të Përjashtimit.

7. TREGU SEKONDAR

7.1 Akses në Tregun Sekondar

- (a) **Tregu Sekondar** është tregtimi i Kapacitetit të Rezervuar midis një Tregtari/Furnizuesi Ofertues dhe një Palë tjetër të Regjistruar e cila do të bëhet si një Delegim ose Transferim.
- (b) Transportuesi do të lehtësojë tregtimin e Kapacitetit të Rezervuar në tregun sekondar për Palët e Regjistruara:
 - (i) në lidhje me Transferimet, duke përdorur Platformën e Rezervimit të Kapacitetit; dhe
 - (ii) në lidhje me Delegimet, sipas procedurës së përcaktuar në Paragrafin 7.3,

duke i mundësuar një Tregtari/Furnizuesi tregtimin e të gjithë ose një pjesë të Kapacitetit të tij të Rezervuar. Çdo transfertë e tillë i nënshtrohet termave specifike që kanë të bëjnë me të tilla tregëtime të përcaktuara në Marrëveshjen përkatëse të Transportit të Gazit.

- (c) Nëse një Palë e Regjistruar dëshiron të ketë akses tek Kapaciteti i Rezervuar me anë të një Transferimi, ajo duhet ta bëjë atë përmes Platformës së Rezervimit të Kapaciteteve. Është përgjegjësi e secilës Palë të Regjistruar që synon të marrë Kapacitet të Rezervuar me anë të Transferimit të pranojë dhe të përmbushë kërkesat e aksesit të Platformës së Rezervimit të Kapaciteteve, siç përcaktohet në termat dhe kushtet e Platformës së Rezervimit të Kapaciteteve.
- (d) Nëse një Palë e Regjistruar dëshiron të pranojë një Delegim të të gjithë ose të një pjese të ndonjë Kapaciteti të Rezervuar, ajo duhet ta bëjë këtë duke plotësuar një Formular Delegimi në përputhje me Paragrafin 7.3.

7.2 Proçedura e Transferimeve

- (a) Transportuesi do të sigurojë që Platforma e Rezervimeve të Kapaciteteve të mbështesë proçedurat e mëposhtme për Transferimet e Kapaciteteve të Rezervuara:
 - (i) Tregtinë sipas kontratave të brendshme afatgjata (Over-the-Counter/OTC), ku një Transportues Ofertues dhe një Palë e Regjistruar tregtojnë në mënyrë bilaterale;
 - (ii) Thirrjen për Urdhra (Call for Orders/CFO), kur një Tregtar/Furnizues Ofertues paraqet një propozim Transferimi të hapur ndaj përgjigjeve të Palëve të Regjistruar dhe zgjedh përgjigjen që ai pranon; dhe
 - (iii) I shërbehet të parit atij që vjen i pari (First Come First Served /FCFS), kur një Tregtar/Furnizues Ofertues paraqet një propozim Transferimi të hapur ndaj përgjigjeve të Palëve të Regjistruara dhe automatikisht pranon përgjigjet bazuar në rendin në të cilin janë marrë ato përgjigje.
- (b) Për proçedurën e Thirrjes Për Urdhëra (CFO), një Transportues mund të krijojë një listë të palëve të të tjera mundshme tek Platforma e Rezervimit të Kapacitetit.
- (c) Një Tregtar/Furnizues mund të tërheqë propozimin e tij të Transferimit përpara se të marrë një përgjigje nga një Palë e Regjistruar, por jo më pas.
- (d) Nëse një Transportues Ofertues dhe një Palë e Regjistruar konfirmojnë një tregti të përputhshme të bërë si një Transferim, Tregtari/Furnizuesi Ofertues duhet të njoftojë Transportuesin përmes Platformës së Rezervimit të Kapacitetit. Njoftimi nga Tregtari/Furnizuesi Ofertues duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm në lidhje me një Transferim:
 - (i) Pika e Interkonjeksionit;

- (ii) Produkti i Kapacitetit;
 - (iii) Sasia e Kapacitetit të Rezervuar që i nënshtrohet Transferimit dhe kohëzgjatja e Transferimit; dhe
 - (iv) Pala e Regjistruar që merr të drejtat për Kapacitetin e Rezervuar që i nënshtrohet Transferimit.
- (e) Pas marrjes së njoftimit të Transferimit, Transportuesi do të verifikojë Transferimin brenda një Dite të plotë Pune, nëse Transferimi është në përputhje me kushtet për Transferimet e Kapaciteteve të Rezervuara, të përcaktuara në Paragrafin 7. Transferimet e përfunduara do të regjistrohen dhe publikohen tek Platforma përkatëse e Rezervimit të Kapacitetit.

7.3 Proçedura për Delegime

- (a) Një Tregtar/Furnizues Ofertues që dëshiron të transferojë të drejtat dhe detyrimet që lidhen me Kapacitetin e Rezervuar përmes një Delegimi dhe Pala e Regjistruar që dëshiron të marrë ato të drejta dhe detyrime (**i Deleguari Potencial**) do t'i plotësojnë Transportuesit një Formular Delegimi jo më vonë se 33 Ditë Pune para datës së propozuar të këtij Delegimi.
- (b) Formulari i Delegimit duhet të përmbajë konfirmimet e mëposhtme:
- (i) nga Tregtari/Furnizuesi Ofertues dhe i Deleguari i Mundshëm, që Delegimi i propozuar plotëson kushtet në Paragrafet 4.7.3, 4.7.6 dhe 4.7.9 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët;
 - (ii) nga i Deleguari i Mundshëm, nëse Delegimi i propozuar ka lidhje me Kapacitetin e Rezervuar sipas një Marrëveshjeje Fillestare për Transportin e Gazit, që pajtohet me paragrafin 4.1.1 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët në lidhje me transportin e Gazit Natyror duke përdorur Kapacitetin e Rezervuar që i nënshtrohet Delegimit; dhe
 - (ii) nga Tregtari/Furnizuesi Ofertues dhe i Deleguari i Mundshëm, në lidhje me një Delegim të propozuar të Kapacitetit në Drejtimin Përpara Afatgjatë në Pikën e Interkonjeksionit në Melendugno dhe ku kërkohet sipas paragrafit 4.7.2 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët dhe në përputhje me Ligjin Italian në fuqi, që Tregtari/ Furnizuesi Ofertues dhe / ose i Deleguari Potencial kanë dorëzuar një aplikim pranë Ministrisë Italiane të Zhvillimit Ekonomik (ose një organi të tillë pasues) për autorizimin paraprak të Delegimit të propozuar, kusht i Transportuesit për të pranuar Delegimin e propozuar që një autorizim i tillë është marrë nga Tregtari/Furnizuesi Ofertues dhe / ose i Deleguari i Mundshëm dhe i është përcjellë Transportuesit.
- (c) Transportuesi, brenda dy Ditë Pune pas marrjes së një Formulari Delegimi, duhet të konfirmojë Tregtarit/ Furnizuesit Ofertues dhe të Deleguarit Potencial nëse Formulari Delegimit është plotësuar si duhet ose jo.
- (d) Pas marrjes së Formulari të Delegimit të plotësuar siç duhet, Transportuesi duhet të vendosë nëse Delegimi i propozuar për të Deleguarin e Mundshëm plotëson kushtet e përcaktuara në Paragrafin 7.4 (përfshirë termat dhe kushtet për Delegimin të përcaktuara tek Marrëveshja përkatëse për Transportin e Gazit). Nëse, sipas Marrëveshjes përkatëse për Transportin e Gazit, kërkohet miratimi i Tregtarit / Furnizuesit për një Marrëveshje, duhet miratimi i Transportuesit për Delegimin, Transportuesi duhet ta ushtroje miratimin sipas termave të Marrëveshjes për Transportin e Gazit.
- (e) Transportuesi rezervon të drejtën që sipas gjykimit të tij për një Delegim të Mundshëm të këshillohet menjëherë me Rregullatorët për Delegimin e mundshëm, kur kërkohet nga Transportuesi për të siguruar që Delegimi nuk është në kundërshtim të kushteve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët apo ndonjë Ligji tjetër përkatës. Në rast të një konsultimi të tillë, si Tregtari /Furnizuesi Ofertues edhe Deleguesi i Mundshëm duhet ta ofrojnë këtë informacion brenda kompetencave të tyre, pasi Transportuesi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme të lehtësojë konsultimin me Autoritetet Rregullatore.
- (f) Nëse Delegimi i propozuar ka të bëjë me Kapacitetin Alternativ të Mbështetjes së Kreditit, atëherë:

- (i) Transportuesi mund të kërkojë nga i Deleguari Potencial që të sigurojë informacione të tilla të mëtejshme siç kërkon në mënyrë të arsyeshme Transportuesi për të vlerësuar pajtueshmërinë e të Deleguarit Potencial me kërkesat e mbështetjes së kreditit të Marrëveshjes së Transportit të Gazit që rregullojnë kushtet e Kapacitetit përkatës të Rezervuar, si pjesë e vlefshmërisë së tij të Delegimit të propozuar; dhe
 - (ii) Delegimi i propozuar nuk do të hyjë në fuqi derisa i Deleguari Potencial të përmbushë kërkesat e mbështetjes së kreditit si një Tregtar/ Furnizues sipas Marrëveshjes për Transportin e Gazit.
- (g) Transportuesi duhet që brenda pesë Ditëve të Punës të njoftojë Tregtarin/Furnizuesin Ofertues që Formulari i tij i Delegimit është plotësuar siç duhet dhe të njoftojë Tregtarin/Furnizuesin Ofertues nëse kërkon ndonjë informacion ose konsultim të mëtejshëm në përputhje me paragrafët (e) ose (f).
- (h) Transportuesi do të njoftojë Tregtarin / Transportuesin Ofertues dhe të Deleguarin Potencial nëse Delegimi është pranuar nga Transportuesi jo më vonë se (i) 23 Ditë Pune pas përfundimit të çdo konsultimi dhe marrjes së një informacioni të mëtejshëm të kërkuar nga Transportuesi, siç njoftohet në përputhje me paragrafin (g) më lart; dhe (ii) 30 Ditë Pune pas marrjes së Formularit të Delegimit të plotësuar siç duhet. Nëse Transportuesi nuk e ka pranuar atë Delegim dhe Transportuesi do të sigurojë arsye për atë mos pranim. Nëse Transportuesi ka përcaktuar se Delegimi është i suksesshëm, Transportuesi duhet me anë të atij njoftimi të specifikojë Ditën e parë të Gazit në të cilën Delegimi i propozuar do të jetë në fuqi (duke qenë më vonë e tre Ditë Pune pas datës së njoftimit dhe datës së specifikuar në Formularin e Delegimit, por që i nënshtrohet paragrafit (f) (ii) më lart nëse është e aplikueshme).

7.4 Kushtet e Tregtimit të Tregjeve Sekondare

- (a) Çdo term dhe kusht specifik në lidhje me një Delegim ose Transferim sipas Marrëveshjes për Transportin e Gazit do të aplikohen tek një Delegim ose Transferim to ndonjë Kapaciteti të Rezervuar sipas Marrëveshjes për Transportin e Gazit. Për më tepër, kushtet e mëposhtme zbatohen për tregtimin e kapaciteteve në Tregun Sekondar:
- (i) vetëm Palët e Regjistruara mund të tregëtojnë Kapacitetin e Rezervuar;
 - (ii) kapaciteti i Rezervuar që fillimisht u alokua si Kapacitet i Grupuar (bundled) mund të rishitet vetëm si Kapacitet i Grupuar (bundled). Kapaciteti i pagrupuar mund të rishitet vetëm si kapacitet i pagrupuar (por mund të shndërrohet në Kapacitet të Grupuar (bundled) me marrëveshje të OST- ve përkatëse);
 - (iii) periudha minimale për një Delegim ose Transferim është një Ditë Gazi;
 - (iv) periudha maksimale për një Delegim ose Transferim është kohëzgjatja e plotë e tregtimit të Kapacitetit të Rezervuar;
 - (v) transportuesi do të vërtetojë një Delegim të Kapacitetit të Rezervuar (përveç Kapacitetit Alternativ të Mbështetjes së Kreditit) për një Palë të Regjistruar e cila është brenda Kreditit të Disponueshëm për atë Palë të Regjistruar; dhe
 - (vi) delegimi ose Transferimi i propozuar nuk duhet të çojë në mos përputhje me kushtet e Përrjashtimit.
- (b) Termat dhe kushtet e Kapacitetit të Rezervuar nuk ndikojnë tek tregtimi në Tregun Sekondar.
- (c) Nëse Tregtari/Furnizuesi ofron një sasi të Kapacitetit të Rezervuar për Dorëzim dhe në tregun sekondar, i cili në total tejkalon Kapacitetin e tij të Rezervuar, Transportuesi do të refuzojë njoftimin e tregtisë që korrespondon me tregtimin në tregun sekondar.

7.5 Efektet e Tregtimit në Tregjet Sekondare

- (a) Për çdo Kapacitet të Transferuar, për kohëzgjatjen e Transferimit, Transportuesi do të pranojë vetëm Nominime, Rinominime dhe Njoftime Tregtimi në lidhje me atë Kapacitet të Transferuar nga Pala Pranuese. Tregtari/Furnizuesi Ofertues nuk do të ketë të drejtë të bëjë Nominime, Rinominime ose Njoftime Tregtare në lidhje me Kapacitetin e Transferuar dhe Transportuesi do të refuzojë çdo nominim ose njoftim të marrë nga Tregtari/Furnizuesi Ofertues për kohëzgjatjen e këtij Transferimi. Sipas Paragrafit 7.6, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera (përfshirë detyrimet e pagesës) në lidhje me Kapacitetin e Transferuar mbeten tek Tregtari/Furnizuesi Ofertues dhe Tregtari/Furnizuesi ofertues do të vazhdojë të trajtohet si " Tregtar/Furnizues" në lidhje me atë Kapacitet të Transferuar.
- (b) Për çdo Kapacitet të Deleguar, për kohëzgjatjen e Delegimit, të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me atë Kapacitet të Deleguar do ti përkasin Palës së Regjistruar që pranon Delegimin e këtij Kapaciteti të Deleguar. Pa ndikuar tek të drejtat ose detyrimet që vijnë si pasojë, Tregtari/Furnizuesi Ofertues nuk do të ketë ndonjë të drejtë dhe do të lirohet nga të gjitha detyrimet në lidhje me Kapacitetin e Deleguar për tërë kohëzgjatjen e Delegimit. Për të shmangur dyshimet, të drejtat dhe detyrimet që zbatohen për Kapacitetin e Deleguar do të vazhdojnë të jenë të drejtat dhe detyrimet sipas Marrëveshjes përkatëse për Transportin e Gazit dhe nuk do merret parasysh asnjë Marrëveshje tjetër për Transportin e Gazit që mund të jetë në fuqi midis Transportuesit dhe Palës së Regjistruar.

7.6 Njoftimet për Transferimet e Kapacitetit të Rezervuar

Për çdo Kapacitet të Transferuar, rregullimet e mëposhtme në dispozitat e komunikimit tek ky Kod i Rrjetit do të zbatohen për kohëzgjatjen e atij Transferimi:

- (a) Transportuesi do t'i dërgojë Palës Pranuese:
- (i) kopje të çdo:
 - (A) Njoftimi për Kufizimin e Kapacitetit, Njoftimi për Ndërprerjen e Kufizimit të Kapacitetit, Njoftimi për Ndërprerje dhe Njoftimi për Përfundimin e Ndërprerjes; dhe
 - (B) Njoftimi për Mirëmbajtje të Planifikuar dhe çdo njoftim në përputhje me Paragrafet 11.3 ose 11.4;
- dhe në të njëjtën kohë kur ato dërgohen tek Tregtari/Furnizuesi Ofertues në masën që lidhen me Kapacitetin e Transferuar;
- (ii) çdo Njoftim të Sasive të Konfirmuara dhe çdo komunikim në lidhje me Nominimet, Rinominimet, Njoftimet Tregtare, Njoftimet e Përditësuara të Tregtimit, Sasitë e Nominuar, Sasitë e Tregtuara, Sasitë Provizore dhe Sasitë e Konfirmuara, në lidhje me Kapacitetin e Transferuar;
 - (iii) kopje të çdo komunikimi në lidhje me Sasitë e Alokua ose çështjet e përcaktuara në Paragrafin 10.4 ose 10.6 në lidhje me Kapacitetin e Transferuar në të njëjtën kohë kur ato dërgohen tek Tregtari/Furnizuesi Ofertues (por pa asnjë zbritje në përputhje me paragrafin (c) më poshtë); dhe
 - (iv) në të njëjtën kohë kur ajo i dërgon ndonjë Deklaratë Tregtarëve/Furnizuesve Ofertues, detaje për Sasitë e Alokua në lidhje me Kapacitetin e Transferuar për çdo Ditë Gazi në çdo muaj Gazi përkatës;
- (b) Transportuesi nuk do tu dërgojë Tregtarëve/Furnizuesve Ofertues asnjë njoftim ose komunikim tjetër të specifikuar në paragrafin (a) (ii) më lart; dhe
- (c) Transportuesi do të përjashtojë nga çdo Deklaratë dhe çdo komunikim në lidhje me Sasitë e Alokua në lidhje me çdo Kapacitet të Transferuar për secilën Palë Tregtarësh/Furnizuesish, detajet e Tregtarit/Furnizuesit në OST Fqinjje që po merr Gaz Natyror nga Pala Pranuese.

8. NOMINIMET

8.1 Llojet e Nominimeve për Kapacitetin në Drejtimin Përpara

- (a) Nominimet në lidhje me Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) mund të bëhen ose si Nominime të Dyanshme në rastin e të gjitha Pikave të Interkonjeksionit ose Nominime të Njëanshme në rastin e secilës Pikë Interkonjeksioni me rezervime të Njëanshme.
- (b) Transportuesi duhet të publikojë në faqen e tij të internetit një listë të Pikave të Interkonjeksionit, në lidhje me të cilat do të pranohet një Nominim i Njëanshëm (secila, një Pikë Interkonjeksioni e Njëanshme), së bashku me identitetin e OST Aktive dhe OST Pasive në secilën Pikë Interkonjeksioni të Njëanshme.
- (c) Në lidhje me secilën Pikë Interkonjeksioni të Njëanshme:
 - (i) Transportuesi dhe OST Fqinje do të përcaktojnë se kush prej tyre do të jetë OST aktive, ndërkohë që tjetri është OST pasive; dhe
 - (ii) Tregtari/Furnizuesi tek një Palë Tregtarësh/Furnizuesish që ka kapacitetin rezervë për atë Palë Tregtarësh/Furnizuesish me OST aktive do të bëhet Tregtari/Furnizuesi aktiv, ndërkohë që tjetri është Tregtari/Furnizuesi pasiv.
- (d) Një Palë Tregtarësh/Furnizuesish mund të bien dakord të kryejnë Nominime të Njëanshme në një Pikë Interkonjeksioni të Njëanshme dhe të njoftohet OST-ja pasive për atë marrëveshje nga Tregtari/Furnizuesi pasiv duke dërguar një Njoftim Nominimi të Përbashkët tek OST Pasive, duke e njoftuar atë për faktin që Tregtari/Furnizuesi Pasiv autorizon Tregtarin/Furnizuesin Aktiv që të emërojë në emër të Tregtarëve/Furnizuesve Pasiv dhe të specifikojë datën e fillimit për atë autorizim dhe ose datën e mbarimit për atë autorizim ose që autorizimi është me kohë të pacaktuar.
- (e) Në periudhën pas marrjes nga OST Pasive të Njoftimit të Përbashkët të Shpalljes së Nominimit deri në datën e skadimit (nëse ka) të autorizimit të përmendur në paragrafin (d) më lart, OST aktive do të jetë përgjegjëse për marrjen e nominimeve për një Palë Tregtarësh/Furnizuesish nga Tregtari/Furnizuesi aktiv për të dy anët e Pikës përkatëse të Interkonjeksionit të Njëanshëm, dhe OST aktive do të dërgojë nominime tek OST pasive. Nëse Transportuesi është OST pasive, atëherë nominimi i marrë nga OST aktive do të konsiderohet si Sasia e Nominuar e marrë nga Tregtari/Furnizuesi përkatës.

8.2 Nominimet për Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers)

Tregtarëve/Furnizuesve do t'i caktohen Kode të veçanta të Llogarisë së Tregtarëve/Furnizuesve nga Transportuesi për Kapacitetin Tregtar në Drejtimin Përpara (Forward) dhe për çdo Rrugë për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers.) Nominimet për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) duhet jenë si Sasi të Nominuara të barabarta në kombinimin e Pikës Hyrëse dhe Dalëse që formon Rrugët Tregtar e në Drejtim të Kundërt (Revers) të rezervuar.

8.3 Përparësitë

- (a) Një Tregëtar/Furnizues, kur paraqet Nominimet ose Njoftimet e Tregëtimit, mund të përcaktojë një nivel përparësie për secilën palë tjetër në çdo Palë Tregëtarësh/Furnizuesish tek të cilët ai është një Tregëtar/Furnizues. Një Tregëtar/Furnizues mund të përcaktojë një nivel përparësie që fillon nga 1 (më i larti) deri tek 20 (më i ulëti) Nëse nuk ka asnjë nivel përparësie për një Nominim specifik, Rinominim ose Palë Tregëtarëve /Furnizuesve, do të përcaktohet një nivel i parazgjedhur përparësie 10.
- (b) Nëse Transportuesit i kërkohet sipas kushteve të këtij Kodi të Rrjetit të zvogëlojë Sasi të Nominuesë të Tregëtarit/Furnizuesit, Sasi të Tregtuara ose të Konfirmuara të tij, ai do të kërkojë të rrisë totalin e

Sasive të Konfirmuara përmes të gjitha Pikave të Interkonjeksionit. Për aq sa është e mundur, Transportuesi do të marrë në konsideratë nivelet e përparësisë referuar në paragrafin (a) më sipër kur të përcaktojë se cila nga palët e tjera të një Pale Tregtarësh/Furnizuesish në Pikën e Interkonjeksionit ose Pikën Virtuale e Tregëtimit do të reduktohet fillimisht, në mënyrë që sasive për dorëzim ose ridorëzim tek palët e tjera me një nivel më të ulët përparësie të reduktohen para palëve të tjera me një nivel përparësie më të lartë dhe të tilla palë të tjera me të njëjtin nivel përparësie do të reduktohen proporcionalisht.

- (c) Për të shmangur dyshimet, një Tregtari/Furnizuesi nuk i kërkohet të specifikojë ndonjë nivel përparësie kur të paraqesë Nominimet ose Njoftimet për Tregëtim dhe Transportuesi do të marrë në konsideratë nivelet e përparësisë vetëm kur të përcaktojë se si Sasive të Nominuara, të Tregëtuara ose të Konfirmuara të një Tregtari/Furnizuesi do të reduktohen ndërmjet tyre.

8.4 Proçedura e Përgjithshme

- (a) Është përgjegjësi e Tregtarëve/Furnizuesve që të paraqesin Nominimet e sakta brenda afateve kohore dhe në përputhje me proçedurën e përcaktuar në këtë Paragraf 8.
- (b) Për të njoftuar Transportuesin për sasive të Gazit Natyror që do të transportohen duke përdorur Kapacitetin e Rezervuar të Tregtarëve/Furnizuesve, Tregtari/Furnizuesi dërgon Nominimet e tij dhe, nëse aplikohet, Rinominimi tek Transportuesi, do të përpunohet sipas proçedurës vijuese:
- (i) Tregtari/Furnizuesi i dërgon një njoftim Transportuesit me Nominimin e tij për një Pikë Hyrje ose Pike Daljeje;
- (ii) Transportuesi llogarit Sasinë e Konfirmuar të Gazit Natyror të Tregtarëve/Furnizuesve që planifikohet të dorëzohet ose ri-dorëzohet tek Transportuesi në atë Pikë Hyrjeje ose Pikë Daljeje; dhe
- (iii) Transportuesi dërgon një Njoftim të Sasisë së Konfirmuar për secilin Tregtar/Furnizues duke përcaktuar Sasive të tij të Konfirmuara në atë Pikë Hyrje ose Dalje.

8.5 Paraqitja e Nominimeve

- (a) Çdo Tregtar/Furnizues duhet të paraqesë Nominime të veçanta për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) dhe Kapacitetin në drejtim të kundërt (Revers) për secilën Pikë Hyrje dhe Pikë Dalje për të cilën ka Kapacitet të Rezervuar për çdo Ditë Gazi, në përputhje me kalendarin e parashikuar në Paragrafin 8.7. Për secilin Nominim, Tregtari/Furnizuesi duhet të specifikojë sa vijon:
- (i) identifikimin e Pikës së Interkonjeksionit (që do të thotë pika specifike Hyrëse ose Dalëse në Sistemin e Transportit të TAP); dhe nëse kjo Pikë Interkonjeksioni është një Pikë Hyrje ose një Pikë Dalje për Kapacitetin përkatës në Drejtim të Kundërt;
- (ii) kodin e Llogarisë së Tregtarëve/Furnizuesve (i cili do të jetë i ndryshëm për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) dhe Kapacitetin Tregtar në drejtim të kundërt (Revers));
- (iii) identifikimin e palës tjetër (kodi i llogarisë së dërguesit të lëshuar nga OST-ja Fqinje për Tregtarin/Furnizuesin tjetër tek Pala përkatëse e Tregtarëve/Furnizuesve në anën tjetër të Pikës së Interkonjeksionit);
- (iv) ditën e Gazit në të cilën aplikohet Nominimi;
- (v) sasinë e Gazit Natyror që do të transportohet në njësi kWh për Ditë Gazi;
- (vi) llojin e Nominimit që është ose Nominim i Njëanshëm ose Nominim i Dyanshëm
- (b) Për aq kohë sa Njoftimi i Përbashkët për Deklaratën e Nominimit është në fuqi, një Tregtar/

Furnizues i cili është Pasiv nuk mund të paraqesë një Nominim ose Rinominim në lidhje me Kapacitetin e Rezervuar sipas Njoftimit të Përbashkët për Deklaratën e Nominimit.

- (c) Nëse një Tregtar/Furnizues paraqet një Nominim si pjesë e një Nominimi të Dyanshëm, është përgjegjësi e Tregtarëve/Furnizuesve dhe palës tjetër që të sigurojnë që nominimet për atë Palë Tregtarësh/Furnizuesish në secilën anë të Pikës së Interkoneksionit të jenë të barabarta.

8.6 Pika Virtuale e Tregtimit dhe Njoftimet Tregtare

- (a) Transportuesi do të lehtësojë tregtimin e Gazit Natyror midis Tregtarëve/Furnizuesve duke lejuar që të bëjnë Tregti në Pikën Virtuale të Tregtimit. Tregtarët/Furnizuesit mund të bëjnë një tregti titulli për Gazin Natyror duke paraqitur Njoftime Tregtare për Transportuesin në përputhje me kalendarin në Paragrafin 8.7.
- (b) Gazi Natyror i tregtuar në Pikën Virtuale të Tregtimit mund të dorëzohet nga një Tregtar/Furnizues që ka Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) në një Pikë Hyrëse dhe mund të ridërgohet tek një Tregtar/Furnizues që ka Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) në një Pikë Daljeje. Tregtarët/Furnizuesit nuk mund të tregtojnë në Pikën Virtuale të Tregtimit Gaz Natyror që do të dërgohet ose ri-dërgohet duke përdorur Kapacitetin në drejtim të kundërt (Revers) dhe Palët e Regjistruara që nuk janë Tregtar/Furnizues nuk mund të tregtojnë Gaz Natyror në Pikën Virtuale të Tregtimit.
- (c) Tregtia midis dy Tregtarëve/Furnizuesve në Pikën Virtuale të Tregtimit do të bëhet përmes Njoftimeve Tregtare të paraqitura tek Transportuesi nga të dy Tregtarët/Furnizuesit.
- (d) Një njoftim Tregtar do të sigurojë informacionin e mëposhtëm:
 - (i) që është një Njoftim për një Tregti në Pikën Virtuale të Tregtimit;
 - (ii) kodi i Llogarisë së Tregtarëve/Furnizuesve (për Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward));
 - (iii) kodi i Llogarisë së Tregtarëve/Furnizuesve të tjerë (për Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward));
 - (iv) dita e Gazit në të cilën aplikohet Tregtia; dhe
 - (v) sasia e Gazit Natyror që duhet të tregtohet si një sasi pozitive për një blerje ose një sasi negative për një shitje në njësi kWh për Ditë Gazi.
- (e) Tregtarët/Furnizuesit janë përgjegjës për paraqitjen e saktë të Njoftimeve Tregtare për sasi të Gazit Natyror që dëshirojnë të tregtojnë. Transportuesi nuk do të jetë përgjegjës nëse Sasi të Konfirmuara ose Sasi të Alokua të Tregtarëve/Furnizuesve në Pikën Virtuale të Tregtimit nuk pasqyrojnë sasi të Gazit Natyror që një Tregtar/Furnizues ka pranuar të blejë ose shesë në Pikën Virtuale të Tregtimit, sipas çdo marrëveshje të shitjes së Gazit ndërmjet tij dhe një Tregtari/Furnizuesi tjetër.

8.7 Kalendari

- (a) Kalendari i mëposhtëm aplikohet për një Tregtar/Furnizues që paraqet Nominimet ose Njoftimet Tregtare për Transportuesin:
 - (i) Tregtari/Furnizuesi mund të paraqesë një Nominim ose një Njoftim Tregtar tek Transportuesi për një Ditë Gazi në çdo kohë pas datës që bie një vit kalendarik para asaj Dite Gazi;
 - (ii) Tregtari/Furnizuesi duhet të paraqesë një Nominim ose një Njoftim Tregtar tek Transportuesi për një Ditë Gazi jo më vonë se ora 13.00 UTC (ora dimërore) ose 12.00 UTC (ora verore) në ditën e menjëhershme të mëparshme të Gazit;
 - (iii) nëse Tregtari/Furnizuesi ka paraqitur një Nominim ose një Njoftim Tregtar në lidhje me një Ditë Gazi, atëherë në çdo kohë para afatit të Nominimit për atë Ditë Gazi, Tregtari/Furnizuesi

mund të paraqesë një Nominim të ri ose një Njoftim Tregtar për Transportuesin, i cili do të hedhë poshtë çdo Nominim ose Njoftim Tregtar të mëparshëm për atë Ditë Gazi;

- (iv) pas afatit të Nominimit për një Ditë të veçantë Gazi, Transportuesi kryen Proçeset e Përputhjes siç përcaktohet në Nenin 9 duke përdorur Nominimin e fundit dhe Njoftimet Tregtare të marra nga një Tregtar/Furnizues para afatit të Nominimit, pas së cilës Transportuesi njofton Tregtarin/Furnizuesin për Sasitë e tij të Konfirmuara jo më vonë se ora 15.00 UTC (koha dimërore) ose 14.00 UTC (koha verore) në ditën e menjëhershme të mëparshme të Gazit.
- (b) Nëse Transportuesi nuk merr një mesazh të vlefshëm me Nominimet për një Pikë Interkonjeksioni ose Njoftim Tregtar për Pikën Virtuale të Tregtimit për një Ditë Gazi brenda afatit të Nominimit, Sasitë e Nominuara të Tregtarëve/Furnizuesve në atë Pikë Interkonjeksioni dhe / ose Sasitë e Tregtuara në Pikën Virtuale të Tregtimit (sipas rastit) do të konsiderohen të jenë zero.

8.8 Rinominimet

- (a) Në këtë Paragraf 8.8:

Sasia në Total e Konsideruar, nëkupton në lidhje me një orë në një Ditë Gazi dhe një Pikë Hyrje, Pikë Dalje ose Pikës Virtuale të Tregtimit llogaritet si:

- (i) për orën e parë në atë Ditë Gazi, zero; dhe
- (ii) për çdo orë tjetër në atë Ditë Gazi, totali i Sasive të Konsideruara për Orë për çdo orë në atë Ditë Gazi që i takon përpara asaj ore në atë Pikë Hyrje, Pikë Dalje ose Pikë Virtuale Tregtimi (sipas rastit).

Sasia e Konsideruar për Orë, për një orë (H) në një Ditë Gazi dhe një Pike Hyrje, Pikë Dalje ose Pikë Virtuale Tregtimi llogaritet si:

- (i) (A) vlera absolute e sasive të konfirmuara Tregtarit/Furnizuesit në vijim të Proçeseve të Përputhjes që ndodhin në fund të ciklit të Rinominimit, duke rënë dy orë para orës (H) në atë Pikë Hyrje, Pikë Dalje ose Pik Virtuale Tregtimi (sipas rastit),

me pak se

- (B) Sasia në Total e Konsideruar për orën (H) në atë Pikë Hyrje, Pika Dalje ose Pikë Virtuale Tregtimi (sipas rastit),

pjesëtuar me

- (ii) numrin e orëve të mbetura në atë Ditë Gazi nga dhe përfshirë orën (H).
- (b) Pas afatit të njoftimit për Sasitë e Konfirmuara të tij, në bazë të Nenit 8.7 (a) (iv), një Tregtar/Furnizues mund të paraqesë Rinominime ose Njoftime Tregtare të Përditësuara në lidhje me një Ditë Gazi deri në tre orë para përfundimit të asaj Dite Gazi. Transportuesi do të zhvillojë një cikël rinominimi për çdo orë, në të cilin Rinominimet dhe Njoftimet Tregtare të Përditësuara të marra gjatë një ore përpunohen përmes Proçesit të Përputhjes në fund të asaj ore. Çdo Sasi e Konfirmuar e rishikuar që rezulton nga një Rinominim ose Njoftim Tregtar i Përditësuar do të hyjë në fuqi dy orë pas përfundimit të ciklit të rinominimit në të cilin është dorëzuar Rinominimi ose Njoftimi Tregtar i Përditësuar.
- (c) Rinominimi i një Tregtari/Furnizuesi duhet të sigurojë që vlera absolute e Sasive të Nominuara për Pikën e Hyrjes ose Pikën e Daljes nuk është më e madhe se totali i:
 - (i) Sasia në Total e Konsideruar në atë Pikë Hyrje ose Pikë Dalje për orën që i takon një orë pas përfundimit të ciklit përkatës të rinominimit; dhe

- (ii) Kapaciteti i Rezervuar i Tregtarëve/Furnizuesve në atë Pikë Hyrje ose Pika Dalje pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të orëve në Ditën e Gazit dhe shumëzuar me numrin e orëve të mbetura në Ditën e Gazit nga dhe duke përfshirë orën që i takon dy orë pas përfundimit të ciklit përkatës të rinominimit.
- (c) Rinominimi i një Tregtari/Furnizuesi ose Njoftimi Tregtar i Përditësuar duhet të sigurojë që vlera absolute e Sasive të Nominuara ose Sasive të Tregtuara të jetë jo më e vogël se Sasia në Total e Konsideruar në Pikën përkatëse të Tregtimit Virtual, Pikën e Hyrjes ose Pikën e Daljes për orën që i takon një orë pas fundit të ciklit përkatës të Rinominimit.

9. PËRPUTHJA DHE KONFIRMIMI

9.1 Fillimi i Proçesit të Përputhjes

Pas afatit të Nominimit dhe në fund të çdo cikli të Rinominimit, në përputhje me Nenin 8.8 (b), Transportuesi dhe çdo OST Fqinje do të fillojnë proçesin e përputhjes në lidhje me secilën Pikë të Sistemit dhe Transportuesi do të fillojë Proçesin e Përputhjes në Pikën Virtuale të Tregtimit.

9.2 Verifikimi i Sasive të Nominuara dhe Sasive të Tregtuara

- (a) Tregtari/Furnizuesi është përgjegjës për paraqitjen e Nominimeve që nuk tejkalojnë Kapacitetin e tij të Rezervuar dhe Rinominimet që përputhen me Kufizimet e Rinominimit. Si pjesë e proçeseve të përputhjes, Transportuesi së pari do të sigurojë që Sasitë e Nominuara të jenë në përputhje me këto vlera. Për këtë qëllim, Kapacitetet e Rezervuara për të gjitha Produktet e Kapacitetit që përbëjnë Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) do të trajtohen në bazë totale në secilën Pikë të Interkonjeksionit.
- (b) Nëse Nominimet e një Tregtari/Furnizuesi tejkalojnë Kapacitetin e tij të Rezervuar, Transportuesi do të zvogëlojë ato Sasi të Nominuara të Tregtarëve/Furnizuesve në Pikën përkatëse të Interkonjeksionit përpara se t'i përdori ato për qëllimin e Proçesit të Përputhjes, në mënyrë që ato të jenë të barabarta me Kapacitetin e Rezervuar. Nëse Rinominimi i një Tregtari/Furnizuesi nuk është në përputhje me Kufizimet e Rinominimit, Transportuesi do të rregullojë ato Sasi të Nominuara të Tregtarit/ Furnizuesit në Pikat Përkatëse të Interkonjeksionit para se t'i përdorë ato për qëllim të Proçesit të Përputhjes me shumën minimale të kërkuar, në mënyrë që pas këtij rregullimi, Sasitë e Nominuara do të përputhen me Kufizimet e Rinominimit.
- (c) Nëse si rezultat i një Kufizimi të Kapacitetit, duke iu nënshtruar dispozitave të Paragrafit 12.2 (d), Sasitë e Nominuara të Tregtarëve/Furnizuesve janë më të mëdha se shumën maksimale të Kapacitetit të Rezervuar të atij Tregtari/Furnizuesi që Transportuesi është në gjendje të vendosë në dispozicion Tregtarit/Furnizuesit, Transportuesi do të reduktojë Sasitë e Nominuara të atij Tregtari/Furnizuesi para se t'i përdorë ato për qëllimin e Proçesit të Përputhjes, në mënyrë që ato të jenë të barabarta me sasitë maksimale.
- (d) Tregtari/Furnizuesi është përgjegjës për paraqitjen e Njoftimeve Tregtare të Përditësuar që përputhen me Kufizimet e Rinominimit. Nëse Njoftimi Tregtar i Përditësuar i Tregtarëve/Furnizuesve nuk është në përputhje me Kufizimet e Rinominimit, Transportuesi do ta rregullojë atë Njoftim Tregtar të Përditësuar të Tregtarit/Furnizuesit para se t'i përdorë ato për Proçesin e Përputhjes me shumën minimale që kërkohet, kështu që pas këtyre rregullimeve Njoftimi Tregtar i Përditësuar do të përputhet me Kufizimet e Rinominimit.
- (e) Transportuesi për më tepër do të kontrollojë nëse çdo Tregtar/Furnizues ka paraqitur Nominimet ose Rinominimet e Balancuara. Nëse Nominimet ose Rinominimet e një Tregtari/Furnizuesi nuk janë të Balancuara, Transportuesi do të reduktojë Sasitë e Nominuara të atij Tregtari/Furnizuesi (përpara se t'i përdorë ato për qëllimet e Proçesit të Përputhjes) dhe/ose Sasitë e tij të Konfirmuara në një ose më shumë Pika të Interkonjeksionit dhe/ose do të reduktojë Sasitë e Tregtuara në mënyrë që ato të Balancohen, në rastet kur aplikohet sipas niveleve të përparësisë në Paragrafin 8.3.
- (e) Transportuesi duhet të sigurojë që Nominimet e një Tregtari/Furnizuesi për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) të jenë në përputhje me kërkesën që Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) të jetë i nominuar dhe të përdoret si i barabartë me Sasitë e Nominuara në çdo Pikë Hyrëse dhe Dalëse të cilat formojnë Rrugën Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) të rezervuar. Nëse Sasitë e Nominuara të një Tregtari/Furnizuesi për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) nuk janë në përputhje me këtë kërkesë, Transportuesi do të reduktojë atë Sasi të Nominuar të Tregtarit/Furnizuesit në një ose më shumë Pika përkatëse të Interkonjeksionit përpara se t'i përdorë ato për qëllimet e Proçesit të Përputhjes në mënyrë që ato të jenë në përputhje me këtë kërkesë.

9.3 Përputhja

- (a) Gjatë Proçesit të Përputhjes në një Pikë Interkonjeksioni, Transportuesi dhe OST fqinje do të verifikojnë që:
- (i) identiteti i Tregtarëve/Furnizuesve dhe Palëve të tjera të çdo Pale Tregtarësh/Furnizuesish, siç përmbahet në një Nominim është i njëjtë me identitetin e dërguesve të njoftuar për OST-në e Fqinje; dhe
 - (ii) për secilën Palë Tregtarësh/Furnizuesish, Sasitë e Nominuara (siç mund të jenë rregulluar sipas Paragrafit 9.2) për një Tregtar/Furnizues në Pikën përkatëse të Interkonjeksionit që identifikon dorëzimin tek ose nga Tregtari/Furnizuesi tjetër tek ajo Palë Tregtarësh/Furnizuesish është e barabartë me sasinë e nominuar nga ai Tregtar/Furnizues tjetër për OST fqinje për dërgim tek ose nga Tregtari/Furnizuesi.
- (b) Proçesi i Përputhjes do të rezultojë tek Sasitë e Përkohshme për çdo Tregtar/Furnizues në secilën Pikë Interkonjeksioni si më poshtë:
- (i) nëse Pala e Tregtarëve/Furnizuesve është e njëjtë dhe Sasitë e Nominuara janë të barabarta, atëherë ekziston një "përputhje" dhe Sasitë e Përkohshme të Tregtarëve/Furnizuesve do të jenë të barabarta me Sasitë e tij të Nominuara (siç mund të jetë rregulluar sipas paragrafit 9.2);
 - (ii) nëse Pala e Tregtarëve/Furnizuesve është e njëjtë, por sasinë e nominuara nuk janë të barabarta, atëherë ekziston një "mospërputhje" dhe Sasitë e Përkohshme të Tregtarëve/Furnizuesve do të jenë më të vogla se sasinë e Nominuara (siç mund të jetë rregulluar sipas nenit 9.2) dhe sasinë e nominuar tek OST-ja Fqinje; dhe
 - (iii) nëse Pala e Tregtarëve/Furnizuesve nuk është e njëjtë, atëherë ka një "mospërputhje" dhe Sasitë e Përkohshme të Tregtarëve/Furnizuesve do të jenë zero.
- (c) Transportuesi gjithashtu do të zhvillojë një proçes përputhje në Pikën Virtuale të Tregtimit për të verifikuar që:
- (i) identiteti i Tregtarëve/Furnizuesve në secilën Palë Tregtarësh/Furnizuesish siç përmbahet në dy Njoftimet Tregtare përkatëse është i njëjtë; dhe
 - (ii) për secilën Palë Tregtarësh/Furnizuesish, Sasitë e Tregtuara të njoftuara nga secili Tregtar/Furnizues për atë Palë Tregtarësh/Furnizuesish janë të barabarta.
- (d) Proçesi i përputhjes në Pikën Virtuale të Tregtimit do të rezultojë në Sasitë e Përkohshme për çdo Tregtar/Furnizues si më poshtë:
- (i) nëse Palët e Tregtarëve/Furnizuesve është e njëjtë dhe Sasitë e Tregtuara janë të barabarta, atëherë ekziston një "përputhje" dhe çdo Sasi e Përkohshme e Tregtarit/Furnizuesit do të jetë e barabartë me Sasinë e Tregtuar;
 - (ii) nëse Palët e Tregtarëve/Furnizuesve është e njëjtë, por Sasitë e Tregtuara nuk janë të barabarta, atëherë ka një "mospërputhje" dhe çdo Sasi e Përkohshme e çdo Tregtari/ Furnizuesi do të jetë më e ulët se dy Sasitë e Tregtuara të njoftuara; dhe
 - (iii) nëse Palët e Tregtarëve/Furnizuesve nuk është e njëjtë, atëherë ka një "mospërputhje" dhe Sasitë e Përkohshme të Tregtarit/Furnizuesit do të jenë zero.
- (e) Nëse, Sasitë e Përkohshme të një Tregtari/Furnizuesi pas përfundimit të Proçeseve fillestare të Përputhjes në çdo Pikë Interkonjeksioni dhe Pikë Virtuale të Tregtimit nuk janë të Balancuara, atëherë Transportuesi mund, nëse e kërkon, të ridrejtojë një ose më shumë Proçese të Përputhjes duke përdorur Sasitë e Nominuara për atë Tregtar/Furnizues të cilat janë të barabarta me ato Sasi të Përkohshme por me Sasi të Nominuara të rregulluara në përputhje me Paragrafin 9.2 që rezultojnë në Sasi të reja të Përkohshme.

9.4 Sasitë e Konfirmuara

- (a) Sasitë e Konfirmuara të një Tregtari/Furnizuesi do të jenë të barabarta me Sasitë e tij të Përkohshme pas përfundimit të të gjitha Proçeseve të Përputhjes.
- (b) Transportuesi do t'i dërgojë një Njoftim të Sasive të Konfirmuara çdo Tregtari/Furnizuesi me një Sasi të Konfirmuar në një Pikë Interkonjeksioni pas përfundimit të Proçeseve të Përputhjes në atë Pikë Interkonjeksioni.

9.5 Shkalla Minimale e Rrjedhës

- (a) Nëse totali i të gjitha Sasive të Konfirmuara të Tregtarit/Furnizuesit në një Pikë të veçantë Interkonjeksioni do të rezultojë në një rrjedhë ditore fizike më të madhe se zero por poshtë Shkallës Minimale të Rrjedhës në atë Pikë Interkonjeksioni, atëherë Transportuesi do të përdorë përpjekjet e tij të arsyeshme për tu koordinuar me OST Fqinje, duke iu nënshtruar kufizimeve teknike të Sistemit të Transportit të TAP dhe Sistemit të Ndërlidhur përkatës, për të siguruar Shërbimet e Transportit në atë Pikë Interkonjeksioni.
- (b) Nëse nuk është e mundur për ndonjërin ose të dy: Sistemin e Transportit të TAP dhe Sistemin përkatës të Interkonjeksionit, të marrin ose shpërndajnë bazuar tek rrjedha e modifikuar, Transportuesi do të ndërpresë çdo Kapacitet në Drejtimin përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë në Drejtim të Kundërt të Pikës së Interkonjeksionit tek Pika përkatëse e Interkonjeksionit sipas Paragrafit 12.5 (a). Nëse kjo nuk mjafton për të mbajtur Shkallën Minimale të Rrjedhës, Transportuesi do të ndërpresë çdo Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt në Pikën përkatëse të Interkonjeksionit (derisa Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt të transportohet në Drejtimin Përpara të Interkonjeksionit tek Pika përkatëse e Interkonjeksionit) sipas paragrafit 12.4 (a). Nëse kjo vazhdon të jetë e pamjaftueshme për të ruajtur Shkallën Minimale të Rrjedhës, Transportuesi do të njoftojë Tregtarët/Furnizuesit e prekur që nuk mund të sigurojnë Shërbimet e Transportit për shkak se nuk kanë marrë Shkallën Minimale të Rrjedhës dhe mund ta zvogëlojnë rrjedhën në Pikën përkatëse të Interkonjeksionit në zero.
- (c) Nëse Transportuesit i kërkohet ta zvogëlojë shkallën e rrjedhës në zero, Transportuesi do të rishikojë Sasitë e Konfirmuara dhe do të njoftojë çdo Tregtar/Furnizues të prekur në lidhje me Sasitë e tij të Konfirmuara të rishikuara në Pikat e prekura të Interkonjeksionit dhe në Pikat e tjera të Interkonjeksionit pasi Transportuesit i kërkohet të reduktojë në mënyrë që të sigurojë që Sasitë e Konfirmuara të Tregtarit/Furnizuesit të jenë të Balancuara.

10. BALANCIMI DHE ALOKIMI

10.1 Balancimi për Kapacitetin në Drejtimin Përpara

Disbalancimi i Transmetimit për Kapacitetin në Drejtimin Përpara për një Ditë Gazi (d) për një Tregtar/Furnizues (s) do të llogaritet nga Transportuesi sipas formulës së mëposhtme:

$$FTI'_{d,s} = \sum FEA'_{d,s} + \sum FXA'_{d,s} + \sum VTPA'_{d,s}$$

- (i) $FTI'_{d,s}$ është Disbalancimi i Transmetimit për Kapacitetin në Drejtimin Përpara për Ditën e Gazit d për Tregtarin/Furnizuesin s
- (ii) $FEA'_{d,s}$ janë Sasi të Alokua në secilën Pikë Hyrëse në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara për Ditën e Gazit d për Tregtarin/Furnizuesin s
- (iii) $FXA'_{d,s}$ janë Sasi të Alokua në secilën Pikë Dalëse në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara për Ditën e Gazit d për Tregtarin/Furnizuesin s
- (iii) $VTPA'_{d,s}$ janë Sasi të Alokua në Pikën Virtuale të Tregtimit

10.2 Balancimi për Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers)

Disbalancimi i Transmetimit për Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) në një Ditë Gazi (d) për një Tregtar/Furnizues (s) do të llogaritet nga Transportuesi sipas formulës së mëposhtme:

$$RTI'_{d,s} = \sum REA'_{d,s} + \sum RXA'_{d,s}$$

Ku:

- (i) $RTI'_{d,s}$ është Disbalancimi i Transmetimit për Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) në një Ditë Gazi d për Tregtarin/Furnizuesin s
- (ii) $REA'_{d,s}$ janë Sasi të Alokua në çdo Pikë Hyrëse në lidhje me Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) në një Ditë Gazi d për Tregtarin /Furnizuesin s
- (iii) $RXA'_{d,s}$ janë Sasi të Alokua në çdo Pikë Dalëse në lidhje me Kapacitetin Komercial në Drejtim të Kundërt (Revers) në një Ditë Gazi d për Tregtarin/Furnizuesin s

10.3 Tarifa Ditore e Disbalancimit

- (a) Transportuesi do të llogarisë Tarifën Ditore të Disbalancimit për çdo Tregtar/Furnizues në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin përpara dhe Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt për çdo ditë Gazi në të cilën Tregtari/Furnizuesi ka Sasi të Alokua. Totali i Tarifave Ditore të Disbalancimit për çdo ditë Gazi në një muaj Gazi do të paguhet Tregëtarit/Furnizuesit (nëse është pozitive) ose do të paguhet nga Tregëtarit/Furnizuesi (nëse është negative) dhe do të përfshihet tek Situacioni përkates nxjerrë nga ai Tregtar/Furnizues në lidhje me atë Muaj Gazi.
- (b) Tarifa ditore e disbalancimit llogaritet, për secilën Ditë Gazi d , pasi Disbalancim i Transmetimit për Tregtarin/Furnizuesin s për atë Ditë Gazi d shumëzuar me Çmimin e Disbalancimit të Gazit të Tepërt ($EIGP_d$) për atë Ditë Gazi në rastin e një disbalancimi pozitiv të Transmetimit dhe nga Çmimi i Disbalancimit të Mungesës së Gazit ($SIGP_d$) për atë Ditë Gazi në rast të një disbalancimi negativ të transmetimit (secila siç përcaktohet më poshtë). Nëse një Tregëtar/ Furnizues ka Disbalanca në Transmetim për çdo Kapacitet në Drejtimin Përpara dhe për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers), Transportuesi do të llogarisë Tarifën Ditore të Disbalancimit në mënyrë të veçantë për secilën.
- (c) Çmimi i Disbalancimit për Gazin e Tepërt ($EIGP_d$) për Ditën e Gazit d do të jetë:
 - (i) çmimi mesatar i ponderuar i çdo shitjeje të Gazit Natyror nga Transportuesi në Ditë Gazi d të shprehur në €/kWh (ose, nëse Transportuesi zvogëlon sasinë e Gazit Karburant ose çmimin UFG që përndryshe do të blihet si rezultat i Disbalancimit të Transmetimit, çmimin që Transportuesi do të kishte paguar për një sasi të tillë të Gazit Natyror); ose

- (ii) nëse nuk është i disponueshëm një çmim i tillë, Çmimi i Referencës për atë Ditë Gazi.
- (d) Çmimi i Disbalancimit të Mungesës së Gazit (*SIGP_d*) për Ditën e Gazit *d* do të jetë:
 - (i) çmimi mesatar i ponderuar për çdo blerje të Gazit Natyror nga Transportuesi në Ditë Gazi *d* të shprehur në €/kWh; ose
 - (ii) nëse nuk është i disponueshëm një çmim i tillë, Çmimi i Referencës për atë Ditë Gazi.
- (e) Transportuesi do të publikojë në faqen e tij të internetit çmimin për *EIGP_d* dhe *SIGP_d* që aplikohet për Ditën paraardhëse të Gazit së bashku me listën e çmimeve të mëparshme të referencës. Metodologjia e aplikueshme për Çmimin e Referencës mund të ndryshojë me kalimin e kohës pasi Transportuesi të lajmërojë në faqen e tij të internetit.
- (f) Nëse një Tregtar/Furnizues ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme për Transportin e Gazit në një Ditë të caktuar Gazi, atëherë për të përcaktuar Tarifës Ditore të Disbalancimit të alokuar sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit:
 - (i) Tarifa Ditore e Disbalancimit për Kapacitetin në Drejtimin Përpara do të alokohet çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit proporcionalisht në Kapacitetin e Rezervuar për Kapacitetin në Drejtimin Përpara sipas çdo Marrëveshje të tillë për Transportin e Gazit në atë Ditë Gazi; dhe
 - (ii) Tarifa Ditore e Disbalancimit për Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) do të alokohet çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit proporcionalisht në Kapacitetin e Rezervuar për Kapacitetin në Drejtim të Kundërt (Revers) sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit në atë Ditë Gazi.

10.4 Alokimi

- (a) Në rastin kur një Marrëveshje Operacionale e Balancimit është në fuqi në një Pikë specifike të Interkoneksionit dhe nuk është pezulluar, të gjitha Sasitë e Alokua të Tregtarit/Furnizuesit në atë Pikë Interkoneksioni do të jenë të barabarta për Sasitë e tij të Konfirmuara. Diferenca kryesore e Sasive të Alokua në total dhe Sasive të Matura në atë Pikë Interkoneksioni do të alokohet tek një llogari balancimi e mbajtur nga Transportuesi dhe OST e tij Fqinje.
- (b) Nëse një Marrëveshje Operacionale e Balancimit nuk është në fuqi në një Pikë specifike të Interkoneksionit, ose nëse është pezulluar, ose nëse është aplikuar Paragrafi 17.3 (d)(i)(B), atëherë Sasitë e Alokua do të llogariten duke përdorur rregullin e alokimit proporcional:
 - (i) Sasitë e Alokua për çdo Palë Tregtarësh/Furnizuesish për Nominimet në drejtim të kundërt të rrjedhës së gazit në një Pikë Interkoneksioni do të jenë të barabarta me Sasitë e Konfirmuara për atë Palë Tregtarësh/Furnizuesish; dhe
 - (ii) Sasitë e Alokua të çdo Pale Tregtarësh për Nominimet në të njëjtin drejtim me rrjedhën e gazit në një Pikë Interkoneksioni do të llogaritet si (a) shuma e Sasisë totale të Matur për një Ditë përkatëse të Gazit dhe Sasitë e Alokua për rrjedhën e gazit në drejtim të kundërt me rrjedhën e gazit, shumëzuar me (b) përpjestimin e Sasive të Konfirmuara në të njëjtin drejtim me rrjedhën e gazit për atë Palë Tregtarësh/Furnizuesish në shumën e të gjitha Sasive të Konfirmuara në të njëjtin drejtim me rrjedhën e gazit për të gjithë Çiftet e Tregtarëve/Furnizuesve.
- (c) Transportuesi do të njoftojë çdo Tregtar/Furnizues për çdo ndryshim të rregullave të alokimit në një Pikë të caktuar Interkoneksioni sa më shpejt që të jetë e arsyeshme.
- (d) Nëse një Tregtar/Furnizues ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme për Transportin e Gazit në një Pikë specifike Hyrëse ose Dalëse në një Ditë specifike Gazi, atëherë me qëllim përcaktimin e Sasive të Alokua sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit, Sasitë e Alokua do të alokohen për çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit në mënyrë proporcionale me Kapacitetin e Rezervuar sipas çdo Marrëveshje të tillë për Transportin e Gazit në atë Ditë Gazi.

10.5 Alokimi tek Pikat Virtuale të Tregëtimit

Sasitë e Alokua në Pikën Virtuale të Tregëtimit do të jenë të barabarta me Sasitë e Konfirmuara.

10.6 Alokimi i Përkohshëm

- (a) Transportuesi do t'i komunikojë çdo Tregtari/Furnizuesi Sasitë e Përkohshme të alokuara të tij për secilën Pikë Interkoneksioni dhe Pikën Virtuale të Tregëtimit, ku Tregtari/Furnizuesi ka Sasitë e Konfirmuara, në një formë që specifikon Ditën përkatëse të Gazit Sasitë e Përkohshme të Alokua duke marrë parasysh sasitë e alokuara përkohësisht për orët që kanë kaluar në Ditën e Gazit dhe Sasitë e Konfirmuara për orën (et) e mbetura të Ditës së Gazit.
- (b) Transportuesi do të përpiqet të dërgojë një njoftim të tillë jo më vonë se [45 minuta] pas përfundimit të çdo ore në një Ditë Gazi. Transportuesi mund të rishikojë njoftimin e tij nëse ka dijeni për ndonjë gabim material në Sasitë e Përkohshme të Alokua.
- (c) Njoftimet për Sasitë e përkohshme të Alokua të një Tregtari/Furnizuesi do të jenë vetëm për informacion dhe nuk do të jenë të detyrueshme për Transportuesin. Sasitë Përfundimtare të Alokua do të përfshihen në Deklaratën e Muajit përkatës.

10.7 Marrëveshja e Neutralitetit

- (a) Transportuesi do të mbajë një llogari jo reale (Llogarinë e Neutralitetit) përmes së cilës do të sigurojë që të mbetet financiarisht neutral në lidhje me aktivitetet balancuese. Artikujt e mëposhtëm do të debitohen nga Llogaria e Neutralitetit gjatë çdo Muaj Gazi:
 - (i) të gjitha shpenzimet e bëra nga Transportuesi për blerjen e Gazit Natyror për të zëvendësuar një Disbalancim të Transmetimit në lidhje me çdo Ditë Gazi në atë Muaj Gazi në të cilin totali i Disbalancimit të Transmetimit të të gjithë Tregtarëve/Furnizuesve është negativ; dhe
 - (ii) shumat e kredituara nga Transportuesi për Tregtarët/Furnizuesit në lidhje me Tarifën Ditore të Disbalancimit për atë Muaj Gazi.
- (b) Artikujt e mëposhtëm do të kreditohen në Llogarinë e Neutralitetit gjatë çdo Muaj Gazi:
 - (i) çdo e ardhur (neto e kostove të ndërlidhura) të marra nga Transportuesi në shitjen e Gazit Natyror të shkaktuar nga një Disbalancim i Transmetimi në lidhje me çdo Ditë Gazi në të cilin totali i Disbalancimit të Transmetimit të të gjithë Tregtarëve/Furnizuesve është pozitiv (ose, nëse Transportuesi redukton sasinë e Gazit Karburant ose Gazin i cili nuk merret në Konsideratë UFG që do të blinte si pasojë e Disbalancimit të Transmetimit, shuma totale që Transportuesi do të kishte paguar për një sasi të tillë të Gazit Natyror) në rastin kur një shitje e tillë u bë gjatë Muajit përkatës të Gazit; dhe
 - (ii) shumat e faturuara nga Transportuesi për Tregtarët/Furnizuesit në lidhje me Tarifën Ditore të Disbalancimit për atë Muaj Gazi.
- (c) Bilanci në Llogarinë e Neutralitetit:
 - (i) do të kreditohet ose faturohet Palëve të Regjistruara të cilat ishin Tregtarë/Furnizues në Muajin përkatës të Gazit në përfundim të çdo Muaji Gazi sipas Paragrafit 10.8;
 - (ii) do të rikthehet në zero në fillim të çdo Muaji Gazi.

10.8 Shuma e Pagesës së Neutralitetit

- (a) Transportuesi do të kreditojë një shumë të bilancit pozitiv ose do të ngarkojë një shumë të bilancit negativ në Llogarinë e Neutralitetit në fund të çdo Muaji Gazi (**Shuma e Pagesës së Neutralitetit**) në baza mujore për Palët e Regjistruara që kanë Sasi të Alokua në Muajin e Gazit përkatës.
- (b) Shuma e Pagesës së Neutralitetit do të ndahet për secilin Muaj Gazi për secilën Palë të Regjistruar si më poshtë:

$$NPA_S = \frac{A_S}{A_T} \times NPA$$

ku:

NPA_S është Shuma e Pagesës së Neutralitetit që duhet të ndahet nga Transportuesi për Palën e Regjistruar që ishte Tregtari/Furnizuesi gjatë Muajit përkatës të Gazit.

NPA është Shuma e Pagesës së Neutralitetit për atë Muaj Gazi.

A_S është totali i vlerave absolute të Sasive të Alokua të atij Tregtari/Furnizuesi në të gjitha Pikat Interkonjeksionit në atë Muaj Gazi.

A_T është totali i vlerave absolute të Sasive të Ndara për të gjitha Palët e Regjistruara në Pikat e Interkonjeksionit për atë Muaj të Gazit.

- (c) Nëse një Palë e Regjistruar ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme për Transportin e Gazit në një Muaj të veçantë Gazi, atëherë për të caktuar Shumën e Pagesës së Neutralitetit të alokuar sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit, Shuma e Pagesës së Neutralitetit do të alokohet çdo Marrëveshjeje për Transportin e Gazit në mënyrë përpjestimore të Kapacitetit të Rezervuar sipas Marrëveshjes së tillë për Transportin e Gazit gjatë atij Muaji Gazi.
- (d) Vlera e Shumës së Pagesës së Neutralitetit të alokuar për secilën Palë të Regjistruar përkatëse do të përfshihet si një kredi ose një debi, sipas rastit, në Deklaratën Kryesore (dhe secilën Deklaratë Mujore përkatëse) të lëshuar për atë Palë të Regjistruar për Muajin përkatës të Gazit.

11. MIRËMBAJTJE E PLANIFIKUAR

11.1 Njoftimet për Mirëmbajtje

- (a) Transportuesi duhet të kryejë Mirëmbajtjen e Planifikuar:
- (i) të veprojë si një Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm; dhe
 - (ii) vetëm në kohën e specifikuar në Njoftimet e Mirëmbajtjes, dërguar të gjitha Palëve të Regjistruara nga Transportuesi në bazë të Paragrafit 11, pasi Njoftimet e tilla të Mirëmbajtjes mund të ndryshohen në përputhje me Paragrafin 11.2.
- (b) Transportuesi duhet t'i dërgojë një Njoftim Mirëmbajtjeje të gjitha Palëve të Regjistruara:
- (i) në lidhje me Vitin e parë të Gazit, në ose para Ditës së parë të Gazit të atij Viti të parë të Gazit;
 - (ii) në lidhje me çdo Vit të mëpasshëm të Gazit, deri në ose para 30 shtatorit në vitin paraprak të Gazit; dhe
 - (iii) në çdo rast, jo më pak se 42 ditë përpara Ditës së Parë të Gazit në të cilën Mirëmbajtja e Planifikuar është parashikuar të zhvillohet në atë Njoftim Mirëmbajtje.
- (c) Të gjithë Njoftimet e Mirëmbajtjes duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm në lidhje me Vitin e Gazit:
- (i) kohëzgjatjen e të gjitha periudhave të Mirëmbajtjes së Planifikuar, duke specifikuar se cilat ditë të Gazit në atë Vit Gazi preken nga secila periudhë e Mirëmbajtjes së Planifikuar;
 - (ii) një listë të Pikave të Interkoneksionit të prekura nga Mirëmbajtja e Planifikuar në çdo Ditë Gazi të prekur të specifikuar në paragrafin (i) më lart;
 - (iii) uljen e pritshme të Kapacitetit të Rezervuar që Transportuesi mund të vërë në dispozicion të Tregtarëve/Furnizuesve gjatë secilës Ditë Gazi të prekur të specifikuar në paragrafin (i) më lart.
- (d) Transportuesi duhet të publikojë të gjitha Njoftimet e Mirëmbajtjes (duke përfshirë çdo ndryshim të bërë në Njoftimet e Mirëmbajtjes sipas Paragrafit 11.2) në përputhje me Paragrafin 21.
- (e) Në përcaktimin e periudhave të Mirëmbajtjes së Planifikuar që do të përfshihen në Njoftimet e Mirëmbajtjes dhe që do të kryhen gjatë vitit të ardhshëm të Gazit në përputhje me Paragrafin 11.1, Transportuesi duhet, duke vepruar me mirëbesim, të marrë në konsideratë kërkesat për të kryer Mirëmbajtje të Planifikuar në momente specifike gjatë atij Viti pasardhës Gazi të bërë nga Palët e Regjistruara që kanë Kapacitet të Rezervuar në atë Vit Gazi pasardhës, nëse ato kërkesa janë marrë nga Transportuesi para 15 qershorit dhe kërkesa ka të bëjë me Vitin e Gazit që vjen menjëherë pas datës së kërkesës. Transportuesi nuk ka asnjë detyrim të jetë dakord me kërkesat e bëra nga një Palë e Regjistruar sipas këtij paragrafi (e).

11.2 Ndryshimet në Njoftimet e Mirëmbajtjes

- (a) Transportuesi duhet të njoftojë me shkrim të gjitha Palët e Regjistruara deri më ose para datës 1 Mars në çdo Viti Gazi:
- (i) për çdo ndryshim në një Njoftim Mirëmbajtjeje, të dërguar më parë për të gjitha Palët e Regjistruara, nën Paragrafin 11.1 (b) (i) ose Paragrafin 11.1 (b) (ii) (sipas rastit) që ndikojnë në periudhën nga 1 prilli deri dhe përfshirë 30 shtator në atë Vit Gazi; ose

- (ii) që Njoftimi për Mirëmbajtje që u është dërguar më parë të gjitha Palëve të Regjistruara sipas Paragrafit 11.1 (b) (i) ose Paragrafit 11.1 (b) (ii) (sipas rastit) mbetet i pandryshuar në lidhje me periudhën nga 1 prilli deri dhe përfshirë 30 shtator në atë Vit Gazi.
- (b) Transportuesi mund të ndryshojë periudhën e Mirëmbajtjes së Planifikuar të caktuar në një Njoftim Mirëmbajtjeje në çdo kohë para datës që i takon 30 ditë para Ditës së Parë të Gazit në të cilën Mirëmbajtja e Planifikuar mendohet të kryhet në atë Njoftim Mirëmbajtjeje, me kusht që Transportuesi të japë njoftim jo më pak se 30 ditë për fillimin e çdo Mirëmbajtjeje të Planifikuar të rishikuar.
- (c) Të gjitha ndryshimet në Njoftimet e Mirëmbajtjes që u dërgohen Palëve të Regjistruara duhet të shoqërohen me arsyet për ndryshimet e bëra.

11.3 Detyrimet e Transportuesit në lidhje me Mirëmbajtjen e Planifikuar

- (a) Menjëherë pas dhënies ose ndryshimit të një Njoftimi Mirëmbajtjeje, Transportuesi duhet të informojë veç e veç çdo Tregtar/Furnizues për sasinë e Kapacitetit të tij të Rezervuar që Transportuesi nuk është në gjendje ta vërë në dispozicion të tij në çdo Pikë Interkoneksioni për çdo Ditë Gazi gjatë çdo periudhe të Mirëmbajtjes së Planifikuar.
- (b) Transportuesi duhet të përdorë Përprjekje të Arsyeshme për të kryer Mirëmbajtjen e Planifikuar:
 - (i) në kohën dhe datat e specifikuara në Njoftimet e Mirëmbajtjes;
 - (ii) gjatë muajit maj, qershor, korrik ose gusht në çdo Vit Gazi; dhe
 - (iii) në të njëjtën kohë dhe në të njëjtat data që OST-të Fqinje po kryejnë mirëmbajtje të planifikuar në lidhje me një Sistem të Ndërlidhur.
- (c) Çdo reduktim tek aftësia e Transportuesit për të përdorur Kapacitetin e Rezervuar që vjen nga Mirëmbajtja e Planifikuar do të bëhet në përputhje me Paragrafin 12.

11.4 Reduktimi i Mirëmbajtjes së Planifikuar

- (a) Transportuesi mund të:
 - (i) zvogëlojë periudhën e çdo Mirëmbajtjeje të Planifikuar; dhe / ose
 - (ii) rrisë sasinë e Kapacitetit të Rezervuar që do të vihet në dispozicion të Tregtarëve/Furnizuesve gjatë një periudhe Mirëmbajtjeje të Planifikuar,duke dhënë njoftim jo më pak se katër Ditë Gazi të plota për një ndryshim të tillë për Tregtarët/Furnizuesit e prekur.
- (b) Transportuesi mund të njoftojë Tregtarët/Furnizuesit e prekur që është në gjendje të:
 - (i) zvogëlojë periudhën e çdo Mirëmbajtjeje të Planifikuar; dhe / ose
 - (ii) rrisë sasinë e Kapacitetit të Rezervuar që do të vihet në dispozicion të Tregtarëve/Furnizuesve gjatë periudhës së Mirëmbajtjes së Planifikuar, duke dhënë njoftim në më pak se katër Ditë Gazi të plota. Nëse Transportuesi jep një njoftim të tillë, secili Tregtar/Furnizuesi prekur do të ketë të drejtë ta njoftojë Transporterit jo më vonë se 24 orë pas një njoftimi të tillë që nuk dëshiron të përdorë të gjithë ose një pjesë të Kapacitetit të Rezervuar shtesë që Transportuesi është në gjendje t'i vërë në dispozicion atij. Në mungesë të një njoftimi të tillë nga një Tregtar/Furnizuesi prekur, Transportuesi do ta vendosë atë Kapacitet të Rezervuar shtesë në dispozicion të Tregtarëve/Furnizuesve.

- (c) Në qoftë se një Tregtar/Furnizues nuk e njofton Transportuesin se nuk dëshiron të përdorë një sasi shtesë të Kapacitetit të tij të Rezervuar (qoftë në sasi, kohëzgjatje ose të dyja) në përputhje me paragrafin (b) më lart, atëherë Transportuesi do t'i vërë këto sasi shtesë në dispozicion të atij Tregtari/Furnizuesi.
- (d) Çdo Kapacitet i Rezervuar shtesë që Transportuesi njofton se është i disponueshëm në përputhje me paragrafin (b) më lart, por që një Tregtar/Furnizues njofton Transportuesin që nuk dëshiron ta përdorë, mund të konsiderohet nga Transportuesi si Kapacitet i Disponueshëm dhe të ofrohet për rezervim për Palët e Regjistruara në përputhje me Paragrafin 6.
- (e) Transportuesi mund të dërgojë secilin nga njoftimet e përcaktuara në paragrafët (a) dhe (b) më lart në një njoftim të vetëm.
- (f) Për qëllim të llogaritjes së sasisë së Mirëmbajtjes së Planifikuar të kryer nga Transportuesi, gjatë çdo periudhe të Mirëmbajtjes së Planifikuar të njoftuar nga Transportuesi në një Njoftim Mirëmbajtjeje, Transportuesi do të konsiderohet se nuk e bën të disponueshëm Kapacitetin e Rezervuar në përputhje me reduktimin e specifikuar në atë Njoftim Mirëmbajtjeje (pavarësisht nëse Kapaciteti i tillë i Rezervuar është bërë i disponueshëm) përveç kur:
 - (i) Njoftimi i Mirëmbajtjes është ndryshuar në përputhje me Paragrafin 11.2, rast në të cilin ky paragraf (f) do të zbatohet vetëm për çdo reduktim të specifikuar në atë Njoftim Mirëmbajtjeje të ndryshuar;
 - (ii) Transportuesi njofton Tregtarin/Furnizuesin përkatës në përputhje me paragrafin (a) më lart, në këtë rast Transportuesi do të bëjë të disponueshëm Kapacitetin e Rezervuar në sasinë e Kapacitetit të Rezervuar shtesë të specifikuar në atë njoftim nëse Transportuesi e vë në dispozicion të këtij Tregtari/Furnizuesi Kapacitetin e tillë të Rezervuar (pavarësisht nëse Tregtari/Furnizuesi e përdor atë Kapacitet të Rezervuar); dhe
 - (iii) Transportuesi njofton Tregtarët/Furnizuesit përkatës në përputhje me paragrafin (b) më lart, dhe ai Tregtar/Furnizues njofton Transportuesin se dëshiron të përdorë të gjithë ose një pjesë të Kapacitetit të Rezervuar shtesë, atëherë Transportuesi do të vërë në dispozicion Kapacitetin e Rezervuar në sasinë e Kapacitetit të Rezervuar shtesë të specifikuar në njoftimin nga Tregtari/Furnizuesi nëse Transportuesi në fakt e vë atë Kapacitet të Rezervuar në dispozicion të atij Tregtari/Furnizuesi (pavarësisht nëse Tregtari/Furnizuesi e përdor atë Kapacitet të Rezervuar).

12. REDUKTIMI I KAPACITETIT

12.1 Të Përgjithshme

Nëse Transportuesi kufizon përdorimin e të gjithë ose ndonjë pjese të Kapacitetit të Rezervuar tek një Pikë Interkoneksioni për shkak të një Kufizimi ose Ndërprerje të Kapacitetit, ai duhet të përdorë Përpjekjet e tij të Arsyeshme për të dhënë të paktën 45 minuta njoftim paraprak për Tregtarët/Furnizuesit e prekur dhe në çdo rast të njoftojë sa më shpejt që të jetë e praktikueshme sipas rrethanave përkatëse.

12.2 Kufizimi i Kapacitetit dhe Mirëmbajtja e Planifikuar

(a) Çdo mirëmbajtje e Sistemit të Transportit të TAP që nuk është Mirëmbajtje e Planifikuar dhe që redukton aftësinë e Transportuesit për të vënë në dispozicion Kapacitetin e Rezervuar për Tregtarët/Furnizuesit do të konsiderohet një Kufizim i Kapacitetit.

(b) Nëse kërkohet një reduktim i përdorimit të Kapacitetit të Rezervuar te Tregtarët/Furnizuesit, si rezultat i një Kufizimi të Kapacitetit ose Mirëmbajtjes së Planifikuar në një Pikë Interkoneksioni, Transportuesi duhet:

(i) t'i japë përparësi dispozitës në atë Pikë Interkoneksioni të:

(A) Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë mbi Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) dhe Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë;

(B) Kapacitetit Tregtar në drejtim të Kundërt (Revers) mbi Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë;

(ii) të kufizojë përdorimin e Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë sipas Paragrafit 12.5 në masën e nevojshme për të lejuar Transportuesin të vazhdojë të sigurojë Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë dhe Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) në atë Pikë Interkoneksioni;

(iii) nëse i gjithë Kapaciteti në Drejtimin Para i Ndërprerë është kufizuar, kufizoni përdorimin e Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) (derisa ai Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt është Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) në Pikën përkatëse të Interkoneksionit) sipas Paragrafit 12.4 në masën e nevojshme për të lejuar Transportuesin të vazhdojë të sigurojë Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë në atë Pikë Interkoneksioni; dhe

(iv) vetëm nëse i gjithë Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) i Ndërprerë dhe Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) (nëse është e përshtatshme) është kufizuar, kufizoni përdorimin e Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë në atë Pikë Interkoneksioni në përputhje me Paragrafin 12.3,

për sa kohë vazhdon Kufizimi i Kapacitetit ose Mirëmbajtja e Planifikuar.

(c) Nëse Transportuesi kufizon përdorimin e Kapacitetit të Rezervuar si rezultat i një Kufizimi të Kapacitetit, ai duhet menjëherë:

(i) të dërgojë një Njoftim për Kufizimin e Kapacitetit tek të gjitha Palët e Regjistruara;

(ii) të njoftojë çdo Tregtar/Furnizues në lidhje me sasinë e Kapacitetit të tij të Rezervuar në pikën përkatëse të Interkoneksionit që Transportuesi mund të vendosi në dispozicion të tij; dhe

- (iii) kur Transportuesi ka dërguar më parë një Njoftim për Sasitë e Konfirmuara në lidhje me çdo Ditë Gazi që ka të bëjë me Njoftimin për Kufizimin e Kapacitetit, të dërgojë një Njoftim të ri të Sasive të Konfirmuara për të njoftuar Tregtarët/Furnizuesit mbi Sasitë e Konfirmuara të rishikuara në atë Pikë Interkoneksioni.
- (d) Pavarësisht se Transportuesi ka nxjerrë Njoftimin për Kufizimin e Kapacitetit, Tregtarët/Furnizuesit mund të vazhdojnë të paraqesin Nominime dhe Rinominime për Sasitë e Nominuar deri në sasinë e plotë të Kapacitetit të tyre të Rezervuar sikur Kufizimi i Kapacitetit të mos ishte në fuqi. Nëse një ose më shumë Tregtarë/Furnizues paraqesin Nominime ose Rinominime me Sasi të Nominuara që janë më të ulëta se Kapaciteti i Rezervuar që Transportuesi është në gjendje t'i vërë në dispozicion atyre Tregtarëve/Furnizuesve në përputhje me Njoftimin për Kufizimin e Kapacitetit, Transportuesi do t'i vendosë në dispozicion Tregtarëve/Furnizuesve të tjerë një sasi shtesë të Kapacitetit të Rezervuar të barabartë me diferencën midis (i) totalit të këtyre Sasive të Nominuara dhe (ii) Kapacitetit të Rezervuar total në total të atyre Tregtarëve/Furnizuesve në nominim si të reduktuar në përputhje me Njoftimin për Kufizimin e Kapacitetit. Një sasi e tillë shtesë do të vihet në dispozicion nga Transportuesi për Tregtarët/Furnizuesit e tjerë që paraqesin Nominime ose Rinominime të cilat janë më të mëdha se sasia e Kapacitetit të Rezervuar që u është njoftuar atyre në përputhje me paragrafin (c) më lart, si vijon:
 - (i) transportuesi do të alokojë një sasi të tillë shtesë të Kapacitetit të Rezervuar për secilin Tregtar/Furnizues duke kërkuar të gjithë ose një pjesë të tij proporcionalisht me Kapacitetet e Rezervuara të Tregtarëve/Furnizuesve të tillë; dhe
 - (ii) nëse Transportuesi mund ta vendosë në dispozicion të një Tregtari/Furnizuesi të tillë që ka bërë kërkesën më shumë nga Kapaciteti i Rezervuar i këtij Tregtari/Furnizuesi sesa sasia e Kapacitetit të Rezervuar në dispozicion të njoftuar për Tregtarin/Furnizuesin në përputhje me paragrafin (c) më lart, Transportuesi do të konsiderohet se e ka vënë në dispozicion atë sasi kapaciteti me qëllim të llogaritjes së Tarifës Mujore Aktuale.
- (e) Nëse Kufizim i Kapacitetit vazhdon si rezultat i ngjarjes së një Force Madhore, Transportuesi mund të përfshijë në çdo Njoftim për Kufizimin e Kapacitetit detaje të tilla në lidhje me atë Force Madhore si kërkohet të ofrohet sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit për të përmbushur kërkesat e tij për të dhënë njoftimin e asaj Force Madhore sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit.

12.3 Kufizimi i Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë

Nëse Transportuesit i kërkohet të redukojë Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë në një Pikë Interkoneksioni, ai do të kufizojë aftësinë e çdo Tregtari/Furnizuesi për të përdorur Kapacitetin Rezervë për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë në atë Pikë Interkoneksioni në një bazë proporcionale për Kapacitetin e Rezervuar të secilit Tregtar/Furnizues për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë në atë Pikë Interkoneksioni.

12.4 Ndërprerja dhe Kufizimi i Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers)

- (a) Përveç rrethanave të përcaktuara në Paragrafin 12.2, Transportuesi do të ndërpresë Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) në çdo Pikë të kombinuar Hyrëse dhe Dalëse të cilat formojnë Rrugën Tregtare në Drejtim të Kundërt (Revers) nëse:
 - (i) tek një Pikë Interkoneksioni ku Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt ka Drejtim të kundërt me Pikën e Interkoneksionit, rrjedha e Gazit Natyror në Drejtim të Pikës së Interkoneksionit është e pamjaftueshme për të ofruar Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt në atë Pikë Interkoneksioni pas ndërprerjes së Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Ditës në Avance të Nderprerë sipas Paragrafit 12.5; ose
 - (ii) ka Rrjedhë të pamjaftueshme në drejtim të Perëndimit (Fizike) midis Pikës Hyrëse dhe Pikës Dalëse për të lejuar Rrjedhën në Drejtim të Lindjes (Tregtare).
- (b) Nëse Transportuesi ndërpret Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt (revers) për shkak të një Ndërprerjeje, ai duhet:

- (i) të dërgojë menjëherë një Njoftim për Ndërprerje tek të gjithë Tregtarët/Furnizuesit e prekur sipas Proçesit të Përputhjes;
 - (ii) të informojë çdo Tregtar/Furnizues të prekur mbi sasinë e Kapacitetit të tij të Rezervuar në Pikën përkatëse të Interkoneksionit që Transportuesi është në gjendje të vendosë në dispozicion të tij; dhe
 - (iii) të dërgojë menjëherë një Njoftim të ri mbi Sasinë e Konfirmuara për të njoftuar Tregtarët/Furnizuesit për Sasinë e Konfirmuara të rishikuara tek ajo Pikë Interkoneksioni.
- (c) Nëse Transportuesi kufizon përdorimin e të gjithë ose ndonjë pjese të Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt (revers) tek një Pikë e prekur Interkoneksioni (qofte kjo për shkak të Mirëmbajtjes së Planifikuar, Kufizimit të Kapacitetit ose për shkak të një Ndërprerje), Transportuesi duhet të kufizojë përdorimin e Kapacitetit Tregtar në Drejtim të Kundërt sipas rregullit më poshtë të përparësisë:
- (i) së pari, Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt Ditor;
 - (ii) së dyti, Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt Mujor;
 - (iii) së treti, Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt Tremujor; dhe
 - (iv) së katërti Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt Vjetor,

dhe nëse kërkohet të kufizohet jo i gjithë Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt (revers) sipas paragrafeve nga (i) në (iv) më sipër, i gjithë Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt sipas atij Paragrafi do të kufizohet në mënyrë proporcionale;

12.5 Ndërprerja dhe Kufizimi i Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë

- (a) Përveç rrethanave të përcaktuara në Paragrafin 12.2, Transportuesi mund të ndërpresë të gjithë ose ndonjë pjesë të çdo Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë:
- (i) të ofruar në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkoneksionit, nëse Sasinë e Nominuara të marra nga Transportuesi janë më të mëdha se kapaciteti që Transportuesi është në gjendje të vendosë në dispozicion në atë Pikë Interkoneksioni; dhe
 - (ii) të ofruar në Drejtimin e Kundërt të Pikës së Interkoneksionit nëse rrjedha e Gazit Natyror në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkoneksionit është e pamjaftueshme për të ofruar Kapacitet në Drejtimin Përpara të Ndërprerë për Drejtimin e Kundërt të Pikës së Interkoneksionit në atë Pikë Interkoneksioni.
- (b) Nëse Transportuesi ndërpret Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë për shkak të një Ndërprerjeje, ai duhet:
- (i) të dërgojë menjëherë një Njoftim për Ndërprerje tek të gjithë Tregtarët/Furnizuesit e prekur sipas Proçesit të Përputhjes;
 - (ii) të informojë çdo Tregtar/Furnizues të prekur mbi sasinë e Kapacitetit të tij të Rezervuar në Pikën përkatëse të Interkoneksionit që Transportuesi është në gjendje të vendosë në dispozicion të tij; dhe
 - (iii) të dërgojë menjëherë një Njoftim të ri mbi Sasinë e Konfirmuara për të njoftuar Tregtarët/Furnizuesit për Sasinë e Konfirmuara të rishikuara për atë Pikë Interkoneksioni.
- (c) Nëse Transportuesi kufizon përdorimin e të gjithë ose ndonjë pjese të Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë në një Pikë Interkoneksioni (qoftë për shkak të Mirëmbajtjes së Planifikuar,

një Kufizimi të Kapacitetit ose një Ndërprerje), Transportuesi duhet të kufizojë përdorimin e Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Ndërprerë në atë Pikë Interkoneksioni:

- (i) së pari, në rend të kundërt orar, në mënyrë që Kapaciteti i Rezervuar (duke qenë Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) i Ndërprerë) në atë Pikë Interkoneksioni që ka Datën Kontraktuale më të fundit do të kufizohet i pari dhe Kapaciteti i Rezervuar (duke qenë Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) i Ndërprerë) në atë Pikë Interkoneksioni që ka Datë Kontraktuale më të hershëm do të kufizohet e fundit; dhe
- (ii) së dyti, në bazë proporcionale, nëse dy ose më shumë kontrata të Kapacitetit të Rezervuar (duke qenë Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) i Ndërprerë) në atë Pikë Interkoneksioni kanë të njëjtën Datë Kontraktuale.

12.6 Kufizimet e vazhdueshme të Kapacitetit

- (a) Nëse, ndërsa një Ndërprerje po vazhdon, ndonjë nga informacionet e dhëna nga Transportuesi në një Njoftim për Kufizim të Kapacitetit që është dërguar më parë nga Transportuesi në lidhje me atë Ndërprerje bëhet e pasaktë, Transportuesi duhet të dërgojë një Njoftim të Kufizimit të Kapacitetit të përditësuar sa më shpejt që të jetë e mundur pasi është vënë në dijeni për pasaktësitë që pasqyrojnë informacionin që më pas është i saktë. Nëse Transportuesi nxjerr një Njoftim për Kufizim të kapacitetit të përditësuar i cili ndryshon sasinë e Kapacitetit të Rezervuar që i nënshtrohet Kufizimit të Kapacitetit, Transportuesi do të informojë çdo Tregëtar/Transportues që i preket sasia e Kapacitetit të tij të Rezervuar në Pikën Përkatëse të Interkonjeksionit që Transportuesi është në gjendje ta vendosë në dispozicion.
- (b) Transportuesi duhet, menjëherë pas përfundimit të një Kufizimi të Kapacitetit, të dërgojë një Njoftim të Përfundimit të Kufizimit të Kapacitetit për të gjithë Tregtarët/Furnizuesit e prekur.
- (c) Transportuesi jo më vonë se tre Muaj Gazi pas përfundimit të Kufizimit të Kapacitetit, duhet të sigurojë një raport, duke detajuar arsyet e këtij Kufizimi të Kapacitetit dhe veprimet përkatëse të ndërmarra nga Transportuesi ndërkohë që Kufizimi i Kapacitetit vazhdonte, për të gjithë transportuesit e prekur dhe në masën që kërkohet nga Legjislacioni në fuqi, Autoritetet Qeveritare.
- (d) Çdo Transportues i prekur, deri në (dhe duke përfshirë) datën që i takon gjashtë Muaj Gazi pas përfundimit të një Kufizimi të Kapacitetit, mund të kërkojë, me shpenzimet e veta, një kontroll nga një auditues i pavarur për Kufizimin e Kapacitetit dhe veprimet e ndërmarra nga Transportuesi ndërsa ky Kufizimi i Kapacitetit po vazhdonte.

12.7 Vazhdimi i Ndërprerjeve

- (a) Nëse, ndërsa një Ndërprerje po vazhdon, ndonjë nga informacionet e dhëna nga Transportuesi tek Njoftimi për Ndërprerje që është dërguar më parë nga Transportuesi në lidhje me atë Ndërprerje bëhet i pasaktë, Transportuesi duhet të dërgojë një Njoftim të përditësuar për Ndërprerjen për të gjithë Tregëtarët/Furnizuesit e prekur sa më shpejt që të jetë e arsyeshme, pasi të vihet në dijeni për pasaktësinë përkatëse duke pasqyruar informacionin që është i saktë.
- (b) Transportuesi duhet, menjëherë pas përfundimit të Ndërprerjes, të dërgojë një Njoftim të Përfundimit të Ndërprerjes për të gjithë Tregtarët/Furnizuesit e prekur.

13. MENAXHIM I MBINGARKESAVE (KONGJESTION, TRAFIK)

13.1 Dorëzimi i kapacitetit

- (a) Dorëzimi i kapacitetit është procesi nëpërmjet të cilit një Tregtar/Furnizues mund të lëshojë të gjithë ose një pjesë të Kapacitetit të tij në drejtimin Përpara (Forward) të Sigurt, (përveç Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Sigurt Ditor), në një Pikë Interkoneksioni, në mënyrë që Transportuesi të mund të ofrojë kapacitetin e lëshuar si Kapacitet i Disponueshëm në përputhje me procedurat e specifikuar në Paragrafin 5.5.
- (b) Çdo Kapacitet në Drejtimin Përpara i Pandërprerë i lëshuar duhet të jetë me një kohëzgjatje që korrespondon me Produktin e vetëm të Kapacitetit që përbën Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Sigurt Afatgjatë, dhe çdo Kapacitet Tregtar në drejtim të Kundërt (revers) të lëshuar që duhet të jetë me një kohëzgjatje e cila korrespondon me Produktin e vetëm të Kapacitetit i cili përbën Kapacitetin Tregtar në drejtim të Kundërt (revers), në mënyrë që kapaciteti i lëshuar të mund të ofrohet si një produkt i vetëm në një ankand të vetëm. Palët e Regjistruara që dëshirojnë të Dorëzojnë kapacitetet shtesë duhet ta bëjnë këtë me anë të kërkesave të veçanta.
- (c) Një Tregtar/Furnizues mund të lëshojë Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) të Sigurt që korrespondon me Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Sigurt Vjetor për Vitin e ardhshëm të Gazit që do të ofrohet në ankand.

13.2 Procedura e Dorëzimit të kapacitetit

- (a) Një Transportues që dëshiron të Dorëzojë Kapitalin e Rezervuar, kërkohet të dërgojë një Kërkesë Dorëzimi Transportuesit përmes Platformës së Rezervimit të Kapacitetit. Kërkesa e Dorëzimit duhet të pranohet nga Transportuesi jo më vonë se ora 10:00 e datës që i takon dy Ditë Pune para datës së publikimit të Kapacitetit të Disponueshëm për ankandin përkatës, në të cilin Kapaciteti i Dorëzuar do të ofrohet dhe duhet të specifikojë:
 - (i) pikën e Interkonjeksionit në të cilën po Dorëzohet Kapaciteti i Rezervuar;
 - (ii) sasia dhe Produkti i Kapacitetit të Kapacitetit të Rezervuar që po Dorëzohet;
 - (iii) kohëzgjatja e Dorëzimit (që korrespondon me një nga produktet standarde të Kapacitetit të përcaktuara më lart); dhe
 - (iv) nëse Kapaciteti i Dorëzuar është Kapacitet i Grupuar apo jo.
- (b) Nëse një Kërkesë për Dorëzim plotëson kërkesat e përcaktuara në paragrafin (a) më sipër, Transportuesi duhet të njoftojë Tregtarin/Furnizuesin që ka paraqitur Kërkesën për Dorëzimit që Kërkesa për Dorëzim është pranuar brenda një Dite Pune nga marrja e Kapacitetit të Dorëzuar.
- (c) Një Kërkesë për Dorëzim, kur dërgohet nga Tregtari/Furnizuesi, nuk mund të tërhiqet, anulohet ose ndryshohet nga ai Tregtar/Furnizues.
- (d) Pas njoftimit se Kërkesa për Dorëzim është pranuar nga Transportuesi:
 - (i) Kapaciteti i Dorëzuar do të përfshihet tek sasia e Kapacitetit të Disponueshëm të ofruar nga Transportuesi në ankandet përkatëse të Kapacitetit të Disponueshëm, në përputhje me procedurat e specifikuar në Nenin 5.5; dhe
 - (ii) Tregtari/Furnizuesi përkatës duhet t'i paguajë një tarifë Transportuesit në shumën € 2,000 (dy mijë) për Kërkesën për Dorëzim kur kjo kërkesë të pranohet.
- (e) Në çdo ankand për të cilin ofrohet Kapacitet i Dorëzuar ose Kapacitet i Terhequr, Transportuesi do të:

- (i) së pari, alokojë Kapacitetin e Disponueshëm që nuk është Kapaciteti i Dorëzuar ose Kapaciteti i Tërhequr;
 - (ii) së dyti, alokojë Kapacitetin e Disponueshëm që është Kapaciteti i Dorëzuar, dhe
 - (iii) së treti, alokojë Kapacitetin e Disponueshëm që është Kapaciteti i Tërhequr.
- (f) Nëse më shumë se një Tregtar/Furnizues ka ofruar Kapacitet të Dorëzuar, Kapaciteti i Dorëzuar do të ofrohet në ankandet përkatëse sipas nje afati, në mënyrë që të rialokohet sipas rendit në të cilin Kërkesat për Dorëzim që kanë të bëjnë me atë Kapacitet të Dorëzuar janë marrë nga Transportuesi.
- (g) Menjëherë pas përfundimit të një ankandi në të cilin është ofruar Kapaciteti i Dorëzuar:
- (i) Transportuesi do të njoftojë secilin Tregtar/Furnizues me Kapacitet të Dorëzuar në atë ankand me email për sasinë e Kapacitetit të tyre të Dorëzuar që është rialokuar në atë ankand dhe sasinë e Kapacitetit të tyre të Dorëzuar që nuk është rialokuar në atë ankand, në secilin rast menjëherë pasi ankandi është mbyllur; dhe
 - (ii) nëse Kapaciteti i Dorëzuar i nënshtrohet një Çmimi Ankandi, Tregtari/Furnizuesi dorëzues përkatës duhet t'i paguajë Transportuesit shumën (nëse ka) e llogaritur në përputhje me Nenin 13.7.
- (h) Pas çdo ankandi në të cilin ofrohet Kapital i Dorëzuar, Kërkesa për Dorëzim që lidhet me atë Kapacitet të Dorëzuar nuk do të ketë më efekt. Nëse ndonjë Kapaciteti i Dorëzuar nuk rialokohet në një ankand në tërësi dhe Tregtari/Furnizuesi dëshiron që Kapaciteti i Rezervuar të ofrohet përsëri në ankandin tjetër, është përgjegjësi e Tregtarëve/Furnizuesve që të dorëzojnë atë Kapacitet të Rezervuar para ankandit tjetër në dispozicion duke dërguar një Kërkesë të re për Dorëzim tek Transportuesi.
- (i) Tregtari/Furnizuesi ruan të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit për Kapacitetin e Dorëzuar derisa ky Kapaciteti i Dorëzuar të alokohet nga Transportuesi tek një ose më shumë Tregtar/Furnizues të rinj (me përjashtim të çdo aftësie të Tregtarëve/Furnizuesve për ta tregtuar atë Kapacitet të Rezervuar në përputhje me Nenin 7), pas së cilës Tregtari/Furnizuesi i parë nuk do të ketë ndonjë të drejtë ose detyrim në lidhje me Kapacitetin e tillë të Dorëzuar të rialokuar për kohëzgjatjen e Dorëzimit dhe sasia e Kapacitetit të Rezervuar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit do të konsiderohet e reduktuar me një sasi dhe për një kohëzgjatje të barabartë me Kapacitetin e Dorëzuar të tillë të rialokuar.

13.3 Përdore ose Humbe në terma afatgjatë (Long Term Use It or Lose It) (LT UIOLI)

- (a) Transportuesi do të monitorojë përdorimin e Produkteve të Kapacitetit LT UIOLI të Tregtarëve/Furnizuesve në secilën Periudhë Monitorimi për të përcaktuar Përdorimin Mesatar të një Kapaciteti të tillë të Rezervuar.
- (b) Përdorimi mesatar (**Average Utilization**) në një Pikë Interkoneksioni në çdo Periudhë gjashtë mujore në një Periudhë Monitorimi llogaritet si mesatarja aritmetike e të gjithë Sasive të Alokua të Tregtarëve/Furnizuesve në lidhje me Produktet e Kapacitetit LT UIOLI në atë Pikë Interkoneksioni në atë Periudhë Gjashtë Mujore e pjesëtuar me mesataren e Kapacitetit të Rezervuar të atij Tregtari/Furnizuesi që përbëhet nga Produktet e Kapaciteteve LT UIOLI në atë Pike Interkonjeksioni gjatë asaj Periudhe Gjashtë Mujore. Për këtë qëllim nëse Tregtari/Furnizuesi ka Kapacitet të Rezervuar për Produkte Kapacitetesh të ndryshme, Produktet e Kapacitetit LT UIOLI supozohet të jenë prioritare në raport me çdo Produkt tjetër kapaciteti me një kohëzgjatje më të shkurtër.
- (c) Transportuesi do t'i dërgojë jo me vonë se dy jave pas përfundimit të Periudhës së Monitorimit një raport vjetor të përdorimit të gjitha Palëve të Regjistruara dhe të gjitha Autoriteteve Rregullatore. Ky raport përdorimi i dërguar Autoriteteve Rregullatore do të përmbajë Përdorimin Mesatar për çdo Tregtar/Furnizues dhe Pikën e Interkoneksionit për çdo periudhë gjashtë mujore gjatë Periudhës së Monitorimit. Raporti i përdorimit i dërguar Palëve të Regjistruar do të përmbajë vetëm Përdorimin

Mesatar të të gjithë Tregtarëve/Furnizuesve në secilën Pikë Interkonjeksioni dhe (nëse është e përshtatshme) Përdorimin Mesatar të atij Tregtari/Furnizuesi në secilin Pikë Interkonjeksioni.

- (d) Pas përfundimit të një Periudhe Monitorimi, Transportuesi do të fillojë procedurën vetëm për të përcaktuar nëse LT UIOLI duhet të zbatohet nëse vëren shfaqjen e ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme kontraktuale të mbingarkesës gjatë Periudhës së Monitorimit (secila një Rast Kontraktual Mbingarkese LT UIOLI):
- (i) i gjithë Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) i Sigurt Vjetor për Vitin e ardhshëm të Gazit u shit në ankandin përkatës dhe një Çmim Ankandi u vu re për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Sigurt Vjetor për Vitin e ardhshëm të Gazit; ose
 - (ii) i gjithë Kapaciteti në drejtimin Përpara i Sigurt Tremujor për Vitin e ardhshëm të Gazit u shit në ankandin përkatës dhe një Çmim Ankandi u vu re për të paktën dy Produkte Kapaciteti për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë Tremujor për Vitin e ardhshëm të Gazit.

13.4 Mos-shfrytëzimi sistematik dhe përjashtimet

- (a) Nëse vërehet një Rast Kontraktual i Mbingarkesës LT UIOLI, Transportuesi do t'i paraqesë Autoritetit Rregullator një njoftim (**Njoftim i mbingarkesës**) në të njëjtën kohë kur paraqet raportin vjetor të përdorimit sipas Nenit 13.3 (c).
- (b) Në Njoftimin e Mbingarkesës Transportuesi do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
- (i) një përshkrim të Ngjarjes së Mbingarkesës Kontraktuale LT UIOLI duke përfshirë:
 - (A) informacion nëse Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) i Pandërprerë Vjetor për Vitin e ardhshëm të Gazit është shitur në ankandin përkatës dhe nëse është vërejtur një Çmim Ankandi për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë Vjetor
 - (B) informacion nëse Kapaciteti në drejtimin Përpara (Forward) i Pandërprerë Tremujor për Vitin e ardhshëm të Gazit është shitur në ankandin përkatës dhe nëse është vërejtur një Çmim Ankandi për të paktën dy Produkte Kapaciteti për Kapacitetin në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë Tremujor për Vitin e ardhshëm të Gazit
 - (ii) për çdo Tregtar/Furnizues në lidhje me Produktet e Kapacitetit LT UIOLI:
 - (A) një listë të të gjitha Kërkesave për Dorëzim të paraqitura nga ai Tregtar/Furnizues gjatë Periudhës së Monitorimit, duke përfshirë:
 - I. pikën e Interkonjeksionit në të cilën Kapaciteti i Rezervuar u Dorëzua;
 - II. sasinë e Kapacitetit të Rezervuar të Dorëzuar dhe Produktin e Kapacitetit;
 - III. kohëzgjatjen e Dorëzimit;
 - IV. nëse Kapaciteti i Dorëzuar është Kapaciteti i Lidhur; dhe
 - V. sasinë e Kapacitetit të Dorëzuar që u ri-rezervua dhe rezultatet e ankandëve në të cilat u ofrua Kapaciteti i Dorëzuar.
 - (B) një listë të ofertave për Transferimin e Kapacitetit të Rezervuar për Palët e tjera të Regjistruara në Platformën e Rezervimit të Kapacitetit ose ofertat për delegim me një çmim jo më të madh se Çmimi i Rezervës së Produktit përkatës të Kapacitetit ose Kapaciteti i Rezervuar gjatë Periudhës së Monitorimit, duke përfshirë:

- I. pikën e Interkonjeksionit që lidhet me Transferimin ose Delegimin;
- II. sasinë e Kapacitetit të Rezervuar të ofruar dhe Produktin e Kapacitetit;
- III. kohëzgjatjen e Transferimit ose Delegimit të propozuar;
- IV. nëse Kapaciteti i ofruar është Kapacitet i Grupuar;
- V. çmimin me të cilin është bërë oferta dhe Çmimin përkatës të Rezervë; dhe
- VI. sasia e Kapacitetit të Rezervuar transferuar ose deleguar si rezultat i ofertës.

(C) çdo informacion tjetër që idhet me bazën në të cilën Tregtari/Furnizuesi është përpjekur të ofrojë Kapacitetin e Rezervuar për Palët e tjera të Regjistruara dhe / ose përmes Kërkesave për Dorëzim; dhe

(iii) data e propozuar për ankandet në të cilën Transportuesi synon të ofrojë çdo Kapacitet të Tërhequr që rezulton për Palët e Regjistruara, data më e hershme që (në varësi të ndonjë vonese në atë datë që mund të rezultojë nga procesi i përshkruar në paragrafët më poshtë) duhet të jetë jo më vonë se katër Muajt Gazi pas ditës së fundit të Periudhës së Monitorimit.

- (c) Sipas Rregullores (EC) 715/2009, modifikuar me Vendim të Komisionit Europian datë 24 Gusht 2012, procedura LT UIOLI do të aplikohet nëse një ose më shumë Tregtarë/Furnizues nuk kanë shfrytëzuar në mënyrë sistematike Kapacitetin e tyre të Rezervuar të përbërë nga Produkte Kapaciteti LT UIOLI. Kapaciteti i Rezervuar sistematikisht nuk do të shfrytëzohet nëse Përdorimi Mesatar i Tregtarit/Furnizuesit në Pikën e Interkonjeksionit ka qenë më pak se 80% në të dy Periudhat Gjashtëmujore gjatë Periudhës përkatëse të Monitorimit.
- (d) Transportuesi dhe të gjitha Palët e Regjistruara janë në dijeni që Autoritetet Rregullatore përkatëse kanë kompetenca të marrin vendimin final (Vendim i Autoriteteve Rregullatore) në lidhje me tërheqjen e kapacitetit nga Tregtari/Furnizuesi LT UIOLI sipas Procesit të Vendimit të LT UIOLI.
- (e) Transportuesi duhet të njoftojë menjëherë Tregëtarin/Furnizuesin LT UIOLI mbi Vendimin e Autoriteteve Rregullatore dhe si subjekt i çdo vonese tek Procesi i Vendimit LT UIOLI, do të zbatojë tërheqjen dhe ankandin e Kapacitetit të Rezervuar jo më vonë se 4 Muajt Gazi pas ditës së fundit të Periudhës së Monitorimit.
- (f) Transportuesi dhe të gjitha Palët e Regjistruara bien dakord që Vendimi i Autoritetit Rregullator është detyrues.

13.5 Aplikimi i LT UIOLI (Long Term Use It Or Lose It) (Përdore ose humbe në terma afatgjatë)

- (a) Gjatë aplikimit të LT UIOLI, sasia e Kapacitetit të Rezervuar në lidhje me Produktet e Kapacitetit LT UIOLI që do të tërhiqet nga Tregtari/Furnizuesi do të jetë sasia e specifikuar tek Vendimi i Autoritetit Rregullator dhe ky Kapaciteti të Rezervuar do të tërhiqet për:
 - (i) periudhën e mbetur pas Vitit të Gazit pas Periudhës së Monitorimit, deri kur procesi për Vendimin LT UIOLI të ketë përfunduar; dhe
 - (ii) kohëzgjatjen e plote të Vitit në vazhdim të Gazit.
- (b) Nëse LT UIOLI aplikohet, Tregtari/Furnizuesi përkatës duhet t'i paguajë një tarifë Transportuesit në shumën e €10,000.
- (c) Transportuesi do të ofrojë Kapacitetin e Tërhequr në ankandet e ardhshme në dispozicion për Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë Tremujor. Transportuesi do të ofrojë gjithashtu Kapacitetin e Tërhequr në çdo ankand të disponueshëm për Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) i Pandërprerë Mujor për çdo Muajt Gazi që i takon përpara Tremujorit të parë të Gazit të përfshirë në

ankandet e Kapacitetit në drejtimin Përpara (Forward) të Pandërprerë Tremujor në të cilat ofrohet Kapaciteti i Tërhequr. Transportuesi po ashtu do të ofrojë Kapacitetin e Tërhequr tek ankandi për Kapacitetin Vjetor në drejtimin Përpara të Pandërprerë për Vitin në vazhdim të Gazit. Kapaciteti i Tërhequr ofrohet në ankande sipas priorititetit të vendosur në Paragrafin 13.2 (e) dhe nëse nuk rezervohet në tërësi do të alokohet ndërmjet Tregtarëve/Furnizuesve me Kapacitet të Tërhequr në procedurat përkatëse të ankandit në bazë proporcionale me Kapacitetin e tyre të Tërhequr.

- (d) Menjëherë pas përfundimit të një ankandi në të cilin është ofruar Kapaciteti i Tërhequr:
- (i) Transportuesi do të njoftojë secilin Tregtar/Furnizues me Kapacitet të Tërhequr në atë ankand për sasinë e Kapacitetit të Tërhequr të tyre që është rialokuar në atë ankand menjëherë pasi ankandi është mbyllur; dhe
 - (ii) nëse Kapaciteti i Tërhequr ishte subjekt i një Çmimi Ankandi, Tregtari/Furnizuesi përkatës duhet t'i paguajë Transportuesit shumën (nëse ka) e llogaritur në përputhje me Nenin 13.7.
- (e) Tregtari/Furnizuesi LT UIOLI ruan të drejtat dhe detyrimet e tij (përfshirë të drejtën për të paraqitur Nominime për atë Kapacitet të Tërhequr) sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit për Kapacitetin e Tërhequr deri sa Kapaciteti i Tërhequr të jetë ri-rezervuar nga një ose më shumë Tregtarë/Furnizues, në përfundim të së cilit Tregtari/Furnizuesi i parë nuk do të ketë më të drejtat ose detyrimet në lidhje me Kapacitetin e Tërhequr të tillë të rialokuar dhe sasia e Kapacitetit të Rezervuar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit do të konsiderohet e reduktuar në atë sasi dhe për një kohëzgjatje të barabartë me atë Kapacitet të Tërhequr të rialokuar.
- (f) Pas çdo ankandi, tek i cili Kapaciteti i Tërhequr është vendosur në ankand në përputhje me paragrafin (c) më lart, Tregtari/Furnizuesi do të ruajë të drejtat dhe detyrimet e tij për atë periudhë kohe që mbulohet nga ankandi, për çdo Kapacitet të Tërhequr që nuk është alokuar, dhe ai Kapacitet i Rezervuar nuk do të konsiderohet më Kapaciteti i Tërhequr.

13.6 LT UIOLI Informacion jo konfidencial

Nëse aplikohet LT UIOLI, Transportuesi do të duhet të rialokojë kapacitetet e tilla në përputhje me Nenin 13.5. Informacioni i mëposhtëm nuk do të konsiderohet si konfidencial dhe, në veçanti, nuk përbën "informacion konfidencial" për qëllimin të Marrëveshjes së Transportit të Gazit ose Marrëveshjes së Konfidencialitetit:

- (a) përmbajtja e çdo Njoftimi të mbingarkesës, ose raporti përdorimi;
- (b) sasia e Kapacitetit të Rezervuar që është në shqyrtim për tërheqje nga ai Tregtar/Furnizues LT UIOLI;
- (c) përmbajtja e çdo Vendimi Rregullator; dhe
- (d) sasia e Kapacitetit të Tërhequr dhe identiteti i Tregtarëve/Furnizuesve LT UIOLI.

13.7 Çmimi i Ankandit

Në qoftë se:

- (a) një sasi e Kapacitetit të Dorëzuar ose Kapacitetit të Tërhequr që i nënshtrohet një Çmimi Ankandi, si pjesë e Tarifës, i rialokohet një Pale të Regjistruar në përputhje me Paragrafin 13 dhe procedurat e përcaktuara në Paragrafin 5; dhe
- (b) çdo Kapacitet i Rezervuar sipas të cilit Kapaciteti i tillë i Dorëzuar ose Kapaciteti i Tërhequr rialokohet është subjekt i një Çmimi të ri Ankandi që është më pak se Çmimi i vjetër i Ankandit që aplikohet mbi rezervimin e atij Kapaciteti të Dorëzuar ose Kapaciteti të Tërhequr,

atëherë Tregtari/Furnizuesi me Kapacitet të Dorëzuar ose Kapacitet të Tërhequr duhet t'i paguajë Transportuesit për çdo rialokim të Kapacitetit të Rezervuar një shumë të barabartë me Çmimin e Ankandit të pakthyesëm, të llogaritur si:

$$AP = [P_{old} - P_{new}] \times \frac{RC \times D}{365}$$

ku:

AP është shuma totale që paguhet nga Tregtari/Furnizuesi për Transportuesin në lidhje me Çmimin e Ankandit të pakthyesëm për Kapacitetin e Rezervuar.

P_{old} është Çmimi i Ankandit që zbatohet për Kapacitetin e Dorëzuar ose Kapacitetin e Tërhequr.

P_{new} është Çmimi i Ankandit që zbatohet për Kapacitetin e Rezervuar të rialokuar.

RC është sasia në total e Kapacitetit të Dorëzuar ose Kapacitetit të Tërhequr që rialokohet si pjesë e atij Kapaciteti të Rezervuar.

D është kohëzgjatja totale e Kapacitetit të Rezervuar të rialokuar në Ditë Gazi.

14. GAZI KARBURANT

14.1 Gazi Karburant

- (a) Transportuesi do të veprojë si një Operator i Arsyeshëm dhe i Kujdesshëm në përdorimin e Gazit Karburant.
- (b) Transportuesi do të blejë Gaz Karburant sipas një procedure transparente dhe të bazuar në treg, të publikuar në faqen e internetit të Transportuesit. Procedura do të bazohet tek Transportuesi që zhvillon një tender konkurrues për furnizimin me Gaz Karburant në një Pikë Interkoneksioni ose Pikën Virtuale të Tregtimit në baza periodike, por jo më rrallë se çdo vit, për furnizim gjatë periudhës përkatëse.
- (c) Transportuesi mund herë pas here, në diskrecionin e tij, të përditësojë procedurën e përmendur në paragrafin (b) më lart nëse versioni i përditësuar i kësaj procedure mbetet transparent dhe i bazuar në treg pasi të ketë ndodhur ky përditësim.
- (d) Transportuesi mund të përmbushë detyrimin e tij për të blerë Gaz Karburant, sipas paragrafit (b) më sipër, duke blerë ose shitur një sasi të Gazit Natyror që korrespondon me totalin e UFG (i cili mund të jetë një sasi pozitive ose negative), Gazit Karburant (i cili do të jetë një sasi pozitive) dhe totalit të gjithë Disbalancave të Transmetimit (i cili mund të jetë një sasi pozitive ose negative).
- (e) Nëse Transportuesi nuk ka në dispozicion të tij të gjithë informacionin e kërkuar për të llogaritur Çmimin e Gazit Karburant për një Muaj të veçantë Gazi deri në momentin kur kërkohet të lëshojë Deklaratat Mujore përkatëse, Transportuesi do të përfshijë në çdo Deklaratë Mujore Çmimin e Gazit Karburant bazuar në informacionet më të sakta, të disponueshme për të. Pastaj Transportuesi, duhet të dërgojë tek Deklarata Vjetore e ardhshme e çdo Pale të Regjistruar, sipas disponueshmërisë së informacionit ku të përfshijë një përmbledhje të shumës së paguar gjatë Deklaratës Mujore dhe shumës që duhet të paguhet bazuar në Çmimin e Gazit Karburant të përcaktuar përfundimisht në bazë të informacionit të tillë që është vënë në dispozicion në kohë për Deklaratën Mujore përkatëse.

14.2 Alokimi tek Objektet e Gazit Karburant

- (a) Gazi Karburant do të alokohet për Tregëtarët/Furnizuesit në lidhje me çdo Objekt të Gazit Karburant sipas Paragrafit 14. Tregëtari/ Furnizuesi do të ketë Gaz Karburant të alokuar në lidhje me çdo Objekt të Gazit Karburant nëse një Pikë e veçantë Hyrje ose Dalje ku ka Kapacitet në Drejtimin Përpara (Forward) është alokuar për Objektivin e Gazit Karburant sipas tabelave më poshtë:

<i>Pika e Hyrjes</i>	<i>Objekti i Gazit Karburant</i>
Kipoi	Stacioni i Kompresimit CS00
Komotini ¹	
Nea Mesimvria ²	

<i>Pika e Daljes</i>	<i>Objekti i Gazit Karburant</i>
Komotini	–
Nea Mesimvria	–
Kuçovë	–
Fier	–
Melendugno	Stacioni i Kompresimit CS03 dhe Terminali për Marrjen/Pritjen e Gazsjellësit

¹ Në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë për Drejtimin e kundërt Tregtar të Pikës së Interkonjeksionit.

² Në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë për Drejtimin e kundërt Tregtar të Pikës së Interkonjeksionit.

14.3 Shumat e pagueshme në lidhje me Gazin Karburant

- (a) Çdo Tregtar/Furnizues me Kapacitet në drejtimin Përpara (Forward) duhet t'i paguajë Transportuesit një shumë në lidhje me Gazin Karburant të përdorur nga Transportuesi çdo Muaj Gazi në të cilin ai Tregtar/Furnizues ka Sasi të Alokua për Kapacitet në Drejtimin Përpara. Kjo shumë do të llogaritet duke shumëzuar:
- (i) totalin e Gazit Karburant që përdoret nga Transportuesi dhe alokohet për Tregëtarin/Furnizuesin në lidhje me Objektet e Gazit Karburant që aplikohen, të llogaritura sipas dispozitave të Paragrafit 14.5 (sipas sasisë maksimale të Gazit Karburant që do të alokohet për atë Tregëtar/Furnizues sipas Paragrafit 14.4); me
 - (ii) Çmimin e Gazit Karburant.
- (b) Tregtarët/Furnizuesit që kanë Kapacitet Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers) nuk do të kenë Gaz Karburant të alokuar në lidhje me Kapacitetin e tyre Tregtar në Drejtim të Kundërt (Revers).

14.4 Sasia maksimale e Gazit Karburant që do tu alokohet Tregëtarëve/Furnizuesve

- (a) Sasia maksimale e Gazit Karburant që Transportuesi mund ti alokojë një Tregëtar/Furnizuesi në lidhje me Objektet e Gazit Karburant në një Muaj Gazi do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$F_{Max(i)} = Max Xcs \times A_{Sen(i)}$$

ku:

$F_{MAX(i)}$ është sasia maksimale e Gazit Karburant që Transportuesi mund ti alokojë një Tregëtar/Furnizuesi tek Objekti i Gazit Karburant

Max Xc është koeficienti maksimal që do të aplikohet në lidhje me Objektin e Gazit. Ky koeficient do të jetë, për Strukturën përkatëse të Gazit të Karburantit, siç është përcaktuar në tabelën më poshtë:

Objektet e Gazit Karburant	Max Xc
CS00	2% (ose 4% nëse aplikohen përshkruar në paragrafin (b) më poshtë).
CS03 dhe Terminali për	% Marrjen/Pritjen e Gazsjellësit (i kombinuar)

$A_{Sen(i)}$ është Sasia e Alokua në total të Tregëtarit/Furnizuesit në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara (Forward) në lidhje me Objektin e Gazit Karburant për atë Muaj të Gazit. _n

- (b) Transportuesi, që të kryejë funksionin e një Operatori të Arsyeshëm dhe të Kujdesshëm mund të vendosë në rrethana të kufizuara të Rrjedhës (Fizike) në drejtim të Perëndimit të operojë Sistemin e Transportit të TAP duke përdorur kompresorët tek Stacioni i Kompresimit vetëm me CS00 dhe jo atë me kodin CS03. Në këtë rast, Max Xcs do të përshtatet si përcaktohet në tabelën paragrafi (a) më sipër.
- (c) Nëse Gazi Karburant do ti alokohet Tregëtarit/Furnizuesit që ka Kapacitet në Drejtimin Përpara (Forward) në lidhje me një Objekt të veçantë të Gazit Karburant gjatë një Muaji Gazi tejkalon sasinë maksimale të lejuar sipas paragrafit (a) më sipër, Çmimi i Gazit Karburant që aplikohet për Gazin Karburant mbi atë sasi maksimale do të jetë për llogari të Transportuesit.

14.5 Gazi Karburant që do tu alokohet Tregëtarëve/Furnizuesve

- (a) Transportuesi duhet të sigurojë që Gazi Karburant i përdorur tek Objektet e Gazit Karburant matet me Aparat Matës tek Objekti i Gazit Karburant.
- (b) Transportuesi duhet të mbajë shënim Gazin Karburant të përdorur tek Objektet e Gazit Karburant për çdo ditë Gazi dhe duhet ti publikojë Sasitë e Matura të Gazit Karburant të përdorura tek Objekti i Gazit Karburant tek Platforma Elektronike e të Dhënave e TAP në fund të çdo muaji të Gazit.
- (c) Transportuesi, sipas dispozitave të Paragrafit 14.4 duhet të alokojë Gazin Karburant tek çdo Objekt për Gazin Karburant gjatë Muajit të Gazit, matur sipas paragrafit (a) më sipër, për çdo Tregëtar/Furnizues që ka Kapacitet në Drejtimin Përpara (Forward):
- (i) sipas paragrafit (d) më poshtë në rastin e Stacionit të Kompresimit CS00; dhe
- (ii) sipas paragrafit (e) më poshtë në rastin e Stacionit të Kompresimit CS03 dhe Terminalit të Marrjes/Pritjes së Gazsjellësit.
- (d) Gazi Karburant që është përdorur tek Stacioni i Kompresimit CS00 gjatë një Muaj Gazi do të alokohet për çdo Tregëtar/Furnizues që ka Kapacitet në Drejtimin Përpara (Forward) do të llogaritet si më poshtë:

$$F_{S00} = C_{S00} \times \left(\frac{ASLK}{ATLK} \right)$$

ku:

F_{S00} është sasia e Gazit Karburant që do të alokohet nga Transportuesi për Tregëtarin/Furnizuesin që ka Kapacitet në Drejtimin Përpara në lidhje me Stacionin e Kompresimit C_{S00} gjatë një Muaj Gazi, sipas kapacitetit maksimal për këtë alokim sipas Paragrafit 14.4.

C_{S00} është sasia në total e Gazit Karburant e përdorur nga Transportuesi në Stacionin e Kompresimit C_{S00} të atij Muaj Gazi.

$ASLK$ është Sasia e Alokuar në Total e atij Tregëtar/Furnizuesi në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara tek Pika e Hyrjes në Kipoi gjatë atij Muaj Gazi.

$ATLK$ është Sasia e Alokuar në Total e të gjithë Tregëtarëve/Furnizuesve në lidhje me Kapacitetin e tyre në Drejtimin Përpara tek Pika e Hyrjes në Kipoi gjatë atij Muaj Gazi.

- (e) Gazi Karburant i përdorur në Stacionin e Kompresimit CS03 dhe Terminali për Marrjen/Pritjen e Gazsjellësit gjatë një Muaj Gazi që do ti alokohet çdo Tregëtar/Furnizuesi që ka Kapacitet në Drejtimin Përpara do të llogaritet si më poshtë:

$$F_{S03} = (CS03 + PRT) \times \frac{ASLS}{ATLS}$$

ku:

F_{S03} është sasia e Gazit Karburant që do të alokohet nga Transportuesi për Tregëtarin/Furnizuesin që ka Kapacitet në Drejtimin Përpara në lidhje me Stacionin e Kompresimit me kodin C_{S03} dhe Terminalit të Marrjes/Pritjes së Gazsjellësit gjatë Muajit të Gazit, sipas kapacitetit maksimal për këtë alokim sipas Paragrafit 14.4.

C_{S03} është sasia në total e Gazit Karburant të përdorur nga Transportuesi tek Stacioni I Kompresimit CS03 gjatë atij Muaj Gazi

PRT është sasia në total e Gazit Karburant e përdorur nga Transportuesi tek Terminali për Marrjen/Pritjen e Gazsjellësit gjatë atij Muaj Gazi për të nxehur Gazin Natyror për ta çuar atë tek një Sistem i Ndërlidhur në përputhje me specifikimet për pranimin e Gazit Natyror nga ky Sistem i Ndërlidhur.

ASLS është vlera absolute e Sasive të Alokua në total të atij Tregëtari/Furnizuesi në lidhje me Kapacitetin e tij në Drejtimin Përpara (Forward) tek Pika e Daljes në Melendugno gjatë atij Muaj Gazi.

ATLS është vlera absolute e Sasive të Alokua në total të të gjithë Tregëtarëve/Furnizuesve në lidhje me Kapacitetin e tij në Drejtimin Përpara (Forward) tek Pika e Daljes në Melendugno gjatë atij Muaj Gazi.

- (f) Nëse Tregëtari/Furnizuesi ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme të Transportit të Gazit tek një Pikë e caktuar Hyrje ose Dalje gjatë një Muaji të caktuar të Gazit, për të përcaktuar Gazin Karburant të alokuar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit, Gazi do të alokohet për çdo Marrëveshje të Transportit të Gazit në mënyrë proporcionalle me Kapacitetin e Rezervuar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit gjatë atij Muaj Gazi.

14.6 Pika të Tjera Interkonjeksioni dhe ndryshime në metodologji

- (a) Nëse duhet të shtohet një Pikë tjetër Hyrëse ose Dalëse tek Sistemi i Transportit i TAP, Transportuesi do të rishikojë Paragrafin 14 dhe do të propozojë një ndryshim sipas Paragrafit 22 për të reflektuar ndryshimet tek përdorimi i Sistemit të Transportit të TAP si rezultat i këtyre Pikave Hyrëse dhe Dalëse.
- (b) Transportuesi do të rishikojë herë pas here ndryshimet në Kodin e Rrjetit TAP bazuar tek eksperiencia funksionale dhe të dhënat më të fundit. Nëse Transportuesi merr përsipër që të zbatojë një metodologji të rishikuar e cila do të sillte një parashikueshmëri më të madhe të kostos ose avantazhe të tjera, Transportuesi mund të propozojë një modifikim të nenit 14 të këtij kodi sipas nenit 22 të po këtij kodi

15. ENERGJIA ELEKTRIKE

15.1 Energjia Elektrike

- (a) Transportuesi do të veprojë si një Operator i Arsyeshem dhe i Kujdesshem gjatë përdorimit të Energjisë Elektrike.
- (b) Transportuesi duhet të blejë Energji Elektrike sipas një procedurë transparente dhe të bazuar në treg të publikuar në faqen e tij të internetit.
- (c) Transportuesi herë pas here, në diskrecionin e tij, mund të përditësojë procedurën e përmendur në paragrafin (b) më lart nëse versioni i përditësuar i kësaj procedurë mbetet transparent dhe i bazuar në treg pasi të ketë ndodhur ky përditësim.

15.2 Vlerësimi i kostos së Energjisë Elektrike

Transportuesi do të:

- (a) përpara Ditës së parë të Gazit të Vitit të parë të Gazit; dhe
- (b) në ose përpara 30 Shtatorit në çdo Vit Gazi (duke përfshirë dhe Vitin e parë të Gazit),

publikojë në faqen e tij të internetit një formular për vlerësimin e borxhit të kostove dhe shpenzimeve totale (duke përfshirë dhe Taksat) që priten çdo Muaj Gazi të Vitit pasardhës të Gazit në lidhje me blerjen dhe gjenerimin e Energjisë Elektrike (**Vlerësimi i Kostos së Energjisë Elektrike**).

15.3 Vlerësimi i Kostos së Alokimit të Energjisë Elektrike

- (a) Për çdo Muaj Gazi Transportuesi do ti alokojë Vlerësimin e Kostos së Energjisë Elektrike të çdo Tregtari/Furnizuesi që ka Sasi të Alokua në atë Muaj Gazi sipas formulës së mëposhtme:

$$MEPE_S = \frac{MA_S}{MA_T} * MEPE_{TOT}$$

ku:

MEPE_S është Vlerësimi i Kostos së Energjisë Elektrike që i është alokuar një Tregtari/Furnizuesi S

MA_S është totali i vlerave absolute të Sasive të Alokua të Tregtarit/Furnizuesit S në lidhje me të gjitha Produktet e Kapacitetit tek të gjitha Pikat e Interkonjeksionit në atë Muaj Gazi

MA_T është totali i vlerave absolute të Sasive të Alokua të të gjithë Tregtarëve/Furnizuesve në lidhje me Produktet e Kapacitetit në të gjitha Pikat e Interkonjeksionit në atë Muaj Gazi.

MEPE_{TOT} është Vlerësimi i Kostos së Energjisë Elektrike.

- (b) Nëse një Tregtar/Furnizues ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme për Transportin e Gazit në një Muaj të veçantë Gazi, atëherë me qëllim përcaktimin e Vlerësimit të Kostos së Energjisë Elektrike të alokuar sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit, Vlerësimi i Kostos së Energjisë Elektrike do ti alokohet çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit proporcionalisht për Kapacitetin e Rezervuar sipas çdo Marrëveshje të tillë për Transportin e Gazit gjatë atij Muaji Gazi.

15.4 Kosto Aktuale e Energjisë Elektrike

Kostoja Aktuale e Energjisë Elektrike, në lidhje me çdo Muaj Gazi, do të llogaritet si më poshtë:

$$MEP_{TOT} = MEP_{GR} + MEP_{AL} + MEP_{IT}$$

Ku:

MEP_{TOT} është kostoja aktuale e energjisë elektrike për atë muaj të gazit.

MEP_{GR} nënkupton kostot dhe shpenzimet totale (përfshirë Taksat) e Transportuesit në lidhje me blerjen e Energjisë Elektrike në Greqi gjatë atij Muaji të Gazit.

MEP_{AL} nënkupton kostot dhe shpenzimet totale (përfshirë Taksat) e Transportuesit në lidhje me blerjen e Energjisë Elektrike në Shqipëri gjatë atij Muaji të Gazit.

MEP_{IT} nënkupton kostot dhe shpenzimet totale (përfshirë Taksat) e Transportuesit në lidhje me blerjen e Energjisë Elektrike në Itali gjatë atij Muaji të Gazit.

Për qëllimin e këtij paragrafi referencat për blerjen e Energjisë Elektrike do të përfshijnë blerjen e naftës ose karburantit të ngjashëm të blerë për përdorim në çdo gjenerator rezervë të përdorur nga Transportuesi kur Energjia Elektrike e blerë në përputhje me Paragrafin 15.1 nuk është në dispozicion. Transportuesi, duke vepruar si një Operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm, kërkon të minimizojë kostot e prokurimit të ndonjë karburanti të tillë.

15.5 Alokimi i Kostos Aktuale të Energjisë Elektrike

- (a) Për çdo Muaj Gazi Transportuesi do të alokojë Koston Aktuale të Energjisë Elektrike çdo Tregtari/Furnizuesi që ka Sasi të Alokua në atë Muaj Gazi sipas formulës së mëposhtme:

$$MEP_S = \frac{MA_S}{MA_T} \times MEP_{TOT}$$

Ku:

MEP_S nënkupton Koston Aktuale të Energjisë Elektrike që i është alokuar atij Tregtari/Furnizuesi për atë Muaj Gazi.

MA_S nënkupton totalin e vlerave absolute të Sasive të Alokua të atij Tregtari/Furnizuesi në lidhje me të gjitha Produktet e Kapacitetit në të gjitha Pikat e Interkonjeksionit në atë MuajGazi.

MA_T është totali i vlerave absolute të Sasive të Alokua të të gjithë Tregtarëve/Furnizuesvenë lidhje me të gjitha Produktet e Kapacitetit tek të gjitha Pikat e Interkonjeksionit në atë MuajGazi.

MEP_{TOT} është Kostoja Aktuale e Energjisë Elektrike për atë Muaj Gazi.

- (b) Nëse një Tregtar/Furnizues ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme për Transportin e Gazit në një Muaj të veçantë Gazi, atëherë për të përcaktuar Koston Aktuale të Energjisë Elektrike të alokuar sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit, Kostoja Aktuale e Energjisë Elektrike do të alokohet çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit në mënyrë proporcionale sipas Kapacitetit të Rezervuar sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit gjatë atij Muaji të Gazit.

15.6 Pagesa për Energjinë Elektrike

Tregtarët/Furnizuesit duhet të paguajnë Vlerësimin e Kostos së Energjisë Elektrike si pjesë të pagesave mujore sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit. Transportuesi në përputhje me Paragrafin 19, duhet të koordinojë Përlllogaritjet e Kostos së Energjisë Elektrike me Koston Aktuale të Energjisë Elektrike për çdo Tregtar/Furnizues në baza vjetore dhe duhet të përfshijë një pagesë balancimi në shumën e paguar nga Tregtari/Furnizuesi përkatës në çdo Deklaratë Vjetore.

15.7 Ndryshimet për pagesat

Transportuesi do të rishikojë herë pas here metodologjinë aktuale për pagesat e Energjisë Elektrike bazuar në eksperiencën e tij operative dhe në të dhënat më të fundit që ka marrë. Nëse Transportuesi mendon që do të kishte mundësi që të zbatojë një metodologji të rishikuar e cila do të sillte një parashikueshmëri më të madhe të kostos ose avantazhe të tjera, Transportuesi mund të propozojë një modifikim për këtë nen sipas nenit 22 të kodit.

16. UFG (Gazi i cili nuk merret në Konsideratë)

16.1 Blerja dhe shitja e UFG

- (a) Transportuesi duhet të blejë ose shesë një sasi të Gazit Natyror që korrespondon me UFG sipas një procedurë transparente dhe të bazuar në treg, të publikuar në faqen e internetit të Transportuesit. Procedura do të bazohet tek Transportuesi që zhvillon një tender konkurrues për furnizimin e UFG në një Pikë Interkoneksioni ose në Pikën Virtuale të Tregtimit në mënyrë periodike, por jo më rrallë se sa një herë në vit, për furnizim gjatë periudhës përkatëse.
- (b) Transportuesi herë pas here, në diskrecionin e tij, mund të përditësojë procedurën e përmendur në paragrafin (a) më lart nëse versioni i përditësuar i kësaj procedurë mbetet transparent dhe i bazuar në treg pasi të ketë ndodhur ky përditësim.
- (c) Transportuesi mund të përmbushë detyrimin e tij për të blerë ose shitur Gaz sipas paragrafit (a) më sipër duke blerë ose shitur një sasi Gazi Natyror që korrespondon me totalin e UFG (i cili mund të jetë një sasi pozitive ose negative), Gaz Karburant (i cili do të jetë një sasi pozitive) dhe totalin e të gjitha Disbalancave të Transmetimit (i cili mund të jetë ose një sasi pozitive ose negative).
- (d) Nëse Transportuesi nuk ka në dispozicion të tij të gjithë informacionin e kërkuar për të llogaritur Çmimin UFG ose Koston UFG për një Muaj të veçantë Gazit deri në kohën kur kërkohet të lëshojë Deklaratat Mujore përkatëse, Transportuesi do të përfshijë në çdo Deklaratë Mujore Çmimi UFG dhe Koston UFG bazuar në informacionin më të saktë që është në dispozicion të tij. Transportuesi duhet, sa më shpejt të jetë e arsyeshme dhe jo më vonë se Deklarata Vjetore e ardhshme, t'i dërgojë secilës Palë të Regjistruar në fuqi, duke përfshirë një përputhje të shumës së paguar në Deklaratën Mujore përkatëse dhe shumën që duhet të ishte paguar bazuar në Çmimin UFG dhe / ose Koston UFG të përcaktuar të llogaritur në bazë të informacionit të tillë të vënë në dispozicion në kohë për Deklaratën Mujore përkatëse.

16.2 Shumat e pagueshme në lidhje me UFG

- (a) Nëse UFG-ja në lidhje me një Muaj Gazi është negative, kjo shumë do të bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme nga Transportuesi për secilin Tregtar/Furnizues në lidhje me UFG-në e shitur nga Transportuesi gjatë këtij Muaji Gazit. Kjo shumë do të llogaritet duke shumëzuar:
 - (i) vlera absolute e UFG që është shitur nga Transportuesi dhe i është alokuar Tregtarëve/Furnizuesve përkatës, sipas dispozitave të Paragrafit 16.4; duke
 - (ii) Çmimin UFG për kWh minus Koston UFG për kWh në lidhje me UFG e shitur nga Transportuesi.
- (b) Nëse UFG-ja në lidhje me një Muaj Gazi është pozitive, një shumë do të bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme nga secili Tregtar/Furnizues për Transportuesin në lidhje me UFG-në e blerë nga Transportuesi gjatë këtij Muaji Gazit. Kjo shumë do të llogaritet duke shumëzuar:
 - (i) UFG që është blerë nga Transportuesi dhe i është alokuar Tregtarit/Furnizuesit përkatës, e llogaritur sipas dispozitave të Paragrafit 16.4 (sipas shumës maksimale të UFG që do të alokohet atij Tregtari/Furnizuesi sipas Paragrafit 16.5); nga
 - (ii) Çmimi UFG për kWh plus Koston UFG për kWh në lidhje me UFG e blerë nga Transportuesi.

16.3 Llogaritja e UFG

UFG-ja totale për një Muaj Gazi do të llogaritet nga Transportuesi sipas formulës së mëposhtme.

$$UFG = I_T - W_T - F_T - LM - LFM - \Delta Q$$

Ku:

I_T nënkupton shumën e Sasive të Matura të Gazit Natyror në kWh të shpërndara tek Sistemi I Transportit TAP tek të gjitha Pikat e Interkonjeksionit gjatë atij Muaji Gazi.

W_T nënkupton shumën e Sasive të Matura të Gazit Natyror në kWh të rishpërndara nga Sistemi I Transportit i TAP në të gjitha Pikat e Interkonjeksionit gjatë atij Muaji Gazi.

F_T nënkupton sasinë totale të Gazit Karburant të përdorur nga Transportuesi gjatë atij Muaji Gazit.

LM është sasia e Gazit Natyror në kWh që është humbur nga Sistemi i Transportit të TAP gjatë atij Muaji Gazi si rezultat i të gjithë Mirëmbajtjes së Planifikuar dhe Mirëmbajtjes së Paplanifikuar të kryer nga Transportuesi, e llogaritur nga Transportuesi.

LFM është sasia e Gazit Natyror në kWh që është humbur nga Sistemi i Transportit i TAP gjatë atij Muaji Gazi si rezultat i Forces Madhore, llogaritur nga Transportuesi.

ΔQ është diferenca midis sasisë totale të Gazit Natyror në kWh në Sistemin e Transportit të TAP në fillim të Ditës së parë të Gazit për atë Muaj Gazi dhe në përfundim të Ditës së fundit të Gazit për atë Muaj Gazi, e llogaritur sim ë poshtë:

$$\Delta Q = Q_2 - Q_1$$

Ku:

Q_1 nënkupton sasinë totale të Gazit natyror në kWh në Sistemin e Transportit të TAP llogaritur nga Transportuesi në fillim të Dites së parë të Gazit të atij Muaji.

Q_2 nënkupton sasinë totale të Gazit natyror në kWh në Sistemin e Transportit të TAP llogaritur nga Transportuesi në fund të Dites së fundit të atij Muaji Gazi

16.4 Alokimi i UFG për Tregtarët/Furnizuesit

- (a) UFG pozitive ose negative për një Muaj Gazi mund të alokohet nga Transportuesi për secilin Tregtar/Furnizues sipas formulës së mëposhtme:

$$UFG_s = \frac{A_s}{A_T} \times UFG$$

Ku:

UFG_S është sasia e UFG që do t'i ndahet nga transportuesi një dërguesi në lidhje me të gjitha Pikat e Interkoneksionit që i nënshtrohen kufirit maksimal të UFG që do të ndahet nga Transportuesi tek ai dërgues sipas nenit 16.5

UFG është sasia totale e UFG për atë Muaj të Gazit, siç llogaritet sipas seksionit 16.3

A_S është agregati i vlerave absolute të sasive të alokuara të atij dërguesi në të gjitha Pikat e Ndërlidhjes në atë Muaj të Gazit

A_T është agregati i vlerave absolute të sasive të alokuara të të gjithë dërguesve në të gjitha Pikat e Ndërlidhjes në atë Muaj të Gazit

- (b) Nëse një Tregtar/Furnizues ka Kapacitet të Rezervuar sipas Marrëveshjeve të ndryshme për Transportin e Gazit në një Muaj të veçantë Gazi, më pas për të përcaktuar UFG të alokuar sipas çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit, UFG do ti alokohet çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit në mënyrë përpjestimore Kapacitetit të Rezervuar sipas kësaj Marrëveshje për Transportin e Gazit gjatë atij Muaji Gazi.

16.5 Alokimi maksimal i UFG për Tregtarët/Furnizuesit

- (a) Sasia maksimale e UFG që Transportuesi do ti alokojë një Tregtari/Furnizuesi për një Muaj Gazi do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$UFG_{S_{Max}} = \begin{cases} -MaxXcs \times \frac{A_s}{2}, & UFG_S < 0 \\ +MaxXcs \times \frac{A_s}{2}, & UFG_S > 0 \end{cases}$$

ku:

$UFG_{S_{Max}}$ është sasia maksimale e UFG që Transportuesi mund ti alokojë atij Tregtari/Transportuesi në lidhje me atë Muaj Gazi.

$MaxXcs$ është koeficienti që i aplikohet UFG, i barabartë me 1.5%

- (b) Nëse sasia totale e UFG që do ti alokohet një Tregtari/Furnizuesi gjatë çdo Muaj Gazi e tejkalon sasinë maksimale të lejuar sipas paragrafit (a) më lart, sasia me të cilën UFG për atë Muaj Gazi tejkalon sasinë maksimale të lejuar sipas paragrafit (a) më lart do të jetë për llogarinë e Transportuesit.

16.6 Ndryshimet e metodologjisë

Transportuesi do të rishikojë herë pas here metodologjinë aktuale për pagesat UFG bazuar tek eksperiencia e tij operacionale dhe tek të dhënat më të fundit që ka marrë. Nëse Transportuesi mendon që do të kishte mundësinë të zbatonte një metodologji të rishikuar që do ti mundësonte një parashikueshmëri më të madhe të kostos ose avantazhe të tjera, Transportuesi mund të propozojë një modifikim sipas Paragrafit 22 të metodologjisë në këtë Paragraf 16.

17. MATJA DHE SPECIFIKIMET E GAZIT NATYROR

17.1 Specifikimet e Gazit

Për qëllim të çdo Marrëveshje për Transportin e Gazit, “Specifikimi i Pikës Hyrëse” dhe “Specifikimi i Pikës Dalëse” referuar në specifikimet e Gazit Natyror të përcaktuara në Shtojcën 4.

17.2 Pajisja Matëse

- (a) Sasia dhe cilësia e Gazit Natyror e shpërndarë, konsumuar dhe rishpërndarë nga Transportuesi do të matet për arsye operacionale dhe fiskale. Pajisjet e Matjes të përshtatshme për matjen e Gazit Natyror për Sistemin e Transportit të TAP (duke përfshirë ato në pronësi dhe të përdorura nga Transportuesi dhe ato në pronësi dhe të përdorura nga një OST Fqinje) janë të përcaktuara në Pjesën 2 të Shtojcës 1.
- (b) Pajisja Matëse është projektuar dhe operohet sipas ISO 10012 (Sistemet e Menaxhimit të Matjes-kërkesat për Proçeset e Matjes dhe Pajisjet Matëse). Sistemi i Menaxhimit të matjes së Transportuesit siguron që rreziqet në lidhje me sistemet e matjes (si nxjerrjen e rezultateve jo të sakta) janë të zvogëluara dhe menaxhohen në një mënyrë që është në përputhje me dispozitat në vazhdim të Nenit 17.
- (c) Transportuesi, që vepron si Operator i Arsyeshem dhe i Kujdesshem, duhet të sigurojë që:
- (i) të gjitha Pajisjet e Matjes që janë të nevojshme që Transportuesi të pajtohet me Ligjin në fuqi dhe detyrimet sipas këtij Kodi të Rrjetit dhe Marrëveshjeve për Transportin e Gazit janë të instaluar në Sistemin e Transportit të TAP ose në një Sistem Interkonjeksionit;
 - (ii) të gjitha Pajisjet e Matjes që kërkohen të jenë operacionale vazhdimisht vendosen në përdorim dhe performanca e tyre monitorohet;
 - (iii) të gjitha Pajisjet e Matjes janë të Vlefshme dhe të Kalibruara me një frekuencë të specifikuar tek kërkesat e paragrafëve (A) deri tek (C) më poshtë;
 - (iv) të gjitha të Dhënat e Matjes janë Verifikuar, regjistruar dhe do të mbahen për të paktën pesë vjet pasi të jenë nxjerrë dhe
 - (v) hyrjet e të gjitha Kalibrimeve, Verifikimeve dhe Vlefshmërive që kanë ndodhur janë nxjerrë dhe mbahen për të paktën pesë vjet pas nxjerrjes së tyre,

në çdo rast, sipas kërkesave të:

- (A) së pari, të Ligjit që aplikohet për Sistemin e Transportit të TAP;
- (B) së dyti, specifikimet teknike të Sistemit të Transportit të TAP dhe/ose çdo Sistemi përkatës të Interkonjeksionit; dhe
- (C) së treti, Specifikimet Teknike të Pajisjeve të Matjes,

dhe, në rast konflikti midis kërkesave të përcaktuara në paragrafët (A) deri tek (C) më sipër, Transportuesi duhet të sigurojë pajtueshmërinë me kërkesën që renditet më sipër në atë listë.

- (d) Pa ndikuar tek detyrimet e Transportuesit sipas paragrafit (c) më sipër, është pranuar që Transportuesi mund të prokurojë në përputhje me këto detyrime duke nënshkruar marrëveshje kontraktore me një OST Fqinje ose me ofrues tjetër të shërbimit përkatës në mënyrë që të përmbushë detyrimet që janë në emër të tij.

17.3 Korrigjimi i të Dhënave të pasakta të Matjes

- (a) Nëse, në çdo kohë, Transportuesi bëhet i vetëdijshëm se të Dhënat Matëse, të cilat synohet të maten nga Pajisjet Matëse, nuk janë matur ose janë matur në mënyrë të pasaktë për një periudhë kohe, Transportuesi duhet menjëherë:
- (i) të sigurojë që Pajisja Matëse të Validohet dhe, në masën e nevojshme, të rregullohet ose riparohet në mënyrë që të rifillojë matjen e saktë; dhe
 - (ii) të ndër marrë një veprim të tillë pasi është i nevojshëm për të zëvendësuar çdo të Dhënë Matëse të humbur ose jo të saktë me të dhëna të korrigjuara ose vlera të paracaktuara.
- (b) Transportuesi do të veprojë si një Operator i Arsyeshtëm dhe i Kujdesshtëm në përcaktimin e procedurave për zëvendësimin e të Dhënave Matëse të humbura ose jo të sakta dhe mund të mbështetet në këshillat e ekspertëve të palëve të treta. Procedurat që Transportuesi përdor për të përcaktuar të dhëna të korrigjuara ose të paracaktuar përfshijnë në rendin e preferencës:
- (i) nëse është e disponueshme, përdorimi i të dhënave nga matësit shtesë në gatishmëri (standby) ose të kontrollit të instaluar nga Transportuesi ose një OST Fqinje (sipas rastit, duke qenë palë që nuk ka përgjegjësi për Pajisjet Matëse në Pikën përkatëse të Interkoneksionit);
 - (ii) llogaritja e rrjedhës përmes interpolimit;
 - (iii) ekstrapolimi i të dhënave të fundit të vlefshme të rrjedhës;
 - (iv) simulimi i të dhënave të munguara duke balancuar rrjetet në drejtim dhe në drejtim të kundërt të rrjedhës; dhe
 - (v) përdorimi i të dhënave historike në të njëjtat modalitete presioni, temperature dhe kompresori / rregullatori.
- (c) Periudha për të cilën do të aplikohen vlerat zëvendësuese do të jetë një nga:
- (i) periudha gjatë së cilës të Dhënat Matëse nuk u matën ose u matën në mënyrë të pasaktë, nëse dihen; ose
 - (ii) periudha midis datës në të cilën ndodhi Verifikimi i fundit i të Dhënave Matëse dhe data në të cilën u krye rregullimi ose riparimi i Pajisjeve Matëse siç kërkohet nga paragrafi (a) (i) më lart, sipas çdo kufizimi të dhënë për këtë periudhë tek Marrëveshja e Interkoneksionit.
- (d) Nëse ndonjë e Dhënë e Matjes është korrigjuar në përputhje me këtë Nen 17.3:
- (i) nëse të Dhënat e Matjes prekin Gazin Natyror të dorëzuar në një Pikë Interkoneksioni:
 - (A) transportuesi do të komunikojë me OST-në Fqinje përkatëse për të përcaktuar nëse korrigjimi mund të absorbohet ndërmjet Transportuesit dhe OST-së së Fqinje në përputhje me çdo Marrëveshje Interkoneksioni ose Marrëveshje Operacionale të Balancimit në fuqi në atë Pikë Interkoneksioni (ose siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet Transportuesit dhe OST-së Fqinje) pa qenë nevoja për të rishikuar Sasitë e Alokua; dhe
 - (B) nëse nuk është e mundur të absorbohet korrigjimi në përputhje me paragrafin (A) më lart, Sasitë e Alokua do të rishikohen për çdo Ditë Gazi në të cilën aplikohen vlerat e zëvendësimit në përputhje me rregullin e alokimit proporcional në Paragrafin 10.4 (b); dhe
 - (ii) Transportuesi duhet, në masën e nevojshme, të përditësojë çdo Deklaratë të prekur në përputhje me Paragrafin 19.3.

17.4 Kërkesat për Verifikim

- (a) Nëse një Palë e Regjistruar që është ose ka qenë, në kohën përkatëse, një Tregtar/Furnizues beson në mënyrë të arsyeshme se ndonjë Pajisje Matëse nuk është, ose nuk ka qenë, në çdo kohë që nga data që i takon tre muaj para Verifikimit më të fundit, duke matur me saktësi të Dhënat e Matjes, ajo Palë e Regjistruar mund të kërkojë kopje të të gjitha regjistrimeve përkatëse të Kalibrimit, Validimit dhe Verifikimit, të cilat janë të lidhura me periudhën dhe Pajisjet Matëse nën shqyrtim. Transportuesi duhet të sigurojë të gjitha regjistrat e tillë në lidhje me Pajisjen Matëse dhe periudhën përkatëse brenda dy javësh nga një kërkesë e tillë.
- (b) Pas marrjes dhe shqyrtimit të informacionit të parashikuar në paragrafin (a) më sipër, Pala përkatëse e Regjistruar mund, nëse i vërteton Transportuesit se me arsye beson se ka një gabim material në të Dhënat përkatëse të Matjes, të njoftojë Transportuesin se kërkon që Transportuesi të Verifikojë të Dhënat e Matjes.
- (c) Pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin (b) më lart, Transportuesi duhet:
- (i) të kryejë verifikimin i kërkuar është kryer sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme dhe të sigurojë që Pala e Regjistruar ose Konsumatori Përfundimtar të marrin, të paktën pesë ditë pune, njoftim për kohën dhe vendndodhjen e secilit hap të Verifikimit;
 - (ii) të kryejë Verifikimin e kërkuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Paragrafin 17.2 (c) (A) deri në (C); dhe
 - (iii) jo më vonë se katër javë pas përfundimit të Verifikimit të kërkuar, të sigurojë një raport që deklaron nëse Pajisja Matëse përkatëse subjekt i Verifikimit është dhe ishte duke operuar me saktësi dhe në përputhje me Specifikimet Teknike të Pajisjeve Matëse ose jo dhe, nëse është e rëndësishme, të specifikojë çdo veprim që rezulton të jenë ndërmarrë nga Transportuesi.
- (d) Nëse Verifikimi konkludon se:
- (i) Pajisja Matëse është dhe ka qenë duke operuar me saktësi, në përputhje me Specifikimet Teknike të Pajisjeve Matëse, Pala e Regjistruar që kërkon Verifikimin duhet të rimbursojë menjëherë Transportuesin për të gjitha kostot dhe shpenzimet që Transportuesi ose ndonjë prej punonjësve ose kontraktorëve të tij ka paraqitur në lidhje me atë Verifikim dhe prodhimin e raportit; ose
 - (ii) Nëse Pajisja Matëse nuk është ose nuk po operonte siç duhet, Transportuesi do të jetë përgjegjës për çdo kosto ose shpenzim që Transportuesi ose ndonjë nga punonjësit ose kontraktorët e tij kanë në lidhje me atë Verifikim dhe prodhimin e raportit.
- (e) Një Palë e Regjistruar që kërkon një Verifikim ka të drejtë të ketë personelin e tij gjatë Verifikimit, me kusht që Pala e Regjistruar ta ketë përfshirë, në njoftimin e dhënë sipas paragrafit (b) më lart, konfirmimin që synon të ketë prezent personelin e tij dhe emrat dhe detajet e kontaktit të këtij personeli. Pala e Regjistruar ose Konsumatori Përfundimtar është përgjegjës për të siguruar që personeli i saj të respektojë në çdo kohë që ata janë të pranishëm me të gjitha kërkesat e zbatueshme të sigurimit dhe sigurisë, të siguracionit, konfidencialitetit dhe kërkesat ligjore të Transportuesit dhe / ose OST Fqinje përkatëse.
- (f) Nëse një inspektim, auditim ose investigim i Sistemit të Transportit të TAP nga ndonjë autoritet publik, kombëtar ose metrologjik ndodh gjatë ndonjë periudhe Verifikimi të planifikuar në përputhje me Paragrafin 17.4, ai inspektim, auditim ose investigim do të ketë përparësi mbi Verifikimin dhe Transportuesi mund të vonojë atë Verifikim pasi është e nevojshme për të vendosur inspektimin, auditin ose investigimin.
- (g) Nëse Transportuesi vonon Verifikimin, në përputhje me paragrafin (f) më lart, ai duhet të ri-planifikojë Verifikimin, sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, pas përfundimit të inspektimit, auditimit ose investigimit përkatës dhe t'i japë Palës përkatëse të Regjistruar njoftimin të paktën pesë Ditë Pune mbi kohën dhe vendndodhjen e secilit hap të Verifikimit të planifikuar.

18. RISHPËRNDARJA

18.1 Të Përgjithshme

Ky paragrafi përcakton zbatimin e parimeve për llogaritjen dhe alokimin e sasive që kërkohen të rishpërndahen në përputhje me Pjesën 5 të Skedulit të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme GTC 5.

18.2 Fondi special i Autoriteteve Rregullatore

- (h) Sipas Pjesës 5.2 (a) të Skedulit të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme, sasia që do ti transferohet fondit të veçantë të Rregullatorit për secilën Periudhë të Ardhur llogaritet si më poshtë:

$$RAa_t = AMCmtp_t + AMCrfp_t$$

- RAa_t** është shuma që do ti transferohet fondit të veçantë në dispozicion të Autoriteteve për Periudhën e të Ardhurave t
- $AMCmtp_t$** është sasia totale e marrë nga Transportuesi brenda Periudhës së të Ardhurave t nga pjesa e Tarifave Mujore Aktuale që i atribuohen një Çmimi Ankandi që paguhet në përputhje me procedurat e Testimit të Tregut
- $AMCrfp_t$** është sasia totale e marrë nga Transportuesi brenda Periudhës së të Ardhurave t nga pjesa e Tarifave Mujore Aktuale që i atribuohet një Çmimi Ankandi për Kapacitetin Tregtar në drejtim të kundërt (Revers).
- t** tregon periudhën e marrjes së të ardhurave

- (i) Transportuesi do të transferojë të gjithë shumën në fondin special të Rregullatorit në përputhje me udhëzimet e Rregullatorit.

18.3 Kapacitet në Drejtimin Përpara i Ditës në Avancë i Ndërprerë

- (a) Sipas paragrafit 5.2(b) të Skedulimit të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme, sasia që do të rishpërndahet në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë për çdo Periudhë të Marrjes së të Ardhurave për çdo Tregëtar/Furnizues që e ka patur Kapacitetin në Drejtimin Përpara Afatgjatë të Pandërprerë për një periudhë të veçantë llogaritet si më poshtë:

$$RAi_t S_n = \frac{AMCfwd_t S_n}{AMCfwd_t} \times AMCi_t$$

RA_i, S_n sasia e rishpërndarë nga Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Ditës në Avancë i Ndërprerë për Periudhën e Pranimit të të Ardhurave t të alokuara për Tregëtarin/Furnizuesin n.

AMC_i , sasia në total e marrë nga Transportuesi sipas Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t nga Tarifat Aktuale Mujore për Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Ditës në Avancë të Ndërprerë.

AMC_{fwd}, S_n Totali i Tarifës Aktuale Mujore në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara Afatgjatë të Pandërprerë që është marrë nga Transportuesi brenda Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t nga Tregëtari/Furnizuesi n.

AMC_{fwd} , Totali i Tarifës Aktuale Mujore në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara Afatgjatë të Pandërprerë marrë nga Transportuesi brenda Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t.

t Tregon Periudhën e Pranimit të të Ardhurave

- (b) Sasia që do të rishpërndahet për çdo Tregëtar/Furnizues sipas paragrafit (a) më sipër do të përfshihet si kredi tek Deklarata përkatëse Vjetore.

18.4 Të ardhura të tjera: sasia e rishpërndarë

Sipas pjesës 5.2(c) të Skedulit të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme (Schedule GTC 5), sasia që do të rishpërndahet në lidhje me të ardhurat e pranuar nga Transportuesi ndaj të Ardhurave të Synuara do të llogaritet si më poshtë:

$$RAO_t = \max\left(0; (AMCO_{tj} - TRRD_j)\right) + \sum_{j=1}^{-n} (\max(0; AMCO_{tj} - RS_j))$$

ku,

RAO_t , Sasia e rishpërndarë nga të ardhurat e tjera gjatë Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t

$AMCO_{tj}$, Sasia në total e marrë nga Transportuesi brenda Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t nga Tarifat Aktuale Mujore që paguhet për Kapacitetin e Rezervuar gjatë Periudhës së Rishpërndarjes j, duke përfshirë të ardhurat nga AMC_{mp} , AMC_{rfp} dhe AMC_i të përcaktuara më sipër

$TRRD_j$, Të Ardhurat e Synuara (si përcaktuar tek Skeduli i Kushteve dhe Termave të Përgjithshme (**Schedule GTC 5**) gjatë Periudhës së Rishpërndarjes j

RS_j , Mungese e të Ardhurave (që do të thotë $AMCO_j < TRRD_j$) gjatë Periudhës së Rishpërndarjes j, ku $AMCO_j$ do të rritet deri në pikën e pagesave të vonuara që kanë lidhje me Periudhën e Rishpërndarjes j të cilat pranohen nga Transportuesi gjatë Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t

t Tregon Periudhën e Pranimit të të Ardhurave

j Tregon Periudhën e Rishpërndarjes, ku 0 është periudha aktuale e vlerësimit

n Numrin në total të Periudhave të shkuara (të kaluara) të Rishpërndarjes

18.5 Të ardhura të tjera: rialokimi

- (a) Sasia që do të rishpërndahet në lidhje me të ardhurat sipas pjesës 5.2(c) të Skedulit të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme (Pjesa GTC 5), llogaritur në përputhje me Paragrafin 18.4 më sipër, do të alokohet për çdo Periudhë të Pranimit të të Ardhurave për çdo Tregëtar/Furnizues si më poshtë:

$$RAO_t S_n = RAO_t \times \max\left(0; \frac{\max(0; AMC_{0tj} S_n - HAMC_{0tj} S_n)}{AMC_{0tj} - HAMC_{0tj}}\right)$$

- $RAO_t S_n$** është sasia e rishpërndarë e alokuar për Tregëtarin/Furnizuesin n për Periudhën e Pranimit të të Ardhurave t
- RAO_t** është sasia e rishpërndarë nga të ardhurat e tjera për Periudhën e Pranimit të të Ardhurave t llogaritur sipas Paragrafit 18.4 më sipër
- $AMC_{0tj} S_n$** është sasia në total e pranuar nga Transportuesi gjatë Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t nga Tarifat Aktuale Mujore që paguhet për Kapacitetin Rezervë gjatë Periudhës së Rishpërndarjes j nga Tregëtari/Furnizuesi n, përjashtuar të ardhurat nga AMC_{ntp} , AMC_{rfp} dhe AMC_i si përcaktuar më sipër.
- $HAMC_{0tj} S_n$** Të ardhurat e llogaritura në mënyrë hipotetike (sipas supozimeve) nga Tregëtari/Furnizuesi nga Tarifa Aktuale Mujore për të gjitha Produktet e Kapacitetit të marra nga Transportuesi brenda Periudhës së Pranimit të të Ardhurave t në lidhje me Shërbimet e Transportit gjatë Periudhës së Rishpërndarjes j, që aplikohen vetëm si tarifa hyrëse dhe dalëse llogaritur sipas formulave të paragrafeve 4.1 – 4.4 të Skedulit të Termave dhe Kushteve të Përgjithshme 5 me C të ripërcaktuar si Kapaciteti mesatar Rezervë për Produktet e Kapacitetit në Drejtimin Përpara të Pandërprerë gjatë Periudhës së Rishpërndarjes që paguhet sipas Periudhës së Pranimit të të Ardhurave

Nëse AMC_{0tj} është e barabartë me $HAMC_{0tj}$ (p.sh. për shkak të Kapacitetit Komercial në Drejtim të Kundërt që është Kapaciteti tjetër i vetëm në drejtim të kundërt), atëherë RAO_t do të alokohet për

Tregëtarët/Furnizuesit me Kapacitet në Drejtimin Përpara, Afatgjatë, të Pandërprerë në të njëjtat pjesë si rishpërndarja e sasisë në total marrë nga Transportuesi (AMC_i) si përshkruhet më sipër.

- (b) Sasia që do të rishpërndahet për çdo Tregëtar/Furnizues sipas Paragrafit 18.3 (a) më sipër do të përfshihet si kredi tek Situacioni Vjetor.

19 FATURIMI

19.1 Deklarata kryesore

- (a) Transportuesi do t'i dërgojë çdo Pale të Regjistruar që ka ndonjë shumë prej ose nga Palët e regjistruara në një muaj të caktuar të gazit (ose sipas këtij Kodi Rrjeti ose Marrëveshjes së Transportit të Gazit) një deklaratë kryesore jo më vonë se dita e dhjetë pas përfundimit të këtij muaji të gazit. Deklarata kryesore do të konsiderohet se është marrë nga një Palë e Regjistruar pasi t'i dërgohet asaj Palë të regjistruar në platformën elektronike të të dhënave TAP
- (b) Deklarata Kryesore do të përfshijë çdo Deklaratë Mujore që Transportuesi kërkohet t'i dërgojë asaj Pale të Regjistruar sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit që ka hyrë në fuqi nga Pala e Regjistruar.
- (c) Për më tepër, Deklarata Kryesore do të përcaktojë detaje të shumave të mëposhtme për Muajin përkatës të Gazit (në masën e zbatueshme):
 - (i) çdo reduktim të aftësisë së Palës së Regjistruar për të përdorur Kapacitetin e saj të Rezervuar si rezultat i një Kufizimi të Kapacitetit;
 - (ii) sasi të Alokua për atë Palë të Regjistruar në lidhje me secilin nga Kodet e Llogarisë së Tregtarëve/Furnizuesve në secilën Pikë Interkoneksioni dhe në Pikën Virtuale të Tregtimit për çdo Ditë Gazi në Muajin përkatës të Gazit;
 - (iii) shumën e Pagesës së Neutralitetit, e kredituar ose e pagueshme nga ajo Palë e Regjistruar;
 - (iv) tarifën Ditore të Disbalancimit për çdo Ditë Gazi në atë Muaj Gazi për atë Palë të regjistruar;
 - (v) çdo tarifë të pagueshme në lidhje me Kapacitetin e Dorëzuar, sipas Paragrafit 13.2 (d);
 - (vi) çdo tarifë të pagueshme në lidhje me Kapacitetin e Tërhequr, sipas Paragrafit 13.5 (b);
 - (vii) çdo shumë për të kompensuar Transportuesin për Çmimin e pakthyeshem të Ankandit sipas Paragrafit 13.17;
 - (viii) totalin e Gazit Karburant të alokuar për atë Palë të Regjistruar dhe Çmimin që aplikohet;
 - (ix) totalin e UFG së alokuar për atë Palë të Regjistruar dhe Çmimin që aplikohet për kWh, dhe Koston për kWh;
 - (x) Vlerësimin e Koston së Energjisë Elektrike;
 - (xi) Pjesën e Vlerësimit të Koston së Energjisë Elektrike që alokohet për atë Pale të Regjistruar.
- (d) Përveç Deklaratës Kryesore, shumat e përcaktuara në paragrafin (c) më lart (me përjashtim të Sasive të Alokua në Pikën Virtuale të Tregtimit) (ose raportin përkatës të tyre) do të përcaktohen në Deklaratën Mujore sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit, ose sipas Kodit të Rrjetit që i ka alokuar ato, dhe këto shuma do të paguhet sipas kushteve të kësaj Marrëveshje të Transportit të Gazit.

19.2 Deklarata Vjetore

- (a) Transportuesi do t'i dërgojë çdo Pale të Regjistruar një Deklaratë Vjetore jo më vonë se dita e dhjetë e muajit Mars të çdo Viti Gazi. Deklarata Vjetore do të konsiderohet e marrë nga Pala e Regjistruar kur ajo t'i dërgohet asaj Pale të Regjistruar tek Platforma Elektronike e të Dhënave të TAP.

- (b) Tek çdo Deklaratë Vjetore, Transportuesi do të përfshijë detajet mbi informacionin më poshtë në lidhje me koston e Energjisë Elektrike e cila i ndahet çdo Pale të Regjistruar sipas Marrëveshjeve të Transportit të Gazit:
- (i) Koston Aktuale të Energjisë Elektrike (së bashku me detajet për llogaritjen e bërë për të përcaktuar Koston Aktuale të Energjisë Elektrike sipas Paragrafit 15.4) për çdo Muaj Gazi sipas të cilës ajo Palë e Regjistruar është faturuar për çdo Vlerësim të Kostos së Energjisë Elektrike nga (por duke përjashtuar) Muajin e fundit të Gazit për të cilin ky informacion është përfshirë tek Deklarata Vjetore (përveç Deklaratës së parë Vjetore e cila fillon nga Muaji i parë i Gazit) deri tek (duke e përfshirë) Muaji i fundit të Gazit për të cilin është i disponueshëm ky informacion;
 - (ii) Për çdo Muaj Gazi referuar tek paragrafi (i) më sipër, pjesa e Kostos Aktuale të Energjisë Elektrike që i alokohet asaj Pale të Regjistruar, llogaritur sipas dispozitave të Paragrafit 15.5.
 - (iii) Sasinë (e cila mund të jetë pozitive ose negative) e cila rezulton nga zbritja e Kostos Aktuale të Energjisë Elektrike e alokuar për atë Palë të Regjistruar, nga Vlerësimet e Kostos së Energjisë Elektrike në total faturuar për atë Palë të Regjistruar, në çdo rast në lidhje me të gjithë Muajt e Gazit referuar në paragrafin (i) më sipër.
- (c) Sasitë e specifikuar në Paragrafin (b) (iii) më sipër do të jenë një pagesë balancimi që paguhet nga Transportuesi për Tregëtarin/Furnizuesin ose nga Tregëtari/Furnizuesi për Transportuesin si një zgjidhje e kostove të vlerësuara të Energjisë Elektrike ndaj kostove aktuale.
- (d) Çdo Deklaratë Vjetore do të përcaktojë (sipas rastit) detajet dhe shumën e çdo pagese të kërkuar sipas Paragrafit 14.1 (e) ose 16.1(d).
- (e) Për më tepër, çdo Deklaratë Vjetore do të përmbajë gjithashtu detaje të shumave të mëposhtme (nëse ka) që do të rishpërndahen tek Pala e Regjistruar përkatëse:
- (i) shuma për çdo rishpërndarje të të ardhurave nga Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Ditës në Avancë i Pandërprerë që zbatohet për atë Palë të Regjistruar sipas nenit 18; dhe
 - (ii) shuma për çdo rishpërndarje të të ardhurave të tjera që zbatohen për atë Palë të Regjistruar sipas nenit 18.
- (f) Nëse shuma e përcaktuar në Paragrafin (b) (iii) më sipër është negative dhe/ose kërkohet pagesa nga Tregëtari/Furnizuesi për Transportuesin sipas paragrafit (d) më sipër, Pala e Regjistruar duhet ta paguajë këtë shumë sipas kushteve të Marrëveshjes (Marrëveshjeve) të Transportit të Gazit ndaj të cilës ajo është alokuar (ose, nëse Marrëveshja e Transportit të Gazit nuk është më efektive, sipas kushteve të asaj Marrëveshje të Transportit të Gazit sikur ajo të ishte efektive) sikur Deklaratat Vjetore të ishin Deklarata Mujore.
- (g) Transportuesi do të kreditojë çdo shumë pozitive sipas paragrafit (b) (iii) më sipër dhe çdo shumë specifikuar në paragrafin (e) më sipër ndaj shumave që janë efektive në përpjestim me Kapacitetet e Rezervuara dhe që paguhet sipas çdo Marrëveshje të Transportit të Gazit ndaj të cilës Pala e Regjistruar është një pale. Nëse nuk ka një Marrëveshje efektive me atë Palë të Regjistruar, Transportuesi duhet të nxjerrë një situacion të kredisë për Palën e Regjistruar.

19.3 Korrigjim i Deklaratave Mujore

- (a) Nëse ndonjë e Dhënë Matëse në lidhje me një Muaj Gazi për të cilin është dërguar një Deklaratë Kryesore ose Deklaratë Vjetore është korrigjuar më pas në përputhje me nenin 17, atëherë Transportuesi duhet të:
- (i) rishikojë çdo Deklaratë të prekur nga të Dhënat përkatëse Matëse në mënyrë që të pasqyrojë të Dhënat Matëse të korrigjuara; dhe

- (ii) ti dërgojë secilës Palë të Regjistruar të prekur (ose sipas gjykimit të Transportuesit, së bashku me Deklaratën tjetër Kryesore) Deklaratat e përditësuara të rakorduara edhe me Deklaratat e nxjerra më parë, duke treguar në veçanti:
 - (a) çdo ndryshim tek Sasitë e Alokuaara, alokimin e Shumës së Pagesës së Neutralitetit, Tarifën Ditore të Disbalancimit, alokimin e Gazit Karburant, alokimin e UFG, alokimin e Vlerësimit të Kostos së Energjisë Elektrike, alokimin e Kostos Aktuale të Energjisë Elektrike dhe shumën e çdo rishpërndarjeje;
 - (b) shumën totale që Transportuesi duhet t'i paguajë Palës së Regjistruar ose shumën totale shtesë që paguhet nga Pala e Regjistruar për Transportuesin, sipas rastit, si rezultat i korigjimit të të Dhënave të Matjes, përditësimit të Deklaratës përkatëse dhe përshtatjes së shumave të detyrueshme dhe që do të paguheshin sipas Deklaratës së përditësuar me shumën që ishin të detyrueshme dhe të pagueshme sipas Deklaratës origjinale.
- (b) Nëse Deklaratat e rishikuara të parashikuara në paragrafin (a) (ii) më lart rezultojnë në një pagesë totale shtesë nga Pala e Regjistruar për Transportuesin, Pala e Regjistruar do të paguajë një shumë të tillë në përputhje me kushtet e Marrëveshjes (Marrëveshjeve) të Transportit të Gazit ndaj të cilës ajo alokohet (ose, nëse Marrëveshja e Transportit të Gazit nuk është më në fuqi, sipas kushteve të Marrëveshjes së Transportit të Gazit sikur ajo të ishte në fuqi).
- (c) Nëse Deklaratat e rishikuara të parashikuara në paragrafin (a) (ii) më lart rezultojnë në një pagesë që kërkohet nga Transportuesi për Palën e Regjistruar, Transportuesi do të kreditojë një shumë të tillë kundrejt shumave të pagueshme sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit ndaj të cilës Pala e Regjistruar është palë, shuma të cilat janë efektive në përpjestim me Kapacitetet e Rezervuara sipas Marrëveshjes së Transportit të Gazit dhe nëse jo Marrëveshjes së Transportit të Gazit që janë efektive me ato Palë të Regjistruara, Transportuesi do të lëshojë një situacion të kredisë për Palën e Regjistruar.

20. NDËRPRERJA

20.1 Ndërprerja e të drejtave dhe Shërbimeve të Transportit

- (a) Nëse, në çdo kohë, ndonjë prej rrethanave të përcaktuara në Nenin 20.2 (a) zbatohet në lidhje me një Palë të Regjistruar, Transportuesi mund të njoftojë atë Palë të Regjistruar që të pezullojë të drejtat e asaj Pale të Regjistruar sipas këtij Kodi të Rrjetit dhe Shërbimeve të Transportit sipas çdo Marrëveshje të Transportit të Gazit nga data dhe koha e specifikuar tek ky njoftim deri në fillimin e Ditës së parë të Gazit që menjëherë pason datën në të cilën këto rrethana pushojnë së ekzistuari.
- (b) Njoftimi për pezullimin e përmendur në paragrafin (a) më lart duhet të:
 - (i) përmbajë detaje të rrethanave që zbatohen të përcaktuara në Paragrafin 20.2 (a); dhe
 - (ii) përcaktojë datën dhe kohën nga e cila Transportuesi synon të pezullojë të drejtat e asaj Pale të Regjistruar dhe (nëse zbatohet) Shërbimet e Transportit.
- (c) Paragrafi 20 është shtojcë e të drejtave të përfundimit dhe të pezullimit të Transportuesit sipas Termave dhe Kushteve të Përgjithshme.

20.2 Rrethanat që nxisin një pezullim

- (a) Rrethanat që do t'i lejojnë Transportuesit të ndër marrë veprimet e përmendura në Paragrafin 20.1 (a) në lidhje me një Palë të Regjistruar janë:
 - (i) Kur ajo Palë e Regjistruar ose një Dege e saj caktohet si Palë e Kufizuar;
 - (ii) Kur Transportuesi do të ishte subjekt i një përgjegjësie penale ose civile, ose që nuk pajtohet me Sanksionet që aplikohen për Transportuesin ose atë që do të caktohet Palë Kufizuese, në çdo rast si rezultat i marrëdhënies së Transportuesit me atë Palë të Regjistruar ose me një Degë të saj;
 - (iii) Kur sigurimi i Gazit Natyror nga ajo Palë e Regjistruar për Transportuesin:
 - (a) do të binte në kundërshtim me nenin 14 a të Rregullores së Këshillit (BE) 267/2012 (e ndryshuar me Rregulloren e Këshillit (BE) 1263/2012);
 - (b) do të drejtohet Transportuesit ose ndonjë Tregëtari/Furnizuesi tjetër që pranon rishpërndarjen e Gazit Natyror nga Transportuesi sipas përgjegjësisë penale ose civile; ose çon në mospajtueshmëri me Sanksionet që aplikohen për atë Person ose rezulton që ai Person caktohet si Palë Kufizuese; ose
 - (c) do të bënte që Transportuesi të mos ishte dakort me Përjashtimin e tij.
- (b) Për qëllim të Paragrafit 20.2, **Sanksionet** kanë kuptimin që jepet tek Kushtet dhe Termat e Përgjithshme që kanë hyrë në fuqi ose janë miratuar nga Pala përkatëse e Regjistruar.

21. KOMUNIKIMET

21.1 Rendi i Përparësisë së komunikimeve

- (a) Neni 21 është objekt i çdo dispozite në kundërshtim me këtë Kod të Rrjetit ose Marrëveshje të Transportit të Gazit që përshkruan se si duhet të bëhet një komunikim i veçantë.
- (b) Të gjitha komunikimet sipas dhe në lidhje me këtë Kod të Rrjetit duhet të bëhen në gjuhën Angleze.
- (c) Komunikimet sipas dhe në lidhje me këtë Kod të Rrjetit duhet të bëhen si më poshtë nëse nuk ka padisponueshmëri të përgjithësuar të atyre mjeteve të komunikimit:
 - (i) në lidhje me komunikimet operacionale ndërmjet Transportuesit dhe Tregtarëve/Furnizuesve, duke përdorur mesazhet Edig@s (megjithëse Nominimet mund të bëhen përmes Platformës Elektronike të të Dhënave të TAP) ose, nëse Tregëtari / Furnizuesi nuk është në gjendje të komunikojë nëpërmjet mesazheve Edig@s, duke përdorur Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP deri në momentin që kjo periudhë si Tregëtar/Furnizues të komunikohet duke përdorur mesazhet Edig@s;
 - (ii) në lidhje me komunikimet midis Transportuesit dhe Palëve të Regjistruara dhe komunikimet ndërmjet Palëve të Regjistruara në secilin rast në lidhje me rezervimet dhe tregëtimin e Produkteve të Kapacitetit, duke përdorur Platformën e Rezervimit të Kapacitetit;
 - (iii) në lidhje me komunikimet midis Transportuesit dhe Palëve të Regjistruara dhe komunikimet midis Palëve të Regjistruara në çdo rast në lidhje me çështjet që nuk përmenden tek paragrafet (i) ose (ii) më sipër, duke përdorur Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP;
- (d) Nëse ka një padisponueshmëri të përgjithshme të software të përdorur nga Transportuesi i cili mbështet komunikimin përmes Edig@s, komunikimet operacionale sipas dhe në lidhje me këtë Kod të Rrjetit midis Transportuesit dhe Tregtarit/Furnizuesit do të bëhen duke përdorur Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP.
- (e) Sipas paragrafit (d) më sipër, nëse ka padisponueshmëri të përgjithshme të ndonjë prej mënyrave të komunikimit të përmendura në paragrafin (c) më lart, komunikimet sipas dhe në lidhje me Kodin e Rrjetit duhet të bëhen sipas rregullit të mëposhtëm të përparësisë.
 - (i) me e-mail duke përdorur modelet dhe adresat e email të publikuara në faqen e internetit të Transportuesit në kohën e shfaqjes së padisponueshmërisë (ose, për një Tregëtar/Furnizues, në adresën e email të specifikuar tek Formulari i tij i Regjistrimit ose adresën e përditësuar siç mund të jetë njoftuar nga Transportuesi); dhe
 - (ii) nëpërmjet faksit duke përdorur çdo model ose numra faksi të publikuar në faqen e internetit të Transportuesit në kohën e padisponueshmërisë, që ndiqet, në rastin e çdo faksi, me një telefonatë drejtuar Transportuesit në numrin e telefonit të publikuar në faqen e internetit të Transportuesit, në kohën e shfaqjes së padisponueshmërisë, duke njoftuar Transportuesin se faksi i është dërguar atij.
- (f) Çdo komunikim që bëhet duke përdorur mjetet e komunikimit referuar në paragrafet (c), (d) ose (e) më sipër do të konsiderohet e hartuar me shkrim për qëllime të këtij Kodi të Rrjetit.
- (g) Nëse ka një padisponueshmëri të përgjithshme të ndonjë prej mënyrave të komunikimit të përmendura në paragrafin (c) më sipër, Transportuesi do të informojë të gjithë Tregtarët/Furnizuesit që preken dhe Palët e Regjistruara (sipas rastit) për faktin se një padisponueshmëri e tillë është në vazhdim e sipër dhe për kohëzgjatjen e asaj periudhe padisponueshmërie, Transportuesi do të pranojë vetëm komunikimet e bëra duke përdorur mjetet e tjera të mundshme të komunikimit të specifikuar në paragrafin (d) ose (e) më sipër.

- (h) Pasi të ketë mbaruar periudha e padisponueshmërisë në përgjithësi të ndonjë prej mënyrave të komunikimit të përmendura në paragrafin (c) më sipër, Transportuesi do të njoftojë të gjithë Tregtarët/Furnizuesit dhe Palët e Regjistruara (sipas rastit) se periudha e padisponueshmërisë ka përfunduar dhe nga data e këtij njoftimi, komunikimet mund të rifillojnë duke përdorur mjetet e mundshme të komunikimit specifikuar në paragrafin (c) më sipër.
- (i) Çdo Palë e Regjistruar duhet të sigurojë që Personi që ajo ka nominuar tek Formulari i Regjistrimit për të menaxhuar komunikimet e Palës së Regjistruar (ose ndonjë person tjetër i njoftuar nga kjo Palë e Regjistruar tek Transportuesi) është në dispozicion për tu kontaktuar në mënyrë të vazhdueshme. Një Palë e Regjistruar mund të nominojë një kompani të shërbimeve profesionale si palë të tretë për të kryer këtë funksion.

21.2 Edig@s

Transportuesi do të njoftojë me shkrim të gjitha Palët e Regjistruara nëse është kryer versioni i përditësuar i Edig@s ose nëse është kryer version i përditësuar i software që mbështet Edig@s. Çdo Palë e Regjistruar duhet të sigurojë që ka shkarkuar dhe do të jetë në gjendje të përdorë versionin e përditësuar të Edig@s ose softwarin mbështetës të Edig@s, sipas rastit deri në një datë që i bie jo më vonë se 6 muaj pas datës së këtij njoftimi të Transportuesit.

21.3 Platforma Elektronike e të Dhënave të TAP

- (a) Transportuesi do të përdorë Përpjekje të Arsyeshme për ta vënë Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP në dispozicion të të gjitha Palëve të Regjistruara që kërkojnë akses tek Platforma Elektronike e të Dhënave të TAP.
- (b) Çdo Palë e Regjistruar që ka akses tek Platforma Elektronike e të Dhënave të TAP duhet të sigurojë që personeli i saj (ose Personat që administrojnë komunikimet në emër të tij) të kenë kompetencën teknike dhe përvojën e nevojshme për të komunikuar me saktësi duke përdorur Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP. Vetëm Personat që kanë kaluar një test komunikimi do të lejohen të komunikojnë duke përdorur Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP në emër të një Pale të Regjistruar.
- (c) Transportuesi do të bëjë Përpjekje të Arsyeshme për të siguruar mbështetje teknike dhe testuese për Palët e reja të Regjistruar që kërkojnë të aksesojnë Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP.
- (d) Transportuesi do tu ofrojë të gjitha Palëve të Regjistruara që kërkojnë akses në Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP identifikime dhe fjalëkalime unike të përdoruesit, në mënyrë që të lehtësojë aksesin e Palëve të tilla të Regjistruara në Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP.
- (e) Transportuesi do të vendosë në dispozicion një manual përdorimi për Platformën Elektronike të të Dhënave të TAP në faqen e tij të internetit dhe do të përdorë Përpjekje të Arsyeshme për ta mbajtur atë manual të përditësuar herë pas here.

22. RISHIKIMI

22.1 Rishikimi i këtij Kodi të Rrjetit

Ky Kod i Rrjetit mund të rishikohet herë pas here sipas procedurave të përcaktuara në Nenin 22. Rrethanat në të cilat ky Kod i Rrjetit mund të rishikohet përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm tek:

- (a) kur Transportuesit i kërkohet, ose zgjedh, të vërë në dispozicion Kapacitetin e Zgjerimit;
- (b) kur Transportuesi synon të ndërtojë, ose të bëjë operacionale Pika shtesë Interkonjeksioni;
- (c) kur ka një ndryshim në Sistemet e Interkonjeksionit i cili kërkon një ndryshim në procedurat e këtij Kodi të Rrjetit në mënyrë që Transportuesi të përmbushë detyrimet e tij sipas Marrëveshjeve të Interkoneksionit, Marrëveshjeve Operacionale të Balancimit dhe këtij Kodi të Rrjetit.
- (d) kur ka një ndryshim në ligj, i cili ndikon tek procedurat e këtij Kodi të Rrjetit ose kërkon një modifikim në mënyrë që Transportuesi të përmbushë detyrimet e tij sipas këtij Kodi të Rrjetit;
- (e) kur kërkohet një përditësim nga Autoritetet Rregullatore; ose
- (f) çdo situatë tjetër që Transportuesi përcakton, duke vepruar si një Operator i Arsyeshëm dhe i kujdesshëm, e cila ka rezultuar se është e nevojshme ose e dëshirueshme për të përditesuar ose modifikuar Kodin e Rrjetit në mënyrë që të lehtësojë ofrimin e Shërbimeve të Transportit (përfshirë rrethanat e përcaktuara në Pjesën 22.8).

22.2 Paraqitja e Kërkesave për Rishikim

- (a) Pala e Regjistruar në çdo kohë mund të paraqesë një propozim për rishikim të Kodit të Rrjetit duke dërguar Kërkesën për Rishikim tek Transportuesi.
- (b) Çdo Kërkesë për Rishikim duhet:
 - (i) të specifikojë emrin e subjektit që bën Kërkesën për Rishikim, adresën e tij të regjistruar dhe emrin, adresën e email-it dhe numrin e telefonit të personit të kontaktit që është përgjegjës për Kërkesën për Modifikim në subjektin që bën Kërkesën për Rishikim;
 - (ii) të përmbajë një përshkrim sa më të plotë të ndryshimeve tek Kodi i Rrjetit që janë duke u propozuar, së bashku me një përshkrim të arsyeve teknike, operacionale ose tregtare përse janë propozuar ato ndryshime;
 - (iii) të përmbajë, kur aplikohet, një vlerësim me shkrim të lidhjes logjike të ndryshimeve të propozuara me Ligjin që aplikohet për Sistemin e Transportit të TAP dhe objektivat e Kodit të Rrjetit;
 - (iv) të bashkëlidhë dokumentat e nevojshëm për të provuar çdo informacion që parashikohet në paragrafet (i) deri tek (iii) më sipër; dhe
 - (v) të specifikojë datën e propozuar në të cilën ndryshimet e propozuara duhet të hyjnë në fuqi, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për të ndryshuar Kodin e Rrjetit dhe në rastin e ndryshimeve të propozuara që mund të ndikojnë në funksionimin e Sistemit të Transportit të TAP, duke patur parasysh kohën e nevojshme për zbatimin e çdo ndryshimi të kërkuar në funksionimin e Sistemit të Transportit të TAP.
- (c) Transportuesi duhet të paraqesë një propozim për rishikim të Kodit të Rrjetit dhe në çdo rast duhet të përgatisë një Propozim Rishikimi sipas Paragrafit 22.4.

22.3 Vlerësimi i Kërkesave për Rishikim

- (a) Transportuesi duhet të pranojë marrjen e Kërkesës për Rishikim të paraqitur tek Transportuesi nga çdo Person referuar në Paragrafin 22.2 (a) (Personi që ka Paraqitur Kërkesën **Submitting Person**) jo më vonë se 7 [shtatë] ditë pas marrjes.

- (b) Transportuesi duhet, jo më vonë se 90 ditë pas kësaj të fundit:
- (i) të pranojë marrjen e një Kërkesë për Rishikim; dhe
 - (ii) aty ku është e aplikueshme marrja e informacionit shtesë të fundit të kërkuar sipas paragrafit (d) më poshtë, të njoftojë Personin që Paraqet Kërkesën nëse ai:
 - (A) do të vijojë me Kërkesën për Rishikim, rast në të cilin, Transportuesi duhet t'i sigurojë Personit që Paraqet Kërkesën një afat kohor të mjaftueshëm për zbatimin e ndryshimeve të propozuara në Kërkesën për Rishikim; ose
 - (B) refuzon Kërkesën për Rishikim, rast në të cilin, Transportuesi duhet të njoftojë për arsyet e refuzimit si Personin që ka Paraqitur Kërkesën dhe Autoritetet Rregullatore.
- (c) Në marrjen e vendimit të tij si përcaktuar në dispozitat e paragrafit (b) më lart, Transportuesi duhet të marrë parasysh:
- (i) përputhshmërinë e ndryshimeve të propozuara në kërkesën për rishikim me ligjin e zbatueshëm për Sistemin e Transportit TAP, Përfshirimin, objektivin e këtij Kodi të Rrjetit dhe dispozitat e Marrëveshjeve ekzistuese të Transportit të Gazit;
 - (ii) mënyrat sipas të cilave ndryshimet e propozuara tek Kërkesa për Rishikim ndihmojnë në pëmirësimin e funksionimit të Sistemit të Transportit të TAP; dhe
 - (iii) korrigjimet e ndryshimeve të propozuara tek Kërkesa për Rishikim, për të ofruar Shërbimet e Transportit nga Transportuesi, duke marrë në konsideratë efektet që ndryshimet e propozuara mund të kenë tek kostot dhe vështirësia e ofrimit të Shërbimeve të Transportit.
- (d) Sipas paragrafit (e) më poshtë, në çdo kohë para afatit të përmendur në paragrafin (b) (i) më lart, Transportuesi mund të kërkojë informacion shtesë ose sqarime nga Personi që ka Dorëzuar Kërkesën për sa i përket Kërkesës për Rishikim, dhe Personi që ka Dorëzuar Kërkesën duhet të sigurojë menjëherë një informacion të tillë ose shpjegime që janë nën kontrollin e tij ose t'i konfirmojë Transportuesit që informacionet ose shpjegimet e tilla nuk janë në kontrollin e tij.
- (e) Në vijim të kërkesës së parë për informacion ose shpjegim të bërë sipas paragrafit (d) më lart në lidhje me një Kërkesë për Rishikim, Transportuesi mund të bëjë kërkesa të mëvonshme për informacion ose shpjegime në lidhje me atë Kërkesë për Modifikim, pavarësisht afatit të përmendur në paragrafin (b) (i) më lart.

22.4 Konsultimi Publik i Rishikimit

- (a) Nëse, sipas Nenit 22.3 (b), Transportuesi kryen një Kërkesë për Rishikim të bërë nga Personi që ka Dorëzuar Kërkesën, ose nëse vetë Transportuesi duhet të përgatisë propozimin për rishikim të Kodit të Rrjetit, Transportuesi duhet të përgatisë Propozimin për Rishikim për konsultim publik, ku të përmbledhë ndryshimet e propozuara tek Kodi i Rrjetit, relacionin mbështetës për ato ndryshime, dhe kuadrin kohor të vlerësuar për zbatimin e këtyre ndryshimeve.
- (b) Transportuesi duhet të publikojë Propozimin për Rishikim në faqen e tij të internetit për konsultim publik e cila zgjat minimumi 30 ditë radhazi dhe maksimumi 45 ditë radhazi, kur vlerësohet e përshtatshme nga Transportuesi në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të ndryshimeve të propozuara tek Kodi i Rrjetit të përfshira tek Propozimi i Rishikimit. Transportuesi duhet të publikojë një formular përgjigje online së bashku me publikimin e Propozimit të Rishikimit dhe duhet të mbledhë çdo reagim të paraqitur në përgjigje të Propozimit të Rishikimit, nga Personat e mëposhtëm:
- (i) çdo Pale të Regjistruar;
 - (ii) çdo OST Fqinje; dhe
 - (iii) çdo person tjetër me interesa direkte sipas kushteve të Kodit të Rrjetit,

si dhe lehtëson diskutimin mbi Propozimin e Rishikimit në Forumin e Palëve të Palëve të interesuara dhe mbledhjen e reagimeve që vijnë nga ai diskutim.

22.5 Proçesi i miratimit

- (a) Pas përfundimit të periudhës së konsultimit të përmendur në Paragrafin 22.4 (b), Transportuesi duhet të marrë në konsideratë çdo reagim të marrë prej tij sipas Paragrafit 22.4 (b) në përgjigje të Propozimit për Rishikim dhe duhet të përgatisë vendimin e tij përfundimtar nëse duhet të ndryshojë Kodin e Rrjetit dhe si ta ndryshojë Kodin e Rrjetit brenda 90 ditëve pas përfundimit të periudhës së konsultimit (**Vendimi Përfundimtar i Transportuesit**).
- (b) Transportuesi, brenda ose para afatit të përmendur në paragrafin (a) më lart, do të paraqesë Rregullatorit dokumentet e mëposhtme në mënyrë që ata të vlerësojnë Vendimin Përfundimtar të Transportuesit;
 - (i) Kërkesën për Rishikim;
 - (ii) Propozimin për Rishikim;
 - (iii) çdo reagim të marrë nga Transportuesi mbi Propozimin për Rishikimin gjatë periudhës së konsultimit të përmendur në Paragrafin 22.4 (b); dhe
 - (iv) Vendimin Përfundimtar të Transportuesit.
- (c) Transportuesi miraton kërkesën, në të njëjtën kohë kur ai paraqet dokumentet e përmendura në paragrafin (b) më lart, që Autoriteti Rregullator :
 - (i) t'i sigurojë Transportuesit ratifikimin e Vendimit Përfundimtar të Transportuesit; ose
 - (ii) t'i kërkojë Transportuesit të rishqyrtojë dhe modifikojë Vendimin Përfundimtar të Transportuesit.

Nëse Autoriteti Rregullator kërkon që Vendimi Përfundimtar i Transportuesit të rishqyrtohet dhe modifikohet, Transportuesi do ta modifikojë atë dhe do t'ia paraqesë Autoritetit Rregullator Vendimin Përfundimtar të Transportuesit dhe do të kërkojë që ai të ndërmarë ndonjë nga veprimet e përcaktuara në paragrafët (i) ose (ii) më lart në lidhje me Vendimin Përfundimtar të Transportuesit të modifikuar.

22.6 Ndryshime të Kodit të Rrjetit

- (a) Pas marrjes së një vendimi ratifikimi nga Autoriteti Rregullator sipas Paragrafit 22.5 (c), Transportuesi duhet të ndryshojë Kodin e Rrjetit sipas vendimit të ratifikimit.
- (b) Transportuesi duhet të publikojë Kodin e rishikuar të Rrjetit në faqen e tij të internetit, por në asnjë rast jo më vonë se 60 ditë pas marrjes së vendimit të ratifikimit, së bashku me njoftimin i cili përmbledh përmbajtjen dhe qëllimin e ndryshimeve të bëra tek Kodi i Rrjetit.
- (c) Çdo ndryshim tek Kodi i Rrjetit sipas Paragrafit 22 do të jetë i detyrueshëm për Transportuesin dhe të gjitha Palët e Regjistruara, pasi të publikohet sipas paragrafit (b) më lart.

22.7 Forumi i Palëve të Interesuara

- (a) Transportuesi duhet të krijojë një Forum të Palëve të Interesuara për të siguruar të dhëna të rregullta këshilluese. Roli i Forumit të Palëve të Interesuara do të përfshijë (por nuk duhet të limitohet) tek aktivitetet e mëposhtme:
 - (i) t'i ofrojë Transportuesit opinionet e anëtarëve të Forumit të Palëve të Interesuara mbi mundësitë strategjike dhe sfidat që mund të ndikojnë tek Sistemi i Transportit i TAP dhe Shërbimet e Transportit të ofruara nga Transportuesi;
 - (ii) ofrimin e vlerësimeve mbi Shërbimet e Transportit të ofruara nga Transportuesi;

- (iii) shkëmbimin e opinioneve të anëtarëve të Forumit të Palëve të Interesuara për çdo Propozim për Rishikimin që aktualisht janë në shqyrtim; dhe
 - (iv) shkëmbimin e opinioneve të anëtarëve të Forumit të Palëve të Interesuara mbi çdo rishikim të procedurave, metodologjive ose dokumentave referuar në Kodin e Rrjetit që publikohet tek faqja e internetit e Transportuesit.
- (b) Transportuesi duhet të publikojë në faqen e internetit datën që propozohet për krijimin e Forumit të Palëve të Interesuara, së bashku me formularët online të aplikimit ku të lejojë një Person të aplikojë për tu bërë anëtar i Forumit të Palëve të Interesuara brenda 60 ditëve nga Data Fillestare Efektive dhe duhet të njoftojë Autoritetet Rregullatore për krijimin e Forumit të Palëve të Interesuara jo më vonë se 15 ditë pas publikimit.
- (c) Sipas paragrafeve (d) tek (h) më poshtë, do të caktohen për tu bërë anëtarë të Forumit të Palëve të Interesuara Personat e mëposhtëm:
- (i) Palët e Regjistruara;
 - (ii) OST-të Fqinje; dhe
 - (iii) çdo person që ka interesa direkte tek kushtet e Kodit të Rrjetit.
- (d) Çdo Person i cili ka të drejtë të bëhet anëtar i Forumit të Palëve të Interesuara sipas paragrafit (c) më sipër pas formimit të Forumit të Palëve të Interesuara mund të aplikojë tek Transportuesi për tu bashkuar Forumit duke plotësuar formularin online që është në dispozicion tek faqja e internetit e Transportuesit.
- (e) Rregullat proceduriale për Forumin e Palëve të Interesuara do të hartohen nga anëtarët e Forumit të Palëve të Interesuara. Këto rregulla nuk mund të jenë diskriminuese ndaj anëtarëve të Forumit të Palëve të Interesuara.
- (f) Pas krijimit, Forumi do të mbledhet në mënyrë periodike, në kohët dhe vendet e përcaktuara tek rregullat proceduriale që do të hartohen sipas paragrafit (e) më sipër.
- (g) Një përfaqësues nga Transportuesi do të drejtojë takimet e Forumit të Palëve të Interesuara.
- (h) Vetëm një përfaqësues nga çdo anëtar i Forumit të Palëve të Interesuara do të lejohet të marrë pjesë tek takimet e Forumit.
- (i) Forumi i Palëve të Interesuara nuk do të ketë fuqi vendimmarrëse në lidhje me Rishikimet.
- (j) Nëse numri i anëtarësimit të Forumit të Palëve të Interesuara që bëhet vetëm sipas opinionit të Transportuesit, është tepër i madh, për të lehtësuar dialogun e detajuar mbi një çështje të caktuar, Transportuesi mund të ftojë grupe më të vogla anëtarësh të Forumit të Palëve të Interesuara për të marrë pjesë rreth diskutimeve në lidhje me këtë çështje, rezultati i të cilës do të shpërndalet tek Forumi i Palëve të Interesuara. Çdo grup me i vogël duhet të ketë të paktën një Tregëtar/Furnizues i cili ka Kapacitet në Drejtimin Përpara të Pandërprerë Afatgjatë përveç nëse të gjithë këta Tregëtarë/Furnizues refuzojnë që të marrin pjesë.

22.8 Zhvillimet në të ardhmen

Transportuesi do të vlerësojë zhvillimet specifike të Kodit të Rrjetit të cilat mund të zbatohen në të ardhmen në përputhje me Shtojcën 5. Nëse Transportuesi, i cili vepron sipas Shtojcës 5 vlerëson se ndryshimi tek Kodi i Rrjetit është i nevojshëm ose kërkohet si ndryshim, ai duhet të paraqesë propozimin për rishikim të Kodit të Rrjetit sipas Pjesës 22.4.

23. LIGJI DREJTUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

23.1 Ligji Drejtues

Ky Kod i Rrjetit dhe çdo detyrim jo-kontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të do të qeveriset dhe do të interpretohet dhe shpjegohet në përputhje me Legjislacionin Anglez, duke përjashtuar Konventën 1980 mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (Konventa e Vjenës).

23.2 Përgjegjësia

Transportuesi, në masën maksimale të lejuar me ligj, nuk do të ketë përgjegjësi për shkelje të kontratës, përgjegjësi jashtë-kontraktore ose për çdo humbje, dëm ose përgjegjësi tjetër që ndonjë Person ka marrë nën ose në lidhje me këtë kod të rrjetit, përveç nëse është shkaktuar nga mosveprimi i qëllimshëm i transportuesit.

23.3 Mosmarrëveshjet në lidhje me Marrëveshjen e Transportit të Gazit

Pavarësisht dispozitave të Paragrafit 23.5, çdo mosmarrëveshje ndërmjet Transportuesit dhe çdo Tregëtari/Furnizuesi që ka ndonjë lidhje me/ose një Marrëveshje të Transportit të Gazit duhet të zgjidhet në përputhje me dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të përcaktuara tek Kushtet dhe Termat e përgjithshme.

23.4 Mosmarrëveshjet që do të zgjidhen nga Autoritetet Rregullatore

Një mosmarrëveshje në lidhje me LT UIOLI për të cilën është lëshuar një njoftim për kërkesë do të zgjidhet me Vendim të Autoritetit Rregullator. Çdo mosmarrëveshje tjetër që përfshihet në fushën e vendimit të përbashkët të lëshuar sipas Paragrafit 4.8.2 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, do të zgjidhet në përputhje me atë vendim të përbashkët të Autoriteteve Rregullatore.

23.5 Mosmarrëveshjet që lidhen me Kodin e Rrjetit

- (a) Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis Transportuesit dhe një Pale të Regjistruar (**Palët**) në lidhje me këtë Kod të Rrjetit që nuk bën pjesë në Paragrafin 23.3 ose 22.4, Palët duhet që, brenda 10 ditëve nga njoftimi me shkrim nga njëra Palë për Palën tjetër (**Njoftimi për Mosmarrëveshjen**), të zhvillojnë një takim për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Secila Palë duhet të dërgojë një përfaqësues për të marrë pjesë në atë takim i cili ka autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 ditëve nga dërgimi i një njoftimi për mosmarrëveshje, pavarësisht nëse është mbajtur një takim apo jo, atëherë do të zbatohen paragrafët (b) deri në (f) më poshtë.
- (b) Çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet ndryshe sipas paragrafit (a) më sipër do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë që është në fuqi në datën kur kërkesa për arbitrazh është parashtruar sipas këtyre Rregullave (**Rregullat**).
- (c) Numri i personave të arbitrimit do të jetë tre persona, të caktuar sipas Rregullave.
- (d) Selia ose vendi ligjor i arbitrazhit do të jetë Vjena (Austri).
- (e) Gjuha e procedurave të arbitrimit do të jetë gjuha Angleze. Të gjitha dokumentat e paraqitura në lidhje me procedurat do të jenë në gjuhën Angleze, ose, nëse janë në një gjuhë tjetër, duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën Angleze.
- (f) Dorëzimi i çdo kërkesë për arbitrim sipas Paragrafit 23.5 do të jetë me postë të regjistruar, në rastin e Transportuesit, në adresën e selisë së Transportuesit siç është publikuar në faqen e internetit të Transportuesit në atë kohë dhe në rastin e një Pale të Regjistruar, në adresën më të fundit të asaj Pale të Regjistruar që i është njoftuar Transportuesit nga ajo Palë e Regjistruar sipas këtij Kodi të Rrjetit.

SHTOJCA 1

SISTEMI I TRANSPORTIT I TAP

PJESA 1

PËRSHKRIMI I SISTEMIT

Sistemi i Transportit TAP është duke u zhvilluar për të transportuar Gazin Natyror nga kufiri Turk / Grek në rajonin jugor Puglia të Italisë, përmes Shqipërisë, siç përcaktohet në hartën më poshtë.

Përbërësit kryesorë të Sistemit të Transportit të TAP, kur ndërtohen për të lehtësuar kapacitetin fillestar janë:

- (a) lidhja me sistemin e transportit të gazit natyror Trans Anatolian në kufirin Turk / Grek;
- (b) dy Stacione Kompresimi:
 - (i) një në Kipoi në Greqi, CS00; dhe
 - (ii) një në fillim të pjesës në tokë të Sistemit të Transportit të TAP, në afërsi të Fierit në Shqipëri, CS03;
- (c) një stacion matës dhe stacion “pigging station” në kufi midis Greqisë dhe Shqipërisë pjesa Shqiptare, ka kodin CS02;
- (d) terminali i pritjes së gazsjellësit dhe stacioni matës dhe “**igging**” i kombinuar për zvogëlimin e presionit, në veri të Melendugno në Itali (**Terminali për Pritjen e Gazsjellësit**);
- (e) tubacioni në tokë 48" midis Stacioneve të Kompresimit CS00 dhe CS03;
- (f) tubacioni në tokë/në det 36" midis Stacionit të Kompresimit CS03 dhe Terminalit për Pritjen e Gazsjellësit;
- (g) stacionet në tokë të bllokimit të valvulave 31 x 48" dhe stacionet e valvulave në afërsi të tokës 2 x 36" në secilën anë të Detit Adriatik;
- (h) kabllo me fibër optike që ecin paralelisht me tubacionin nga Stacioni i Kompresimit CS00 në Terminalin Pritës së Gazsjellësit; dhe
- (i) lidhjen me sistemin e transportit të Gazit Natyror Snam Rete në kufirin midis Terminalit Pritës të Gazsjellësit dhe sistemit të transportit të gazit Snam Rete.



**PJESA 2
PAJISJA MATËSE**

Vend ndodhja	Emri	Fiskal	Pajisja Matëse	Në pronësi dhe operuar nga:
Kipoi (TU)	Shërbim për Menaxhimin e Kostove (CMS) TANAP	Kontrolli Fiskal i Stacionit të Matjes	<ul style="list-style-type: none"> • 2 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (UltraSonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi në C7+ • 2 Kromograf Sulfuri • 2 Analizues të Ujit • 2 Analizues të Hidrokarbonit • 2 Analizues të Oksigjenit • Sistemi i matjes së Gazit Karburant (turbina matëse, madhësia 1+1) 	TANAP
Kipoi (GR)	TAP FMS Kipoi (GCS00)	Fiskal	<ul style="list-style-type: none"> • 3 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi në C7+ • 2 Kromograf Sulfuri • 2 Analizues– Pika të përziera uji dhe hidrokarboni • 2 Analizues të oksigjenit • Sistemi i matjes së Gazit Karburant – i përshtatshëm për turbinat dhe kazanet (matësat e turbinës, matës qarkullues, madhësia 1+1) 	TAP
Komotini (GR)	IGB Stacioni i Integruar Mates dhe i Rregulluar	Fiskal	<ul style="list-style-type: none"> • 2 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi në C6+ • 2 Kromograf Sulfuri • 2 Analizues të Ujit • 2 Analizues të Oksigjenit • Sistemi i matjes së Gazit Karburant 	IGB
Nea Mesimvria	DESFA Stacioni Mates dhe Rregullues	Fiskal	<ul style="list-style-type: none"> • 3 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë me Shumë Rrjedha për matësat “me pagesë” dhe 2 Kompjuterë me Shumë Rrjedha për matësat e “kontrollit” • 2 Kromograf Gazi në C6+ • 2 Kromograf Sulfuri • 1 Analizues Uji • Analizues Hidrokarburi • Sistemi i matjes së Gazit Karburant (matës turbine, 	DESFA
Bilisht (AL)	Bilisht Stationi Mates (ACS02)	Fiskal	<ul style="list-style-type: none"> • 3 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi në C6+ • 2 Analizues – Pika të përziera uji dhe hidrokarboni 	TAP

<p>Fier (AL)</p>	<p>Fier Compressor Station (ACS03)</p>	<p>Funksional</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 3 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi në C6+ • 2 Analizues– Pika të përziera uji dhe hidrokarboni • Sistemi i matjes së Gazit Karburant – i përshtatshëm për turbinat dhe kazanet (matësat e turbinës, matës qarkullues, madhësia 1+1) 	<p>TAP</p>
<p>Melendugno (IT)</p>	<p>Pipeline Reception Terminal (IPR01)</p>	<p>Kontrolli i Stacionit të Matjes</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 3 Rrjedha Matëse (n+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi në C7+ • 2 Kromograf Sulfuri • 2 Analizues– Pika të përziera uji dhe hidrokarboni • 2 Analizues Oksigjeni • Sistemi i matjes së gazit karburant – i përshtatshëm për kazanet (matës qarkullues madhësia 1+1) 	<p>TAP</p>
<p>Melendugno (IT)</p>	<p>SRG Stacioni Mates dhe I Rregulluar</p>	<p>Fiskal</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 4 Rrjedha Matëse (3+1) secila përbëhet nga 2 Matësa Ultrasonik për gazin (Ultra Sonic gas flow meter USM) në seri (2 Matesa Ultrasonik të pavarur për gazin, në të njëjtin trup) dhe 2 Kompjuterë • 2 Kromograf Gazi • 1 Analizues Sulfuri • 1 Analizues Uji • 1 Analizues Hidrokarboni • 1 Analizues Oksigjeni • 1 sistem matës Densimetër për Gazin Karburant – i përshtatshëm për kazanet ndihmës 	<p>SRG</p>

SHTOJCA 2

PIKAT E INTERKONJEKSIONIT

Tabela A: Pikat e Interkonjeksionit dhe Pikat Hyrëse/Dalëse në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkonjeksionit

Çdo Pikë Interkonjeksioni tek Sistemi i Transportit i TAP përmendet tek tabela më poshtë së bashku me caktimin e saj si Pikë Hyrëse/Dalëse në lidhje me Kapacitetin në Drejtimin Përpara të Pikës së Interkonjeksionit, Kodin e saj EIC dhe distancën nga Pika Hyrëse më në Lindje.

Pika e Interkonjeksionit	Kapaciteti në Drejtimin Përpara i Pikës së Interkonjeksionit	Kodi EIC	Distanca (km)		Përqindja Minimale e Rrjedhës (Nm ³ /Ditë Gazi) ¹
			L _{ne drejtimin para}	L _{ne drejtim te kundert}	
Kipoi (lidhja me Gaszjellësin Anatolian të Natyror)	Pikë Hyrje	21Z0000000004758	0	879	7,050,144
Komotini	Pikë Dalje	21Z000000000472	89	790	914,400
Nea Mesimvria	Pikë Dalje	21Z000000000473	364	515	240,000
Kuçovë	Pikë Dalje	<i>Duhet të konfirmohet</i>	715	164	<i>Duhet të konfirmohet</i>
Fier	Pikë Dalje	<i>Duhet të konfirmohet</i>	757	122	<i>Duhet të konfirmohet</i>
Melendugno (Lidhja e Gazit Snam Rete)	Pikë Dalje	21Z000000000474	879	0	5,685,600

Kapaciteti në Pikat e Interkonjeksionit në Kuçovë dhe Fier do të vendosë në dispozicion tek Testimet e Tregut dhe ankandet e rregullta në atë masë që kapaciteti të vendoset në dispozicion me OST Fqinje.

¹ TAP është duke ndërmarrë një analizë teknike me qëllim rishikimin e këtyre shifrave në rënie para fillimit të funksionimit tregtar

Tabela B: Pikat e Interkonjeksionit dhe Pikat Hyrëse/Dalëse në lidhje me Kapacitetin Tregtar në drejtim të Kundërt

Pikat e Interkonjeksionit të përmendura tek tabela më poshtë caktohen si Pika Hyrëse dhe Dalëse në lidhje me Kapacitetin Tregtar në Drejtim të Kundërt.

Kapaciteti Tregtar në Drejtim të Kundërt mund të rezervohet sipas kombinimeve të mëposhtme të Pikave të Interkonjeksionit si Pikë Hyrëse/Dalëse. Disa Pika Interkonjeksioni mund të jenë ose Pika Hyrëse ose Pika Dalëse në varësi të Rrugës Tregtare në Drejtim të Kundërt si përcaktohet tek tabela më poshtë.

Rruga	Pika Hyrëse	Pika Dalëse
1	Melendugno	Nea Mesimvria
2	Melendugno	Komotini
3	Nea Mesimvria	Komotini
4	Melendugno	Fier
5	Melendugno	Kuçovë
6	Fier	Kuçovë
7	Fier	Nea Mesimvria
8	Fier	Komotini
9	Kuçovë	Nea Mesimvria
10	Kuçovë	Komotini

Kapaciteti për çdo Rrugë Tregtare në Drejtim të Kundërt e cila përfshin Pikën e Interkonjeksionit në Kuçovë ose Fier do të vendosen në dispozicion vetëm në atë shkallë që kapaciteti është në dispozicion me OST Fqinje. Transportuesi nuk ka lidhje me disponueshmërinë e shërbimeve të transportit tek Rruga në Drejtim të Kundërt të Pikës së Interkonjeksionit nga çdo OST Fqinjë.

SHTOJCA 3

FORMULARI I REGJISTRIMIT

Të bëhesh një Palë e Regjistruar tek Sistemi i Transportit i TAP

Aplikuesit të cilët dëshirojnë të regjistrohen tek Sistemi i Transportit i TAP duhet fillimisht të plotësojnë Formularin online të ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit (**Onboarding Form**) që ndodhet tek faqja e internetit e Transportuesit dhe pastaj duhet të plotësojnë këtë Formular Regjistrimi dhe ta paraqesi kopjen e firmosur së bashku me dokumentacionin mbështetës. Transportuesi duhet të njoftojë aplikuesin nëse janë regjistruar në mënyrë të suksesshme si Palë e Regjistruar. Kushtet financiare që përdoren por nuk përcaktohen tek ky Formular Regjistrimi kanë kuptimin që u është dhënë atyre tek Kodi i Rrjetit që aplikohet për Gazsjellësin Trans Adriatik

1. Detajet e Aplikuesit dhe informacioni i kontaktit

Ju lutem jepni detaje për Personin që aplikon për tu bërë Palë e Regjistruar tek Sistemi i Transportit i TAP.

1.1 Informacione të kompanisë:

Emri i plotë ligjor i kompanisë	
Adresa kryesore (selia)	
Adresa tjetër	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Numri i Telefonit	
Numri i Faksit	
Adresa e emailit	
Faqja e Internetit e Kompanisë	
Numri i regjistrimit të kompanisë	
Kodi i ACER (nëse aplikohet përmes raportimit të REMIT)	
Regjistrimi për TVSH (nëse aplikohet)	

Transportuesi ka të drejtën të kërkojë informacione të tjera nëse nuk jepet një numër i verifikueshëm i regjistrimit të TVSH.

1.2 Detajet e bankës së kompanisë:

Nëse aplikohet, Transportuesi duhet të transferojë fondet tek llogaria e mëposhtme

Emri i Bankës	
Kodi BIC/SWIFT i Bankës	
IBAN për llogarinë në Euro	
Emri i personit që ka llogarinë në Euro	

1.3 Informacioni i kontaktit të përfaqësuesit të autorizuar:

Personi i autorizuar duhet të nënshkruajë kontrata me Transportuesin

Emri i personit	
Pozicioni	
Adresa kryesore	
Adresa e 2-te	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Numri i Telefonit	
Numri i Faksit	
Adresa e email	

1.4 Informacione kontakti të Biznesit:

Personi përgjegjës për veprimtarinë dhe detyrat funksionale të përditshme të biznesit

Emri i personit	
Pozicioni	
Adresa kryesore	
Adresa e dytë	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Numri i telefonit	
Numri i faksit	
Adresa e email	

1.5 Informacionet e kontaktit të personit që merr faturat:*Personi përgjegjës për faturat dhe pagesat*

Emri i personit	
Pozicioni	
Adresa kryesore	
Adresa e 2-të	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Numri i Telefonit	
Numri i faksit	
Adresa e email	

1.6 Informacionet e kontaktit të personit që do të bëjë dërgimin 24(orë/7ditë):

Personi i kontaktit përgjegjës për komunikimin elektronik me Transportuesin dhe që është i disponueshëm 24 orë në ditë. Keni parasysh që këtij personi do ti dërgohet email ose do të telefonohet nga Transportuesi për të organizuar testin e komunikimit.

Personi i kontaktit përgjegjës për komunikimet me transportuesin (ju lutem përzgjidhni një nëse aplikohet)	
Personat brenda kompanisë që po aplikon	
Ofruesit e shërbimit të palës së tretë	
Emri i personit të kontaktit	
Numri i telefonit	
Numri i faksit	
Adresa e email	

1.7 Mënyra e komunikimit:

Ju lutem konfirmoni mënyrat e komunikimit që do të përdoren për komunikimet operationale dhe konfirmoni që keni plotësuar formularin përkatës që përmendet më poshtë dhe që ndodhet tek faqja e internetit e Transportuesit. Keni parasysh që Edig@s duhet të përdoret derisa ju nuk jeni në gjendje të komunikoni duke përdorur Edig@s.

Ju lutem konfirmoni që keni plotësuar Formularin e	
--	--

Regjistrimit tek Llogaria e Perdoruesit ne lidhje me komunikimet duke perdorur Platformen Elektronike te te Dhenave te TAP	
Ju lutem konfirmoni qe jeni ne gjendje te komunikoni permes Edig@s dhe keni plotesuar Formularin e Specifikimeve te TAP AS4. Shenim: Nese nuk jeni ne gjendje ta ofroni kete informacion, duke qene qe nuk keni mundesi te komunikoni permes Edig@s Transportuesi ju rekomandon te ndermorni hapa per te zbatuar komunikimin nepermjet Edig@s dhe per te siguruar Formularin e Specifikimeve te TAP AS4 kur te kete perfunduar zbatimi.	

1.8 Informacionet e kontaktit të përfaqësuesit ligjor të Kompanisë:

Përfaqësuesi ligjor i kompanisë.

Përfaqësuesi ligjor i Transportuesit (ju lutem përzgjidhni një që mund të aplikohet)
Personi brenda kompanisë
Ofruesi i shërbimit të palës së tretë
Emri i personit të kontaktit
Numri i telefonit Numri i faksit Adresa e email

2. Konfirmimet përkatëse dhe dokumentacioni mbështetës

2.1 Kopje që jeni regjistruar tek regjistri i kompanisë

Konfirmoni që keni shtuar provat e regjistrimit të kompanisë në regjistrin e kompanive përkatëse (ju lutemi shënoni)	
--	--

2.2 Autorizimi nga autoriteti për të hyrë tek formulari i regjistrimit

Konfirmoni që keni bashkëlidhur autorizimin nga autoriteti për personin që do të nënshkruajë këtë Formular Regjistrimi (kopje e vërtetuar nga regjistri përkatës i kompanisë ose autorizim i përfaqësuesit ligjor) (ju lutem shënoni)	
---	--

2.3 Informacione për vlerësimin e besueshmërisë së kredisë

Transportuesi do të kryejë një vlerësim fillestar të besueshmërisë së kredisë dhe duhet të caktojë një Limit Krediti për çdo Palë të Regjistruar. Për ta bërë këtë Transportuesi kërkon dokumentat e mëposhtëm që do të dorëzohen së bashku me Formularin e Regjistrimit (në masën që është e aplikueshme):

- (a) Nëse kompania juaj ka për qëllim të ketë një Limit Krediti mbi Vlerësimin e Kreditit, (i) tre

pasqyra financiare të fundit vjetore të kompanisë së certifikuar për organizatën tuaj (entin operues) dhe (ii) raportin më të fundit të kredisë për kompaninë tuaj nga një agjenci e njohur ndërkombëtarisht e vlerësimit të kredisë.

- (b) Nëse kompania synon të përdorë një Garanci të Vlerësuar të Subjektit nga një kompani e lidhur, (i) tre pasqyra financiare të fundit vjetore të kompanisë së certifikuar për kompaninë e lidhur me kompaninë tuaj (ii) raportin më të fundit të kredisë për kompaninë e lidhur me kompaninë tuaj nga një agjenci e vlerësimit të kredisë e njohur ndërkombëtarisht dhe (iii) një garanci draft në formën e një modeli që të jetë tek faqja e internetit e Transportuesit, të plotësuar me informacionin përkatës nga kompania e lidhur.
- (c) Nëse kompania juaj synon të përdorë një Garanci të Vlerësuar të Subjektit nga një bankë / institucion kreditor, (i) raporti më i fundit i kredisë për atë bankë / institucion kreditor nga një agjenci e vlerësimit të kredisë e njohur ndërkombëtarisht dhe (ii) një garanci draft në formën e një modeli të ofruar tek faqja e internetit e Transportuesit, të plotësuar me informacionin përkatës për bankën/institucionin kredidhënës⁵.

Në rastin kur më shumë se një agjenci e vlerësimit të kredisë e njohur ndërkombëtarisht siguron një vlerësim, raporti më i fundit i kredisë nga secila agjenci duhet t'i jepet Transportuesit.

Ju lutem specifikoni cilin kriter do të përdorni për tu pajtuar me kërkesën për Limitin Minimal të Kreditit.	
Konfirmoni që ju keni bashkëlidhur dokumentat përkatës për çdo kriter të kërkuar, që përmendet më sipër (ju lutem shënoni)	
Nëse nuk e keni dhënë këtë informacion, ju lutem jepni një justifikim (maksimumi 100 fjalë)	
Nëse po përdorni një Garanci të Vlerësuar të Subjektit, specifikoni çdo limit që do të aplikoni për atë garanci.	€
Nëse dëshironi të depozitoni Kolateral në para, specifikoni shumën që dëshironi të depozitoni.	€

⁵ keni parasysh që, sipas modelit, nëse Garancia e Vlerësuar e Subjektit ka një datë përfundimi, Transportuesi mund të kërkojë që Pala e Regjistruar të nënshkruajë një marrëveshje tjetër në lidhje me përfundimin e kësaj Garancie të Vlerësuar të Subjektit.

2.4 Garanci për Sanksionet

Tregëtari/Furnizuesi kërkohet të japë disa garanci të caktuara në lidhje me Sanksionet.

Konfirmoni që keni kuptuar dispozitat e Kushteve dhe Termave të Përgjithshme që kanë të bëjnë me "Sanksionet" (siç përcaktohet tek Kushtet dhe Termat e Përgjithshme) dhe keni nënshkruar dhe bashkangjitur modelin e duhur të dhënë në faqen e internetit të Transportuesit (ju lutemi shënoni)	
--	--

2.5 Deklarata e mbizotërimit

Sipas Nenit 4.7 te Opinionit Përfundimtar të Përbashkët limite të caktuara mund të aplikohen për kompani nese pretendojne te kene nje pozicion mbizoterues pas vleresimit tek tregjet Italiane, Greke dhe/ose Shqiptare të gazit. Detajet e kontaktit te secilit prej Autoriteteve Rregullatore per kete qëllim janë:

ARERA: mercati-ingrosso@arera.it

RAE: capacity_caps.@rae.gr

ERE: capacitycaps@ere.gov.al

Konfirmoni që keni njoftuar Autoritetin Rregullator për qëllimin tuaj për tu regjistruar me Transportuesin dhe që do të njoftoni Transportuesin për çdo limit kapaciteti që duhet të vendoset mbi ju sipas vleresimit dominues që kryhet nga Autoriteti përkatës Rregullator në përputhje me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (ju lutem shënoni)	
--	--

3. Deklarata e pranimit dhe nënshkrimi

Në momentin që ju nënshkruani këtë Formular Regjistrimi, ju konfirmoni që:

- (a) Ju keni paguar Tarifën e Regjistrimit të vendosur tek faqja e internetit e Transportuesit sipas mënyrës së specifikuar.
- (b) Informacioni i dhënë tek ky Formular Regjistrimi është i plotë, korrekt dhe i vërtetë.
- (c) Ju keni fuqinë për ta nënshkruar dhe dorëzuar këtë Formular Regjistrimi si dhe shtojcat bashkëlidhur, të konfirmuara nga informacioni mbështetës që jepet tek Paragrafi 2.2.
- (d) Ju keni lexuar Kodin e Rrjetit në lidhje me Sistemin e Transportit të TAP, Kushtet dhe Termat e Përgjithshme për transportin e gazit tek Sistemi i Transportit të TAP dhe Konfirmimin e Transportit, secili sipas formularit më të fundit të publikuar tek faqja e internetit e Transportuesit dhe pranoni kushtet e këtyre dokumentave që rregullojnë çdo kontratë të nënshkruar me Transportuesin për përdorimin e kapacitetit tek Sistemi i Transportit duke siguruar një letër pranimit të nënshkruar si shtojcë të këtij formati.

- (e) Ju keni dhënë të gjitha konfirmimet përkatëse dhe bashkëngjitur informacionin e nevojshëm mbështetës, siç kërkohet në Paragrafin 2 të kësaj forme, ose keni dhënë arsyetime të përshtatshme për arsyen pse nuk kërkohen.
- (f) Ju keni lexuar politikën e mbrojtjes së të dhënave të Trans Adriatic Pipeline AG që ndodhet tek <https://www.tap-ag.com/privacy-notice> dhe jepni pëlqimin tuaj të plotë për përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave tuaja, siç përcaktohet nga ky njoftim.
- (g) Ju pranoni që Transportuesi kërkon që ju të përditesoheni në përputhje me nenin 3.2 të Kodit të Rrjetit ose duke ndjekur ndonjë ndryshim material, nga data e pranimit tuaj në Regjistër, nëse ka pasur ndonjë ndryshim në informacionin e përmbajtur në këtë Formular Regjistrimi dhe dokumentet beshtetëse të tij. Në rast të ndonjë ndryshimi, duhet t'i siguroni Transportuesit një Formular të ndryshuar të Regjistrimit dhe çdo dokument mbështetës që lidhet me ndryshimet.
- (h) Ju pranoni të informoni Transportuesin, në kohë, për ndryshimet në lidhje me informacionin e kërkuar në Paragrafin 2.4, duke përfshirë pasqyrat e reja vjetore të certifikuara dhe raportin / et e reja të kredisë.
- (i) Ju pranoni të bëni një deklaram të plotë të çdo përkeqësimi material të burimet financiare, besueshmërinë ose gjendjes financiare të organizatës tuaj dhe / ose garantuesi (sipas rastit), në krahasim me informacionin më të fundit të dhënë Transportuesit.
- (j) Ju keni ekzekutuar dhe bashkëngjitur siç duhet Marrëveshjen e Konfidencialitetit në formatin e publikuar në faqen e internetit të Transportuesit.
- (k) Ju keni plotësuar Formularin online të ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit " **Onboarding Form**" që gjendet tek faqja e internetit e Transportuesit dhe pyetësorin e ekzaminimit të personit në tërësi (IDD), një faqe e cila ofrohet nga Transportuesi përmes IDD të Transportuesit me plotësimin e Formularit të ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit
- (l) Ju keni lexuar kërkesat e komunikimit për Sistemin e Transportit TAP dhe i jepni pëlqimin tuaj të plotë të përmbajtjes së tij dhe pranoni që Transportuesi do të kontaktojë individin përgjegjës për komunikime me Transportuesin, siç përcaktohet në Paragrafin 1 sipas informacioneve të kontaktit brenda 24 orëve / 7 dite të dërgimit, për të organizuar një test komunikimi.
- (m) Ju konfirmoni që për dhe nga hyrja juaj në Regjistër do të jeni i lidhur me Kodin e Rrjetit si Palë e Regjistruar dhe do t'i përmbushni të gjitha detyrimet e një Pale të Regjistruar sipas Kodit të Rrjetit.
- (n) Ju e pranoni që Kodi i Rrjetit mund të përditesohet herë pas here sipas procedurës së përcaktuar tek Kodi i Rrjetit dhe se (i) ju do të vazhdoni të respektoni detyrimet tuaja si Palë e Regjistruar në bazë të ndonjë Kodi të tillë të përditësuar të Rrjetit dhe (ii) Kodi itillë i Rrjetit i përditësuar do të rregullojë marrëdhënien tuaj me Transportuesin si Palë e Regjistruar, në secilin rast me efekt ngapublikimi i përditësimit nga Transportuesi.
- (o) Si Pale e Regjistruar e TAP, pranoni dhe është dakord që emri juaj I plote do të publikohet në faqen e internetit të Transportuesit, tek lista e Paleve të Regjistruara që Transportuesi është i detyruar ta publikojë sipas Nenit 78(2)e të Legjislacionit Grek 4001/2011 mbi Funksionimin e Tregjeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, të Kerkimeve të Hidrokarbureve, të Prodhimit dhe Sistemit të Transmetimit.

Emri:

Firma:

Vendi dhe data _____

Ju lutem dërgoni një kopje të firmosur të këtij formulari tek adresa e mëposhtme:

Registrations
Trans Adriatic Pipeline AG
Lindenstrasse 2
6340 Baar
Switzerland

Ose, nëse formulari është firmosur në mënyrë elektronike sipas mënyrës që pranohet nga Transportuesi, në adresën e emailit më poshtë: commercial@tap-ag.com

SHTOJCA 4

SPECIFIKIMET E GAZIT NATYROR

Përbërja e Gazit⁵

Përbërësi	Njësia	min	max
Metan	mol%	75	-
Nitrogjen ⁶	mol%	-	6
Dioksid Karboni	mol%	-	2.5
Oksigjen	mol%	-	0.02
Sulfur Hidrogjeni + Sulfur Karboni (Sulfur)	mg/Nm ³	-	5
Mercaptan Sulfur (as Sulfur)	mg/Nm ³	-	6
Sulfur në Total	mg/Nm ³	-	21

Vetitë e Gazit

Vetia	Njësia	min	max
Pika e Ujit	°C	-	- 8 @70 bar-a
Pika e Hidrokarbonit	°C	-	- 2 @(1~70) bar-a
Temperatura	°C	-	50
Graviteti i Veçantë	-	0.555	0.700
Vlera Kalorifike Bruto	MJ/Nm ³	36.84	47.73
Treguesi Wobbe	MJ/Nm ³	49.87	55.16
Numri Metan	-	65	-

Në vazhdim të kufizimeve të specifikuara më sipër, gazi natyror që furnizohet tek TAP nuk duhet të përmbajë përbërës të tjerë dhe/ose papastërti (përfshirë grimca të ngurta dhe lëngje) në masën që ato nuk mund të transportohen pa rregullime ose trajtime të cilësisë.

⁵ Kushtet referencë për metra kub janë 0°C për volum dhe 25°C për djegjen. Për konvertimin midis standarteve normale dhe në metra kub, ju lutem referojuni ISO 13443.

⁶ Nuk duhet të refuzohet gazi mbi përmbajtjen e nitrogjenit duke siguruar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e tjera.

SHTOJCA 5 ZHVILLIMET NË TË ARDHMEN

1. Procedurat afatshkurtra të menaxhimit të kongjestionit (trafikut të kërkesave)

Transportuesi, brenda një viti nga përfundimi i kohës së testimit (ramp-up) duhet të përgatisë një Propozim Rishikimi sipas Pjesës 22.4 për të përfshirë tek Kodi i Rrjetit, Mekanizmin e mbivendosjes ose atë të blerjes përsëri, ose në mënyrë alternative mekanizmin e ditës në avancë përdore ose humbe sipas paragrafeve 2.2.2 ose 2.2.3 Shtojca I Rregullorja (EC) nr. 715/2009. Vendimi për të proçeduar ose me mekanizmin e mbivendosjes dhe të blerjes përsëri ose me mekanizmin e ditës në avancë përdore ose humbe dhe Propozimi i Rishikimit që rezulton nga kjo, do të merret duke vlerësuar eksperiencën operationale të fituar nga ana e Transportuesit që nga Data e Fillimit të Operacioneve Tregtare.

2. Rriedha Komerciale në drejtim të kundërt

Sipas vendimit për të vënë në dispozicion Kapacitetin e Zgjerimit përmes zbatimit të Projektit të Zgjerimit sipas Testimit të Tregut, Transportuesi do të vlerësojë nëse kufizimet e rishikuara tek Sistemi i Transportit i TAP nënkuptojnë që është teknikisht e mundur heqja e kërkesës që Kapaciteti Komercial në Drejtim të Kundërt të rezervohet sipas Mënyrës/Rrugës Komerciale në Drejtim të Kundërt dhe në vend të kësaj mund të rezervohet si një sistem i pavarur për hyrje-dalje (përfshirë aksesin tek Pika Virtuale e Tregëtimit). Nëse Transportuesi beson që kjo është teknikisht e mundur, ai duhet të konsultohet me:

- a) Autoritetet Rregullatore në lidhje me ndryshimet që mund të kërkohen tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët ose tek Kodi i Rrjetit i TAP për ta vendosur këtë ndryshim;
- (b) Forumi i Palëve të Interesuara se si mund të zbatohen këto ndryshime; dhe
- (c) Tregëtarët/Furnizuesit me rezervime afatgjata të kapacitetit e cila ndikon tek ata Tregëtarë/Furnizues që zbatojnë këto ndryshime,

para se të vendosë, sipas gjykimit të tij, nëse është i mundur ky ndryshim. Nëse është i mundur, Transportuesi duhet të përgatitë një Propozim Rishikimi sipas Pjesës 22.4.

3. Kostot e Tregëtarit/Furnizuesit

Transportuesi duhet të vlerësojë nëse është e mundur rregullimi i mekanizmin për kalimin e kostove të Gazit Karburant, të Energjisë elektrike dhe kostot e UFG tek Tregëtarët/Furnizuesit në mënyrë që këtyre Tregëtarëve/Furnizuesve tu jepet një siguri më e madhe për kostot që do të shkaktohen. Mekanizmi i rishikuar mund të përfshijë edhe një fikse të vlerësuar për periudhën kohore e cila paguhet nga Tregëtari/Furnizuesi, të rregulluar për të reflektuar pagesat nën ose të tepërta krahasuar me kostot aktuale të bëra për periudhat në të ardhmen. Transportuesi do ta fillojë këtë vlerësim pasi të vendosë se ai ka mbledhur të dhëna të mjaftueshme për operimin e qëndrueshëm që të jetë në gjendje të vlerësojë siç duhet meritat e këtij propozimi, përfshirë:

- (a) efektin për sigurinë e kostove tek Tregëtari/Furnizuesi; dhe
- (b) çdo diskriminim që mund tu ndodhë Tregëtarëve/Furnizuesve me rezervimet vetëm për periudha të caktuara.

Nëse Transportuesi, sipas këtij vlerësimi, beson që duhet të zbatohet një ndryshim tek Mekanizmat e alokimit të kostos për Gazin Karburant, Energjinë elektrike dhe kostot UFG, ai duhet të përgatisë një Propozim Rishikimi sipas Pjesës 22.4.

4. Produktet brenda ditës

Transportuesi të paktën një herë në vit duke filluar dy vjet nga Data Komerciale e Vendosjes në Funkcion, duhet të rishikojë nëse ka kërkesa të mjaftueshme për ofrimin e produkteve brenda ditës dhe nëse ka, duhet të vlerësojë (a) ndikimet e tjera funksionale për ofrimin e produkteve brenda ditës dhe (b) produktet të cilat mund të ofrohen nga OST Fqinje tek Sistemet e Ndërlidhura. Nëse vendos se është e përshtatshme, Transportuesi duhet të përgatisë një Propozim për Rishikim sipas Pjesës 22.4 për të përfshirë produktet brenda ditës sipas Produkteve të ofruara të Kapacitetit.